

KËRKIME PEDAGOGJIKE

Përmbledhje punimesh

1

KËRKIME PEDAGOGJIKE

Përmbledhje punimesh

1

Prishtinë, 2023

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin:

Ismet Potera, Zvs. Drejtor

Këshilli Shkencor i IPK-së:

Prof. asoc. dr. Hatixhe Ismajli

Prof. asoc. dr. Naser Zabeli

Prof. asoc. dr. Linda Grapci

Korrektues gjuhësor:

Bekim Morina

Përgatitja teknike:

Skender Mekolli

Shtypi:

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Tabela e përmbajtjes

Parathënie	5
Ismet Potera: Faktorët e kënaqësisë ose të pakënaqësisë së mësimdhënësve në punë	9
Skender Mekolli: Përvojat e shkollave për orientim në karrierë të nxënësve.....	33
Selim Mehmeti: Përgatitja mësimdhënësve para shërbimit në Kosovë: Sfidat dhe mundësitë	65
Safete Statovci-Shala: Analizë e teksteve shkollore të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë.....	119
Agim Bujari & Sahare Reçica-Havolli: Adresimi i TIK-ut në Kurrikulë dhe vështirësitë në zbatimin e lëndës Teknologji me TIK në shkollat e mesme të ulëta	143
Lirije Bytyqi-Beqiri: Praktikat e mësimdhënësve të arsimit fillor në përgatitjen e materialeve mësimore	177

Parathënie

Ky numër i revistës **Kërkime Pedagogjike** është vazhdimësi e publikimeve vjetore të Institutit Pedagogjik. Këtë vit, si rezultat i projekteve të shumta kërkimore, **Kërkime** del në dy vëllime. Tematikat që janë trajtuar nga hulumtuesit e IPK-së janë të larmishme dhe me interes për fusha të caktuara arsimore. Disa nga tematikat e hulumtuara janë nga fusha e mësimdhënies ose e zhvillimit profesional të mësimdhënësve, si një nevojë e vazhdueshme për ngritjen e cilësisë në arsim.

Klima pozitive në shkollë del të jetë faktor i rëndësishëm për shkallën e kënaqësisë së mësimdhënësve në punë. Një temë e tillë nuk është e hulumtuar sa e si duhet në mjedisin tonë arsimor. Po lidhur me mësimdhënësin, si faktor kryesor i procesit mësimor në shkollë, është trajtuar çështja e parapërgatitjes akademike të mësimdhënësve. Analizë e thelluar u është bërë programeve të fakulteteve që përgatisin mësimdhënësit e ardhshëm, e cila është me interes si për fakultetet ashtu edhe për sistemin e përgatitjes në përgjithësi.

Përgatitja e materialeve didaktike nga mësimdhënësit, në funksion të konkretizimit të mësimave, është çështje që nuk shteron së trajtuari, prandaj një temë e tillë është shqyrtuar nëpërmjet analizës së praktikave të mira në shkollë. Faktorët që ndikojnë në qëndrimet e nxënësve ndaj procesit të të nxënësve në shkollë, si dhe përvojat e shkollave për t'i ndihmuar nxënësit për orientim në karrierë, janë aktuale dhe të rëndësishme për teorinë dhe praktikën e organizimit të punës me nxënës në shkollë.

Organizimi i aktiviteteve artistike, si pjesë të përmbajtjeve mësimore ose në formë të aktiviteteve të lira, paraqet një mjet dhe mekanizëm frymëzues për të rritur ndjenjën e përbushjes së nxënësve në shkollë. Prandaj, përfshirja e dramës dhe aktiviteteve të tjera artistike në shkollë ndikon, sipas hulumtimit, në qasjen pozitive të nxënësve ndaj shkollës, por edhe në ndryshimin dhe kultivimin e sjelljeve të nxënësve.

Çështja e përmbajtjeve kurrikulare, përfshirja dhe adresimi i teknologjisë në to, është bërë temë qendrore e diskutimeve dhe është trajtuar në kuadër

Kërkime Pedagogjike

të analizës së fushave kurrikulare dhe lëndëve përkatëse. Dy çështje të tjera më specifike, të trajtuara nga hulumtuesit, lidhen me përmbajtjet e gjuhës në arsimin special, si dhe praktikrat e vlerësimit të performancës së drejtorëve të shkollave publike. Si të tilla, ato paraqesin mundësi për reflektim për këto çështje me interes për shkollën.

Çështjet dhe tematikat e trajtuara në këtë numër të revistës **Kërkime Pedagogjike**, në formë të qasjes kërkimore, sasiore dhe cilësore, paraqesin një burim të rëndësishëm për të gjithë të interesuarit e arsimit dhe kërkimit në fushat e edukimit. Gjithashtu, kërkimet dhe rezultatet e tyre paraqesin një adresë të duhur për studime më të thelluara të çështjeve të përfshira në këtë numër.

Ismet Potera, zvs. Drejtor i IPK-së

Preface

This issue of **Pedagogical Research** is a continuation of the annual publications of the Pedagogical Institute. This year, as a result of numerous research projects, **Research** is published in two volumes. The topics that have been addressed by IPK researchers are diverse and of interest to various educational fields. Some of the topics researched are from the field of teaching or the professional development of teachers as a continuous need for raising the quality in education.

The positive climate in the school turns out to be an important factor for the degree of teachers' job satisfaction. Such a topic is not researched enough in our educational environment. Regarding teachers, the issue of the academic preparation of the teachers has been addressed as one of the main factors of the learning process in the school. An in-depth analysis of the programs of the faculties that prepare future teachers has been made, and it provides recommendation both for the faculties and for the system of teacher preparation.

Preparation of didactic materials by teachers, to support implementation, is an issue that can never be exhausted. Therefore, such a topic has been examined through the analysis of good practices in schools. The factors that influence students' attitudes towards the learning process at school as well as the experiences of schools to help students for career guidance, remain current and important for theoretical analysis and practices in organizing the work with students at the school level.

The organization of artistic activities, either as part of the curriculum content or in the form of free and extra-curricular activities, represents an inspiring tool and mechanism to increase the sense of fulfillment of students in school. Therefore, according to the research, inclusion of drama and other artistic activities in school curriculum affects the positive approach of students towards school and contributes to changing and nurturing students' behavior.

The issue of curricular contents, inclusion and addressing technology in them, has become a central topic of discussion. Thus, they have been

addressed as a part of the analysis of curricular fields and relevant subjects. Two other specific issues addressed by the researchers are related to the language content in special education, as well as the performance evaluation practices of public school principals. As such, they provide for an opportunity to reflect on these issues of interest to the school.

Topics and themes addressed in this issue of **Pedagogical Research**, in the form of a quantitative and qualitative research approach, represent an important resource for all those interested in education and research in the fields of education. Also, research and their results present a starting point for more in-depth studies of such issues.

Ismet Potera, Acting Director of KPI

FAKTORËT E KËNAQËSISË OSE TË PAKËNAQËSISË SË MËSIMDHËNËSVE NË PUNË

Ismet Potera¹

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi ishte ta përcaktojë hierarkinë e faktorëve të kontekstit shkollor dhe kënaqësisë së mësimit në punë. Janë trajtuar gjashtë aspekte të kontekstit shkollor: klima e përgjithshme në shkollë, ngarkesa në punë, marrëdhëniet me kolegët, marrëdhëniet me nxënësit dhe me prindër, motivuesit e jashtëm, si dhe motivuesit e brendshëm dhe të jashtëm, të cilët ndikojnë te mësimit në punë që të ndihet i përmbushur me punën që bën. Pjesë e mostrës ishin 132 mësimit në shkollën fillore dhe të mesme të ulët, si dhe 15 intervista me shkrim. Të dhënat cilësore janë analizuar sipas tematikave dhe duke u ndërritur me të dhënat sasiore. Të gjitha variablat janë grupuar në bazë të llojit të faktorëve që i referohen lidhur me marrëdhënien e tyre, me kënaqësinë në punë të mësimit në shkollë. Rezultatet sasiore dhe cilësore parashikojnë marrëdhëniet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta ndërmjet faktorëve të kontekstit shkollor me motivimin dhe kënaqësinë në punë e mësimit në shkollë. Identifikimi i hierarkisë së faktorëve që ndikojnë në kënaqësinë në punë, në koherencë me tematikat e identifikuar nga pohimet e mësimit në shkollë, paraqet një vlerë të shtuar për krijimin e harmonisë institucionale brenda shkollës, si dhe fuqizimin e ndjenjës së përkatësisë individuale të mësimit në shkollë në këtë harmoni. Kjo gjithësi garanton arritje më të larta me nxënësit si një variabël latente.

Fjalët çelës: *marrëdhëniet me kolegët, klima e përgjithshme e shkollës, mbikëqyrja, ngarkesa administrative, motivuesit e jashtëm, motivuesit e brendshëm.*

¹ Dr. i shkencave të edukimit, hulumtues në Institutin Pedagogjik të Kosovës

Factors of teachers' satisfaction or dissatisfaction at work

Abstract

The purpose of this study was to examine the relationships between school context variables and teachers' job satisfaction. Six aspects of the school context were measured: general school climate, workload, relationships with colleagues, relationships with students and parents, appropriateness of the lesson schedule, extrinsic motivation, as well as intrinsic and extrinsic motivators for which the teacher feels satisfaction at work. Participants are 132 Kosovar primary and lower secondary school teachers and 15 written interviews. Qualitative data were analyzed according to themes and combined with quantitative data. All variables are grouped based on which factors they refer to in relation to their relationship with teachers' job satisfaction. The results prove the direct and indirect relationships between school context factors and teachers' motivation and job satisfaction.

The identification of the hierarchy of factors that influence job satisfaction in coherence with the themes identified by teachers' statements represents an added value for creating institutional harmony within the school as well as strengthening the sense of individual belonging of teachers in this harmony. This however guarantees higher achievement with students as a latent variable.

Key words: *peer relations, general school climate, supervision, administrative workload, extrinsic motivators, intrinsic motivators*

Hyrje

Mësimdhënësi është pjesë e pandashme e zhvillimeve të hovshme në shoqëri, shkencë e teknologji, si dhe në shkencat e tjera. Këto zhvillime mësimdhënien e bëjnë gjithnjë e më sfiduese, derisa për mësimdhënësin paraqet situata të reja, për të cilat zhvillime duhet të përshtatet dhe të zhvillohet në vazhdimësi. Këto zhvillime për mësimdhënësin mund të jenë stresuese, por në raste edhe mund të shkaktojnë pakënaqësi. Mësimdhënia, si profesion dhe si vend pune, bën pjesë në shkencat humane, të cilat janë të ndikuara nga zhvillimet e përgjithshme shoqërore. Këto zhvillime, si në shkencë ashtu edhe në shoqëri, burimin e kanë në zhvillimet dhe ndryshimet që bëhen në sistemin arsimor. Agjent i këtyre ndryshimeve është edhe mësimdhënësi, njëri ndër aktorët e tyre. Në këtë mes të ndryshimeve janë edhe politikat që synim kanë zhvillimin e përgjithshëm shoqëror, ekonomik etj.

Lidhur me kënaqësinë në punë dhe motivimin e mësimdhënësve janë bërë shumë hulumtime. Sipas Lucy Crehan (2016), hulumtimet në shkencat humane, që kanë të bëjnë me motivimin dhe kënaqësinë në punë, janë shumë të afërta (Crehan, 2016, f. 25). Në shikim të parë, koncepti motivim dhe kënaqësi në punë janë ngushtë të ndërlidhur pasi që një faktor motivues mund shkaktojë kënaqësi në punë, gjë që faktori motivues përmbush një kërkesë të brendshme ose të jashtme të mësimdhënësit.

Janë disa faktorë të cilët mund të ndikojnë në shkallën e kënaqësisë së mësimdhënësve në punë. Ata faktorë janë të mjedisit ku punon, si vlerë e organizatës, marrëdhëniet me kolegët, kushtet e përgjithshme brenda mjedisit shkollor, marrëdhëniet me udhëheqjen e institucionit shkollor, raportet me nxënësit dhe prindërit, por edhe faktorë të brendshëm apo autonomë, që ndërlidhen me individin. Këto janë disa nga çështjet e trajtuara në këtë punim. Këto çështje janë trajtuar nga autorë dhe hulumtues të ndryshëm, prandaj edhe duhet t'u referohemi disa prej tyre.

Shqyrtimi i literaturës - konteksti teorik i problemit

Lidhur me faktorët, llojin dhe efektin e tyre në shkallën e kënaqësisë në punë, hasëm në analiza dhe kërkime të ndryshme. Meqenëse faktorët e

mundshëm që ndikojnë në përmbushjen ose pakënaqësinë e mësimitdhënësve mund të jenë të shumtë dhe të ndryshëm, u përcaktuam për disa prej tyre. Njëri ndër kërkimet është bërë nga Dimitri Van Maele & Mieke Van Houtte (2015), sipas të cilëve ka marrëdhënie ndërmjet raportit social, mes mësimitdhënësve dhe kënaqësisë në punë, por edhe mes përvojës dhe kënaqësisë në punë (Van Maele & Van Houtte, 2015, f. 822). Pra, sipas tyre, nga cilësia e marrëdhëniesve mes kolegëve në shkollë varet cilësia dhe shkalla e kënaqësisë në punë. Ndërsa, sipas Crehan (2016), kënaqësia në punë i referohet përmbushjes së ndonjë kërkese apo dëshire të mësimitdhënësit, gjë që ka të bëjë me çështjen e konceptit të ndërlidhur me të, motivimin (Crehan, 2016, f. 25).

Gjithashtu, Crehan ka identifikuar edhe një varg faktorësh që ndërlidhen me pakënaqësinë e mësimitdhënësve në punë, ku ndër të tjerë përmend politikën dhe administratën e kompanisë (institucionit), mbikëqyrjen, marrëdhëniet ndërpersonale, kushtet e punës, paga, statusi dhe siguria (Crehan, 2016, f. 27). Pra, të njëjtit faktorë që janë burim i kënaqësisë në punë, nga veprimi i tyre mund të shndërrohen në faktorë të pakënaqësisë. Këta faktorë, të cilët kryesisht ndërlidhen me mjedisin punues dhe marrëdhëniet pozitive mes individëve, Herzberg (1968) i emëron si “faktorët e higjienës” (sipas Crehan, 2016, f. 27).

Sipas Larissa Maria Troesch & Catherine Eve Bauer (2017), ka konsensus në literaturë se kënaqësia në punë ndikohet nga faktorë të jashtëm, të tillë si kushtet e punës, si dhe faktorët e brendshëm, të tillë si vetefektshmëri (Troesch & Bauer, 2017, f. 390). Të njëjtët autorë, në bazë të analizës që u bëjnë autorëve të ndryshëm, konstatojnë se kënaqësia në punë e mësimitdhënësve është një përcaktues domethënës i suksesit në punë, por edhe i qëndrimit të tyre ndaj punës. Duke cituar Judge, Thoresen, Bono & Patton, (2001), Troesch & Bauer konstatojnë dëshmitë empirike dhe sugjerojnë se kënaqësia e mësuesit është një përcaktues i rëndësishëm i suksesit në punë dhe i ruajtjes së mësuesve (sipas Troesch & Bauer, 2017, f. 390). Ndërkaq, Kinicki et al. (2002) gjetën se kënaqësia në punë ndikon pozitivisht në motivim (sipas Demir, 2020, f.216). Në studimin e tyre, Federici & Skalvik (2012) kanë gjetur se ekziston marrëdhënie pozitive mes faktorëve motivues dhe kënaqësisë në punë. Një marrëdhënie mes faktorëve motivues dhe kënaqësisë në punë kanë e konstatuar edhe Potera & Mehmeti

(2019) në studimin e tyre. Studimet e tilla vendosin një ndarje teorike midis koncepteve motivim dhe kënaqësi në punë. Të dyja konceptet janë të ndërlihdura, por edhe mund të supozohen si të kushtëzuara nga njëri-tjetri. Ndërsa, sa i përket llojit të faktorit që ndikon në nivelin e kënaqësisë, Van Dat Tran & Minh Tuan Lam Le (2015) në studimin e tyre konstatojnë se parashikuesi më i fortë i kënaqësisë në punë ishte interesi profesional, i ndjekur nga konsensusi i misionit, ndërsa parashikuesi më i dobët ishte inovacioni (Dat Tran & Lam Le, 2015, f. 41). Sipas këtij studimi, faktorët e mjedisit shkollor luajnë rol të rëndësishëm në nivelin e kënaqësisë/ të pakënaqësisë së mësimitdhënësve në shkollë.

Bazuar në literaturën e shqyrtuar dhe nevojën për një studim të kësaj natyre, me këtë studim është synuar të identifikohet (për)masa e kënaqësisë në punë, për të ekzaminuar lidhjet e saj me faktorët në nivel të shkollës, rrethanorë, si dhe faktorët personalë.

Qëllimi i hulumtimit

Ushtrimi i profesionit të mësimitdhënies është një akt mjaft specifik dhe i ndjeshëm, por edhe shumë kompleks. Mësimitdhënia nuk ka të bëjë vetëm me transmetimin e njohurive nga burimi deri te marrësi-nxënësi, por edhe gjetja e ndërmjetësuesve, rrugëve dhe mjeteve të tjera për lehtësimin e këtij transmetimi dhe pranimit nga ana e nxënësve. Ndërmjetësues dhe lehtësues kryesor i këtij transmetimi është mësimitdhënësi, i cili çdo ditë e më shumë po has në sfida e pengesa të ndryshme dhe të shumta, të cilat edhe mund ta pengojnë cilësinë e transmetimit dhe të lehtësimit të pranimit. Pra, këto sfida dhe pengesa/ues ndikojnë dukshëm në nivelin e kënaqësisë së mësimitdhënësve në punë gjatë ushtrimit të misionit të tij. Prandaj, synim kryesor i këtij kërkimi është përcaktimi i përmasës së hierarkisë dhe i llojit të faktorëve që ndikojnë/afektojnë nivelin e kënaqësisë së mësimitdhënësve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre të mësimitdhënies. Faktorët që ndikojnë në nivelin e kënaqësisë së mësimitdhënësve në punë janë të jashtëm, por edhe autonomë, apo të brendshëm. Synim tjetër i këtij kërkimi ishte identifikimi i pikave të përbashkëta dhe e shpërputhjes mes hierarkisë së faktorëve, variablave demografike të mësimitdhënësve, si: seksi, mosha, përvoja në punë, dhe deklaratave të dhëna në pyetjet e hapura, cilësore.

Arritja e qëllimit të hulumtimit është mundësuar nëpërmjet përgjigjeve në pyetjet kërkimore nga ana e mësimeve të përfshirë në mostër. Pyetjet kërkimore adresojnë çështjet e ndërlidhura me qëllimin e kërkimit për të analizuar e zbërthyer konceptet kryesore të kënaqësisë/përmbushjes së mësimeve në punë gjatë realizimit të procesit të mësimit.

Pyetjet kërkimore

1. Cila është hierarkia e faktorëve të kënaqësisë së mësimeve në punë, shkollë?
 - 1.1. Cilët janë faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që ndikojnë në kënaqësinë e mësimeve në punë?
 - 1.2. Cilët faktorë motivues ndikojnë në kënaqësinë e mësimeve në punë?
2. Cili është mendimi i mësimeve ndaj faktorëve të kënaqësisë/pakënaqësisë në punë?

Kufizimet e studimit

Ky studim ka disa kufizime. Grumbullimi i të dhënave mbështetet në matjen e vetëraportimit, prandaj nuk ka ndonjë masë të vlerësimit të saktësisë të vetëraportimit nga ana e tyre, që pasqyrojnë variablat e studimit. Gjithashtu, studimi është shumëdimensional, prandaj edhe dukuritë dhe konceptet e ndërlidhura kërkojnë qasje shumëdimensionale.

Metodologji e hulumtimit

Qasja kërkimore ishte sasiore dhe cilësore. Të dhënat janë grumbulluar me anë të pyetësorit, me përgjigje alternative, shkalla e likerit, si dhe me pyetje të hapura të dhënave cilësore.

Mostra

Mostrën e përbëjnë (N=132) mësimdhënës/e të shkollimit të detyrueshëm, 1-9, ndërsa janë përfshirë nga vende dhe shkolla të ndryshme të Kosovës. Për qasjen cilësore janë përzgjedhur 15 mësimdhënës/e të moshave të ndryshme. Përzgjedhja e mostrës (N=132, n=15) mësimdhënës është realizuar me procedurë rastësore të përzgjedhjes. Kriteret për përzgjedhjen e mostrës ishin: të jetë mësimdhënës i rregullt, i kualifikuar, përvojë mbi njëvjeçare në mësimdhënie, si dhe që punojnë në shkollë në fshat dhe/ose në qytet. Mostra cilësore është e qëllimshme: së pari u kontaktuan mësimdhënësit në bazë të një liste të përzgjedhjes së rastit, pastaj iu dërgua protokollin me pyetjet e hapura. Mësimdhënësit e të dy seksve janë përfshirë në mostër kërkimi.




Figura 1. Përbërja e mostrës sipas moshës

Afërsisht përbërje e ngjashme e popullatës së mësimdhënësve, sikurse në mostër, është në shkollat e Kosovës. Por dallimi mes mësimdhënësve të përfshirë në mostër, sipas përvojës, në krahasim me grupmoshën është paraqitur në tabelën 1.

Tabela 1. Përvoja në mësimdhënie e pjesëmarrësve në mostër

		Frequency	Percent
Valid	1-10	54	40,9
	11-19	31	23,5
	20-29	27	20,5
	30-39	19	14,4
	Total	131	99,2
Missing	System	1	,8
Total		132	100,0

Përbërja e mostrës, sipas seksit, përvojës dhe moshës, është e përafërt me të dhënat statistikore zyrtare të ASK/MASHTI (2022).

Procedurat e grumbullimit të të dhënave

Në formë rastësore janë përzgjedhur shkollat. Nga shkollat e përzgjedhura është caktuar numri i mësimdhënësve për mostër. Në bazë të numrit të mësimdhënësve dhe të nxënësve që kanë shkollat u caktua numri i mësimdhënësve për mostër dhe atë: shkollat me më pak se 500 nxënës nga pesë mësimdhënës për shkollë, ndërsa nga shkollat me më shumë se 500 nxënës deri në dhjetë mësimdhënës. Pyetësi u dërgua në formë fizike në shkollë për plotësim. Koha për plotësim merr deri në 10-15, ndërsa pyetjet e hapura deri 20 minuta. I njëjti është kthyer në zarf të mbyllur. Kriteri për zgjedhjen e mostrës, sipas madhësisë së popullatës së shkollës, u bë me qëllim të gjetjes së ndërlidhjes mes madhësisë së shkollës me shkallën dhe llojin e kënaqësisë apo pakënaqësisë së mësimdhënësve në punë.

Instrumentet kërkimore

Për mbledhjen e të dhënave sasiore është përdorur pyetësi i hartuar nga autori dhe i pilotuar. Përmbajtja e pyetësit përfshin të dhënat demografike

të mostrës, si: seksi, moshë, përvoja, shkollimi. Pastaj gjeografia fshat-qytet, si dhe madhësia e shkollës për nga numri i nxënësve.

Pjesa e dytë e pyetësorit përbëhet nga pohimet lidhur me faktorët e mundshëm që ndikojnë në kënaqësinë e tyre në punë, ku janë dhënë gjithsej 35 pohime. Pohimet adresojnë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm, të cilët parashihet se mund të ndikojnë në kënaqësinë e mësimdhënësve në punë. Faktorët e jashtëm, të cilët parashihet se mund të ndikojnë në shkallën e kënaqësisë së mësimdhënësve në punë ndërlidhen me faktorët e mjedisit të punës të adresuar nëpërmjet tetë pohimeve, pastaj faktorët të jashtëm të përfshirë në 5 pohime. Raportet me të tjerët, si faktorë që mund të ndikojnë në shkallën e kënaqësisë në punë, janë adresuar në tetë pohime, ndërsa faktorët e brendshëm në 10 pohime.

Pjesa e tretë të pyetësorit ka gjithsej 22 pohime, të cilat adresojnë faktorët ose/edhe situata, të cilat parashihet se mund të ndikojnë në pakënaqësinë e tyre në punë. Grupin e parë e përbëjnë kërkesat administrative ndaj mësimdhënësve, si faktorë të jashtëm, gjithsej shtatë pohime, ndërsa faktorët personalë janë adresuar në gjithsej 15 pohime.

Përgjigjet janë dhënë në pesë shkallë të Likerit, në të cilat mësimdhënësit japin vlerësimin/ perceptimin e tyre lidhur me nivelin e ndikimit të mundshëm të faktorit në kënaqësinë/ pakënaqësinë e tyre në punë. Vlerësimi bëhet në alternativat nga 1-5, si: *1 = Aspak nuk ndikon, 2 = ndikon pak, 3 = ndikim mesatar, 4 = ndikim i lartë, 5 = ndikim shumë i lartë*. Në fund të pyetësorit është dhënë një kërkesë e hapur: nëse ka mbetur ndonjë faktorë, i cili ndikon në kënaqësinë /pakënaqësinë tënde në punë, ju lutem shtojeni këtu. Kërkesa e hapur, gjë që do të përfshihej në përpunimin e të dhënave cilësore, por nuk patëm ndonjë përgjigje domethënëse.

Kohëzgjatja për plotësimin e pyetësorit ishte paraparë 10-15 minuta.

Protokolli me pyetje të hapura, si:

1. A mund të listosh disa nga faktorët, të cilët ndikojnë në ju që të ndiheni e kënaqur në vendin e punës?
2. Në faktorët e përmendur në 1, si p.sh. fryma pozitive në kolektiv, mjedisi mësimor, raportet me kolegët, raportet me udhëheqjen e

shkollës, rezultatet e arritura me nxënës, bashkëpunimi me prindër, bashkëpunimi me kolegët etj., a mund ta arsyetoni ndonjërin nga këta faktorë?

3. Cili është mendimi juaj lidhur me ndikimin e disa/ndonjërit nga faktorët e cekur më lart në pakënaqësinë tuaj në punë? Argumento pse ndikon keq.
4. Cilët faktorë që rrisin kënaqësinë tuaj në punë do t'i përmirësoje ose do t'i ndryshoje në shkollën tuaj? Argumento pse do t'i përmirësoje ose ndryshoje.
5. Nëse ke për të shkruar diçka që nuk është kërkuar, ju lutem plotësojeni këtu:_____...

Mësimdhënësit e përzgjedhur si pjesë e mostrës cilësore janë kontaktuar dhe pasi që janë pajtuar se do të jenë pjesë e hulumtimit ua kemi dërguar pyetësonin. Pyetjet në pyetësonin e hapur kanë adresuar disa nga faktorët që mund të shkaktojnë kënaqësinë ose pakënaqësinë e tyre me punën që ata bëjnë.

Rezultatet e hulumtimit

Duke u bazuar në pyetjet kërkimore, është përcaktuar edhe natyra dhe lloji i përpunimit të të dhënave. Besueshmëria e pohimeve (35) që adresojnë kënaqësinë është ($\alpha = .888$), derisa për 22 pohimet e tjera ishte ($\alpha = .897$) kurse besueshmëria e të gjitha pohimeve është ($\alpha = .790$). Pra, Alpha e Crombah tregon besueshmëri të pranueshme të pyetësonit për të vazhduar me përpunimet e tjera.

Të dhënat e grumbulluar janë koduar dhe përpunuar në platformën e përgatitur në SPSS 23.

Faktorët të cilët sipas perceptimeve të mësimdhënësve kanë ndikim të fuqishëm në kënaqësinë në punë si dhe faktorët me ndikim më të dobët janë dhënë në tabelë.

Hierarkia e faktorëve me ndikim më të lartë në kënaqësinë e mësimdhënësve në punë

Sipas radhitjes së llojit të faktorëve të bërë nga mësimdhënësit vërehet një tendencë epërsie nga faktorët e brendshëm, nga 13 të vlerësuar, se kanë ndikim shumë të lartë. Suksesi i nxënësve, falënderimi si faktorë i jashtëm, kënaqësia për punë me nxënës, pasioni për mësimdhënien, mirënjohja për punën (i jashtëm), bashkëpunimi me kolegët, klima e mirë në shkollë dhe marrëdhëniet e mira me drejtuesit e shkollës janë faktorët kryesor që ndikojnë në kënaqësinë e tyre në punë.

Rezultatet e analizës përshkruese tregojnë se faktorët me ndikim shumë të lartë në kënaqësinë e mësimdhënësve në punë janë: suksesi i nxënësve ($M=4.82$, $DS=.444$), rang-1, pastaj falënderimet nga nxënësit ($M=4.72$, $DS=.646$), rang-2 sipas të cilëve faktorë, nga 13 gjithsej që paraqesin vlerësimin maksimal ndikim i plotë, janë të brendshëm dhe të jashtëm.

Tabela 2. Faktorët që ndikojnë në kënaqësinë e mësimdhënësve

Pohimet që ndikojnë në kënaqësinë e mësimdhënësve	N	M	DS	rang
Suksesi i nxënësve më bën krenar, motiv për punë dhe përkushtim	131	4,82	.444	1
Falënderimet nga nxënësit më bëjnë të ndihem mirë me punën që bëjë	131	4,72	.648	2
Puna me nxënës të jep kënaqësi të veçantë	132	4,69	.667	3
Mësimdhënien e konsideroj mision, kjo më përmbushë	131	4,64	.680	4
Mësimdhënia është një obligim ndaj nxënësve	128	4,60	.756	5
Pasioni që kam për mësimdhënie krijon kënaqësi	129	4,60	.713	6
Punoj për të ardhmen e vendit, kjo më bën të lumtur	131	4,60	.688	7
Mirënjohja për punën me nxënës është ndjenjë e veçantë	132	4,59	.676	8
Bashkëpunimi i sinqertë me kolegët është frymëzim për punë	131	4,58	.667	9
Promovimi i punës sime nga shkolla më bënë të ndihem mirë	132	4,56	.668	10
Mundësia që të punoj me nxënës më bën të lumtur	132	4,55	.775	11
Marrëdhëniet e mira me kolegët apo klima e mirë	132	4,55	.692	12
Marrëdhëniet e mira me drejtuesit e shkollës	132	4,51	.777	13

Sa i përket ndërlidhjes mes moshës dhe faktorit nën një kemi këtë raport, sa më e madhe të jetë grupmosha e mësimdhënësve ndikimi i suksesit të nxënësve në kënaqësinë në punë rritet. Prandaj, siç tregojnë rezultatet, ka një ndërlidhje mes moshës së mësimdhënësve dhe faktorëve të brendshëm ose të jashtëm. Përjetimi dhe perceptimi i suksesit të nxënësve si rezultat i punës me ndikim shumë të lartë në kënaqësinë në punë. Shumica nga këta faktorë janë të brendshëm. Siç tregohet në tabelën 3, te mësimdhënësit e moshës së mesme, grupmosha 31- 40 vjet, sukcesi i nxënësve ka ndikim më të fuqishëm në kënaqësinë në punë sesa te grupmoshat e tjera (rreth 28%), pastaj grupmosha mbi 50 vjet.

Tabela 3. Rritja e moshës dhe faktori i radhitur i pari i kënaqësisë në punë

	Suksesi i nxënësve më bën krenar, motiv për punë dhe Total përkushtim			Total
	Ndikim mesatar	Ndikim i lartë	Ndikim shumë i lartë	
nën-25	0	0	5	5
25-30	0	3	21	24
Mosha 31-40	3	1	37	41
41-50	0	6	23	29
mbi 50	0	8	24	32
Total	3	18	110	131

Hierarkia faktorëve që ndikojnë në pakënaqësinë e mësimdhënësve në punë sipas perceptimit të tyre

Rezultatet e kërkimit tregojnë se nga 12 faktorët që shkaktojnë pakënaqësinë në punë janë kryesisht të jashtëm. Prandaj mësimdhënësit nënvlerësimin e autoritetit të tyre e shohin me ndikim të lartë në pakënaqësinë e tyre në punë.

Tabela 4. Hierarkia e faktorëve që afektojnë pakënaqësi në punë

Pohimet për faktorët e pakënaqësisë në punë	N	M	DS	Rang
Autoriteti/respekti i mësimit në punë po nënvlerësohet çdo ditë	130	3,86	1,206	1
Braktisja e vazhdueshme e shkollimit nga nxënësit rritë pasigurinë	130	3,57	1,300	2
Përzjerja e panevojshme e politikës në shkollë	131	3,51	1,438	3
Statusi jo i kënaqshëm, nënçmues, i mësimit në shoqëri	130	3,50	1,365	4
Sjelljet e nxënësve po bëhen gjithnjë e më të papërshtatshme	130	3,41	1,173	5
Paga jo dinjitoze, me të cilën nuk mund ta mbaj familjen	129	3,33	1,277	6
Kërkesat e shumta administrative, si planifikimi, vlerësimi i nxënësve etj.	131	3,30	1,299	7
Mospërfillja e mësimit nga ana e prindërve	129	3,02	1,237	8
Raportet jo të mira/duhura me kolegët	130	3,01	1,372	9
Punë stresuese nga kërkesat e vazhdueshme për ndryshim	131	3,00	1,353	10
Përkrahje dhe trajtim jo sipas meritës nga menaxheri i shkollës	126	3,00	1,523	11
Presioni i vazhdueshëm për ri/licencim, trajnim e seminare	131	2,89	1,497	12

Por ndikim mesatar në pakënaqësinë e mësimit në punë ushtrojnë edhe sjelljet e nxënësve, paga, kërkesat administrative, mospërfillja nga prindërit, raportet jo të mira me kolegët, por edhe presioni për zhvillim profesional.

Sa i përket nivelit të pajtueshmërisë së ndikimit të llojit të faktorëve në kënaqësinë ose pakënaqësinë e mësimit në punë, sipas variablave demografike: seks, moshë dhe shkollim, rezultatet e kërkimit nuk tregojnë ndonjë diferencë domethënëse mes tyre, përveç të mësimit në grupmoshës 31-40.

Rezultatet nga të dhënat cilësore

Sa u përket përgjigjeve të mësimit dhe adresimit të llojit të faktorëve të kënaqësisë në punë, nuk dallojnë shumë nga të dhënat sasiore. Pothuajse të gjithë i kanë cekur faktorët sipas hierarkisë së dhënë. Përgjigjet në pyetjen e parë, lidhur me faktorët që ndikojnë në kënaqësinë e tyre në punë, kryesisht përmendin: mjedisin mësimor, frymën pozitive në kolektiv - raportet e mira, bashkëpunimin me kolegë, si vlera të organizatës, pastaj vlerësimi nga ana e prindërve, rezultatet me nxënësit, bashkëpunimi me udhëheqjen e shkollës, si dhe teknologjia mësimore. Gjithashtu, në kuadër të pyetjes për faktorët që

ndikojnë në pakënaqësinë e tyre në punë thuaja të gjithë listojnë mosfunksionimin e faktorëve të shkaktojnë kënaqësinë, duke shtuar edhe përzjerjen e politikës në shkollë, vlerësimin joobjektiv të mësimdhënësve nga udhëheqja e shkollës etj.

Klima pozitive në shkollë, si faktor dhe vlerë e kënaqësisë në punë

Raportet e shëndosha mes anëtarëve të kolektivit janë cekur thuajse nga të gjithë, pa marrë parasysh moshën ose përkatësinë e seksit, duke shtuar ndonjë element apo faktor të ri.

(Mf.1)² Një ambient ku ka bashkëpunim dhe mbështetje reciproke mes kolegëve ndihmon në krijimin e një atmosfere të rehatshme dhe ndihem e përkrahur. Mendoj që kolegët që ndihmojnë dhe mbështesin njëri-tjetrin, ndjenjat e kënaqësisë rriten dhe puna bëhet më e lehtë. Po ashtu, komunikimi i hapur dhe shkëmbimi i ideve dhe i eksperiencave me kolegët mund të jetë frymëzues. Ky proces mund të sjellë inovacione dhe zgjidhje të reja për sfidat që has në punën time. Ndjenja se jeni pjesë e një ekipi të përpiluar dhe me kontribut të vlefshëm mund të rrisë ndjenjën e përkatësisë dhe rritjen e vetëbesimit. Gjithashtu, ndikon që të kemi një mjedis pozitiv në shkollë, duke përfshirë marrëdhëniet e mira me kolegët. Kur ka një atmosferë pozitive dhe harmoni mes kolegëve, kjo mund të rrisë motivimin, produktivitetin dhe kënaqësinë në punë.

Mësimdhënësja, e cila i përket përvojës deri në 10 vjet ka përmbledhur disa nga faktorët që e përbëjnë klimën e përgjithshme në shkollë dhe që kanë ndikim në kënaqësinë në punë. Ndër të tjera, si pjesë e rëndësishme e klimës përmend komunikimin dhe këmbimin e ideve me kolegët, gjë që është e rëndësishme për funksionim të mirë të një shkolle.

(Mf.1.1) Mendimi që po bëj diçka në të mirë të nxënësve më bën që të jem e kënaqur që jam mësuese. Klima e re në shkollë (edhe pse ende nuk është kthyer në kulturë), bashkëpunimi me kolege, vlerësimi nga ana e prindërve (në disa raste) etj.

² Mf.1=m-mësimdhënëse, f-femër, 1-grupmosha

Edhe mësimdhënësja tjetër, përvojë të njëjtë, përveç klimës në shkollë, si element të kënaqësisë përmend faktin që punon me nxënës, gjë që i jep kënaqësinë e të qenit mësuese. Ky element i përket faktorit motivues të brendshëm, i gërshetuar edhe me faktorët e jashtëm, siç është bashkëpunimi me kolegët, si pjesë e kulturës së shkollës.

Ndërsa një mësimdhënës tjetër këtyre elementeve ua shton edhe vullnetin për punë, si dhe dëshirën e nxënësve për lëndë.

(Mm. 3) Bashkëpunimi kolegjal, mjedisi mësimor (pajisje me mjete pune); vullneti për punë; dëshira e nxënësve për lëndë shkencore.

Ky mësimdhënës i përket grup-përvojës (20-29 vjet punë) në mësimdhënie. Ndërsa dy mësimdhënës të të njëjtit grup-përvojë (30-39), përmendin edhe disa faktorë shtesë të ndërlidhur me mjedisin shkollor, klimën pozitive.

(Mm. 4) Faktori njeri më jep kënaqësi në vendin e punës dhe ambienti shkollor.

(Mm. 4.1) Fryma pozitive në kolektiv; mjedisi mësimor; raporti me kolegët; rezultatet e arritura me nxënës.

E veçantë e mësimdhënësit (Mm. 4.1) është se përmend si faktor edhe rezultatet e arritura me nxënës, gjë që ndërlidhet me rezultatet sasiore ku ky faktor radhitet ndër të parët.

Sa i përket temës së klimës pozitive dhe ndikimit në kënaqësinë në punë, pjesa më e madhe e mësimdhënësve që janë përgjigjur në këtë pyetje, pa marrë parasysh grup-përvojën e tyre, theksojnë thuaja të njëjtit faktorë, ose elemente të tyre.

Shkalla e bashkëpunimit mësimdhënës-prindër si faktor i kënaqësisë në punë

Sa u përket marrëdhënieve bashkëpunuese me prindër, rezultatet sasiore e radhësin në faktor të lartë të ndikimit kënaqësinë e mësimdhënësve. Ky faktor përmendet edhe te të dhënat cilësore. Disa nga mendimet e mësimdhënësve për rëndësinë e këtij faktori jepen në vijim.

(Mf.2) Rezultatet e mira të nxënësve; bashkëpunimi me kolegët; respektimi i rregullave të shkollës nga mësimdhënësit dhe nga nxënësit; bashkëpunimi me prindër.

Siç shihet, kjo mësimdhënëse, e grup-përvojës (11-19 vjet), ka cekur pothuajse të gjithë faktorët të cilët janë theksuar edhe në rezultatet sasiore, ndërsa bashkëpunimi me prindër është cekur dy herë. Përveç tjerash, përmend edhe çështjen e respektimit të rregullave të shkollës, faktor të cilin nuk e kemi paraparë si faktor të mundshëm për kënaqësinë e mësimdhënësve në punë. Afërsisht në frymë të ngjashme ndikimin e faktorit bashkëpunim me prindër e shohin edhe këta mësimdhënës/e.

(Mm.5) Fryma pozitive në kolektivin e shkollës sonë; mjedisi mësimor; raportet me kolegët dhe udhëheqjen e shkollës; bashkëpunimi me kolegët dhe me prindër.

(Mm.4) Fryma pozitive në kolektiv, mjedisi mësimor, raporti me kolegët, me udhëheqjen e shkollës, rezultatet e arritura me nxënës, bashkëpunimi me prindër.

(Mf.2) Fryma pozitive në kolektiv, bashkëpunimi me udhëheqësin e shkollës, raporti me kolegët e punës, bashkëpunimi me prindër, rezultatet e arritura me nxënës, pajisja me mjetet e punës janë disa faktorë që më ndihmojnë shumë që të kem një ditë pune të kënaqshme.

Që të tre pjesëmarrësit në hulumtim, në kuadër të faktorëve të tjerë të kënaqësisë në punë, bashkëpunimi me prindër zë vend të rëndësishëm. Për të krahasuar me faktorët e kënaqësisë në punë do t'i analizojmë disa nga faktorët e pakënaqësisë sipas perceptimit dhe mendimit të mësimdhënësve.

Faktorët që nxisin pakënaqësinë në punë të mësimdhënësve

Edhe sa U përket faktorëve të pakënaqësisë, mësimdhënësit kanë bërë rangimin e tyre sipas perceptimit personal. Edhe ky grup faktorësh grupohen në dy lloje kryesore: të jashtëm - rrethanorë, si dhe në faktorë të brendshëm.

(Mf.1) Udhëheqësi i shkollës nuk i trajton të gjithë mësimdhënësit në mënyrë të njëjtë. Kjo rrit ndjenjat e pakënaqësisë dhe mungesës së

drejtësisë, andaj ndonjëherë reflekton edhe në motivimin në punë dhe në performancë e punës. E shoh që jo të gjithë mësimitdhënësit kemi mundësi të barabarta për vlerësimin e punës të cilën e bëjmë, andaj ndonjëherë humbas interesin dhe entuziazmin për punë.

Sipas kësaj mësimitdhënëseje, trajtimi jo i barabartë, ose dallimet që bëhen mes mësimitdhënësve nga ana e menaxhmentit të shkollës, ndikojnë në pakënaqësinë e tyre në punë.

(Mf.1.1) Ndërhyrja e pavend nga ana prindërve, mosvlerësimi i punës së mësueses nganjëherë më bën të ndihem që puna ime nuk po vlerësohet dhe mirësia ime po kalon në naivitet.

Derisa bashkëpunimi me prindër konsiderohet faktor i kënaqësisë në punë, ndërhyrje në punët e mësimitdhënësës ndikojnë që të ndihet keq. Një tjetër mësimitdhënës, si faktorë të rëndësishëm që shkaktojnë pakënaqësinë e tij në punë janë prindërit, që nuk kujdesen sa duhet për nxënësit.

(Mm.4) Ndikon negativisht faktori njeri, pra prindërit, sepse shumë pak janë të interesuar për fëmijët e tyre në procesin mësimitor-edukativ.

Pra, si faktor, i cili do ta ndihmonte mësimitdhënësin në arritjen e suksesit me nxënë, ose edhe menaxhimin më të lehtë të klasës, e sheh në interesimin e ulët të prindërve për t'u marrë me fëmijët e tyre.

(Mm.4.1) Nëse bashkëpunimi me prindër, kolegë dhe menaxhmentin e shkollës, janë këta faktorët që nëse nuk i zbaton si mësimitdhënës nuk do të kesh suksese dhe rezultate të mirë me klasën të cilën e menaxhoj unë.

(Mf.2) Faktori bashkëpunim me prindër nëse nuk do të ishte në formën e duhur atëherë edhe puna nuk do të zhvillohet ashtu si duhet. Faktor tjetër me rëndësi është edhe digjitalizimi i shkollës, ku ne si mësimitdhënës të rinj kemi shumë nevojë dhe do të na lehtësonte punën me përdorimin e tyre.

Mësimitdhënësi me përvojë (30-39) dhe mësimitdhënësja me përvojë (11-19) vjet theksojnë mungesën e bashkëpunimit me prindër si faktor që ndikon në pakënaqësinë e tyre në punë. Ky element, faktor është vlerësuar lart te ndikimi në kënaqësinë në punë, gjë që është normale që mungesa e këtij bashkëpunimi të shkaktojë telashe gjatë punës dhe arritjes së suksesit me nxënë, si faktor që, sipas tyre, i bën ata të ndihen të kënaqur me punën e

vet. Ndërsa një mendim me interes të dhënë nga mësimdhënësja e grup-përvojës (1-10) vjet e paraqet si faktor që ndikon në pakënaqësi dhe humbjen e entuziazmit për punë vlerësimi jo i barabartë që u bëhet në shkollë, si:

(Mf.1.1) Udhëheqësja e shkollës nuk i trajton të gjithë mësimdhënësit në mënyrë të njëjtë. Kjo rrit ndjenjat e pakënaqësisë dhe mungesës së drejtësisë, andaj ndonjëherë reflekton edhe në motivimin në punë dhe në performancë të punës. Jo të gjithë mësimdhënësit kemi mundësi të barabarta për vlerësimin e punës, të cilën e bëjmë, andaj ndonjëherë humbas interesin dhe entuziazmin për punë.

Çështja e objektivitetit në vlerësim dhe qasja e barabartë në mundësitë e vlerësimit dhe të çmuarjes së kontributit është një element i rëndësishëm i kënaqësisë/i pakënaqësisë në punë. Një problem të këtillë, prezent në shkollë, e paraqet mësimdhënësja në fjalë. Ajo i përket moshës së re të mësimdhënësve, prandaj edhe nevoja për vlerësim e motivim është e shprehur.

Siç mund të shihet nga analiza e të dhënave sasiore dhe cilësore, faktorët që ndikojnë në kënaqësinë ose në pakënaqësinë e mësimdhënësve në punë janë të jashtëm dhe të brendshëm. Në grupin e faktorëve që ndikojnë në kënaqësinë në punë, sipas rangimit në bazë të vlerësimit të mësimdhënësve, vërehet një dominim i lehtë, jo domethënës, i faktorit të brendshëm, ndërkaq në grupin e faktorëve që ndikojnë në pakënaqësinë e tyre dominojnë faktorët e jashtëm.

Diskutimi i rezultateve

Qëllimi i këtij studimi ishte të identifikojë përmasën e hierarkisë e faktorëve që mund të ndikojnë në kënaqësinë dhe/ose pakënaqësinë duke u bazuar në perceptimet dhe vlerësimet e mësimdhënësve lidhur me shkallën e ndikimit të tyre në kënaqësinë dhe/ose pakënaqësinë në punë. Disa gjetje domethënëse të kërkimit janë prezantuar. Nga rezultatet domethënëse të këtij kërkimi do të përzgjidhen për diskutim ato më domethënëse, si p.sh. marrëdhënia ndërmjet variablave demografike dhe faktorëve që ndikojnë në

kënaqësinë ose pakënaqësinë në punë dhe variablat e tjera të rëndësishme për praktikën e hulumtimit.

Faktorët kryesorë të kënaqësisë në punë

Bazuar në rezultatet e kërkimit, si në skemën - figurën 2, faktorët e jashtëm ndikojnë në motivimin e brendshëm apo në kënaqësinë në punë të mësimit. Gjithashtu, bazuar në këto rezultate, sa më e mirë që të jetë klima pozitive në shkollë, raportet mes anëtarëve të komunitetit të brendshëm shkollorë, kënaqësia në punë është më e lartë dhe anasjelltas.




Figura 2. Disa nga faktorët e rëndësishëm të kënaqësisë së mësimit në punë

Skema në figurën 2 paraqet disa nga faktorët më të shpeshtë të potencuar nga mësimit, si të rezultatet sasore ashtu edhe të ato cilësore. Raportet, apo fryma pozitive, në kolektiv si faktor i mjedisit shkollor, i cili është përmendur edhe në studimin e Gkolia Dimitrios, & Athanasios

Koustelios (2014), del të jetë faktor i rëndësishëm për kënaqësinë e mësimit në punë. Po ashtu, sipas rezultateve të hulumtimit të tyre (2014), marrëdhëniet e këqija ndërpersonale me kolegët janë një tjetër arsye e pakënaqësisë në punë. Marrëdhëniet jo të mira ose jo mbështetëse dhe konfliktet me kolegët dhe/ose mbikëqyrësit çojnë në synime negative psikologjike që rezultojnë në pakënaqësi në punë (Gkolia Dimitrios, & Athanasios Koustelios, 2014, f. 323). Ngjashëm kanë deklaruar edhe mësuesit e përfshirë në mostër, ose e kanë përshkruar në përgjigjet me shkrim. Ky rezultat është në koherencë edhe me gjetjet e Dat Tran & Lam Le (2015) sa i përket faktorit mjedis shkollor, gjë që sipas kësaj ka lidhje domethënëse me liderшипit të drejtorit ($r=.68$), interesit profesional ($r=.66$) me kënaqësinë në punë të mësimit në punë (Dat Tran & Lam Le, 2015, f. 41). Një element që e theksojnë mësuesit e mostrës është edhe ulja e autoritetit të mësimit në shoqëri, por edhe përzierja e politikës në shkollë, si faktorë të jashtëm që ndikojnë në pakënaqësinë e tyre në punë.



Figura 3. Faktorët e pakënaqësisë në punë

Këtë element, faktor, nuk e kemi hasur në literaturën e shqyrtuar, sikurse paraqitet në skemën - figurën 3.

Siç shihet nga skemat 2 dhe 3, hierarkia e faktorëve që ndikojnë në kënaqësinë ose pakënaqësinë e mësimdhënësve në punë, sipas perceptimeve dhe deklaratimit të pjesëmarrësve në mostër, janë të përafërta me studimet e shqyrtuara nga literatura. Gjithashtu, është në përputhje me teorinë e motiv-higjienës të Herzberg (1960). Sipas kësaj teorie, Herzberg faktorët e mjedisit punues dhe raportet apo klima në organizatë janë vendimtar për shkallën e kënaqësisë së mësimdhënësve (punëtorëve në përgjithësi) në rrethanat në të cilat punojnë (Latham, 2007), vendin e punës.

Përfundime dhe rekomandime

Rezultatet e kërkimit nxjerrin në pah disa porosi të rëndësishme që duhet të adresohen te mësimdhënësit, në veçanti te udhëheqësit e shkollës dhe politikëbërësit. Në deklaratat e tyre mësimdhënësit radhisin suksesin e nxënësve dhe klimën pozitive në shkollë, si faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në kënaqësinë e tyre në punë. Suksesi i nxënësve, si faktor i kënaqësisë në punë, varet nga mësimdhënësi, por në masë të madhe edhe nga faktorët e tjerë. Prandaj, ata i kanë listuar klimën dhe raportet me kolegët, me prindërit dhe udhëheqësit e shkollës. Gjithashtu, radhitja e faktorëve që ndikojnë në pakënaqësinë e mësimdhënësve në punë është me interes të adresohet. Ulja e autoritetit të mësimdhënësit, si faktor domethënës i pakënaqësisë, është tejet indikativ që duhet të adresohet brenda dhe jashtë shkollës. Këtë faktorë, si dhe faktori përzierja e politikës në shkollë, nuk i adreson teoria e Herzberg-ut.

Hulumtimi arriti të identifikojë faktorët kryesorë, të jashtëm dhe të brendshëm, që ndikojnë në shkallën e kënaqësisë dhe/ose të pakënaqësisë së mësimdhënësve në punë. Mbetet detyrë, por edhe nxitje për hulumtime të tjera në elaborimin dhe zbërthimin më të thelluar të disa nga faktorët e eksploruar, të cilët afektojnë përmbushjen e mësimdhënësve gjatë punës me nxënës. Nga niveli dhe cilësia e përmbushjes së faktorëve të kënaqësisë varet

në masë të madhe edhe cilësia e punës që ata bëjnë me nxënës. Lidhur me këtë propozojmë rekomandimet në vijim, përmbushja e së cilave do të duhej të ishte prioritet institucional dhe shoqëror.

Rekomandimet

Bazuar në rezultatet kërkimore dalin disa rekomandime për shkollën dhe politikat arsimore, si:

- Të investohet më shumë në kulturën e punës në institucionet arsimore, sidomos në krijimin e klimës, të frymës pozitive në institucion, si një vlerë e shtuar;
- Të eliminohet faktori i jashtëm, si interferimet politike që sipas mësimdhënësve, në rangun e tretë, ndikojnë në krijimin e pakënaqësisë në punë të mësimdhënësve;
- Të rriten cilësia dhe niveli i bashkëpunimit dhe i komunikimit me komunitetin e prindërve;
- Të ketë qasje korrekte dhe të barabartë ndaj vlerësimit të kontributit individual të mësimdhënësve duke ia njohur meritat secilit, si dhe;
- Nevojitet një mobilizim tërëshoqëror për ruajtjen dhe kultivimin e figurës dhe të autoritetit të mësimdhënësit në shoqëri, duke promovuar faktorët e kënaqësisë në punë.

Përfundimet dhe rekomandimet mund të shfrytëzohen si referenca orientuese të politikave dhe të praktikave të udhëheqjes së shkollës, por edhe të bërjes së politikave, të cilat shmangin faktorët ose situatat të cilat shkaktojnë pakënaqësi ose të promovimit të faktorëve që përmbushin mësimdhënësit gjatë procesit të punës.

Literatura³

- Crehan, L. (2016). Exploring the impact of career models on teacher motivation, UNESCO
- Demir, S. (2020). The Role of Self-Efficacy in Job Satisfaction, Organizational Commitment, Motivation and Job Involvement, *Eurasian Journal of Educational Research* 85, pp. 205-224, DOI: 10.14689/ejer.2020.85.10.
- Federici, R. A. & Skaalvik, E. M. (2012). Principal self-efficacy: relations with burnout, job satisfaction and motivation to quit, *Social Psychology of Education*, 15:295–320, DOI 10.1007/s11218-012-9183-5.
- Gkolia Dimitrios, A. & Athanasios Koustelios, B. (2014). Teacher's job satisfaction and self-efficacy: a review, *European Scientific Journal* August 2014 edition vol.10, No.22 ISSN: 1857 – 7881 (Print) e - ISSN 1857- 7431
- Guskey, Th. R. (2002). 'Professional Development and Teacher Change', *Teachers and Teaching: theory and practice*, Vol. 8, No. 3/4, 381-391, Article link: <http://dx.doi.org/10.1080/135406002100000512>.
- Latham, G. P. (2007). *Work motivation, History, theory, research, and practice*, Sage, London etj.
- Maele, D.V., & Houtte, M.V. (2012). The role of teacher and faculty trust in forming teachers' job satisfaction: Do years of experience make a difference? *Teaching and Teacher Education*, 28 (879-889).
- Maria, T. L., & Eve Bauer, C. (2017). Second career teachers: Job satisfaction, job stress, and the role of self-efficacy, *Teaching and Teacher Education* 67, pp. 389-398.
- Menon, M. E. & Saitis, Ch. (2006). Satisfaction of Pre-service and In-service Teachers with Primary School Organization, *Educational Management Administration & Leadership* ISSN 1741-1432 DOI: 10.1177/1741143206065269, SAGE Publications (London, Thousand Oaks and New Delhi), downloaded, 13.01.2018.
- Pappas, E. (2015). A Theory of Intrinsic Learning: Fundamental Concepts, *Social Science Today* Volume 2, Issue 1 (2015), 21-32 ISSN 2368-7169 E-ISSN 2368-7177 Published by Science and Education Centre of North America. Downloaded, 12.01.2018.

³ Disa referenca janë dhënë këtu me qëllim të ndihmës së autorëve që t'i shfrytëzojnë në hulumtimet e veta të kësaj natyre.

- Potera, I., & Mehmeti, F. (2019). Relation between teachers' job satisfaction and their motivation for professional development, *Turkish Studies-Educational Science*, Volume 14 Issue 4, ISSN: 2667-5609
- Ryan, M., Deci, E. L. (2000). Self-determination Theory and the facilitation of Intrinsic motivation, Social development, and well-being, *American Psychological association*, Vol.55, No 1, 68-78.
- Sansone, C., & Harackiewicz, J. M. (2000). Intrinsic and Extrinsic Motivation, The Search for Optimal Motivation and Performance, Academic Press, California, USA.
- Skaalvik, E.M., & Skaalvik, S. (2011). Teacher job satisfaction and motivation to leave the teaching profession: Relations with school context, feeling of belonging, and emotional exhaustion, *Teaching and Teacher Education* 27 (1029-1038).
- Skaalvik, E. M. (1997). Self –enhancing and self-defeating Ego orientation: Relations with task and avoidance orientation, achievement, self-perceptions, and anxiety, *Journal of educational Psychology* Vol.89, No 1, p.71-81.
- Stride, C. , Wall, T. D., & Catley, N., 2nd edit. (2007). Measures of job Satisfaction, Organizational Commitment, mental Health and Job-related Well-being, *John Wiley & Sons Ltd*, England.
- Tran, Van Dat & Le, M. T. Lam. (2015). School Environment Factors as Predictors for Teachers' Teaching Efficacy, Teacher Stress and Job Satisfaction, *International Education Research* Volume 3, Issue 2 (2015), 28-46 ISSN 2291-5273 E-ISSN 2291-5281 Published by Science and Education Centre of North America, download 13.01.2018.
- Troesch, L.M., Bauer, C. E. (2017). Second career teachers: Job satisfaction, job stress, and the role of self-efficacy, *Teaching and Teacher Education*, 67 (389-398).
- Wasserman, E., & Maymon, Z. (2017). The Correlation between Professional Development and Teacher's Self-Efficacy, *International Education Research*, Volume 5, No. 1 (2017), 1-12 ISSN 2291-5273 E-ISSN 2291-5281 Published by Science and Education Centre of North America, downloaded 12.01.2018.

PËRVOJAT E SHKOLLAVE PËR ORIENTIM NË KARRIERË TË NXËNËSVE

Skender Mekolli

Abstrakt

Orientimi në karrierë është një vendim i rëndësishëm jetësor që i vendos të rinjtë përballë dilemave të shumta për shkollimin e mëtejshëm për përcaktimin e profesionit të ardhshëm. Nxënësi në përfundim të arsimit të detyrueshëm duhet të bëjë zgjedhje për të ardhmen e tij profesionale, duke marrë vendime për veten dhe jetën e tij. Ai nuk është i informuar mjaftueshëm me llojin e profileve arsimore që ofrohen dhe me situatën në tregun e punës. Në këtë aspekt, roli i shkollës është i pamohueshëm. Ajo ka kuadër profesional të aftësuar, puna e të cilit gjatë mësimit nënkupton edhe aktivitete për informim dhe orientim profesional të nxënësve, duke i përgatitur ata për jetë dhe punë profesionale.

Qëllimi i studimit është të analizojë dhe të identifikojë përvojat e shkollave për orientim profesional të nxënësve në zgjedhjen e profesionit, informimin e tyre, mbështetjen dhe bashkëpunimin me prindër për orientim profesional dhe të ofrojë rekomandime të bazuara në gjetjet e studimit.

Për realizimin e hulumtimit është përdorur qasja sasiore dhe cilësore. Të dhënat sasiore janë mbledhur nga pyetësorët me mësimdhënës dhe pyetësorët me nxënës. Edhe të dhënat cilësore janë mbledhur nga pyetjet e hapura të pyetësorëve përkatës. Mostra është e rastit, nga popullacioni i nxënësve të klasave të 9-ta dhe mësimdhënësit që punojnë me këta nxënës në rajonin e Prishtinës, nga vendbanimet urbane dhe rurale.

Nga gjetjet e hulumtimit rezulton se numri më i madh i rasteve orientimin dhe edukimin në karrierë për nxënësit e shkollës së tyre e realizojnë përmes lëndës zgjedhore dhe aktiviteteve të veçanta kurrikulare, kurse angazhimi i ekspertëve të jashtëm për këshillim dhe orientim në karrierë realizohet në një shkallë më të ulët.

Për një orientim të drejtë në shkollim, më shumë se 2/3 e nxënësve dhe e mësimdhënësve deklarojnë se rezultatet e nxënësit janë ato që duhet të merren parasysh më së tepërmi në zgjedhjen e shkollimit dhe orientimit të ardhshëm, pastaj është zgjedhja e vetë nxënësit dhe faktori ekonomik që ka të bëjë me mundësinë për të gjetur punë dhe fitim.

Nga analiza e të dhënave dhe diskutimet me palët e interesit, kanë dalë përfundimet dhe rekomandimet për organizimin e informimit, edukimit dhe këshillimit më karrierë për institucionet relevante.

Fjalët çelës: mësimdhënësit, nxënësit, orientimi në karrierë, përvojat, profesioni, shkollat.

The experiences of schools for students' career orientation

Skender Mekolli

Abstract

Career orientation is an important life decision that puts young people in front of multiple dilemmas for further education to determine their future profession. At the end of compulsory education, the student must make choices for his professional future, making decisions about himself and his life. He is not sufficiently informed about the type of educational profiles offered and the situation in the labor market. In this respect, the role of school is undeniable. It has qualified professional staff, whose work during the lesson also includes activities for information and professional orientation of students, preparing them for life and professional work.

The purpose of the study is to analyze and identify the experiences of schools for vocational guidance of students in choosing a profession, informing them, supporting and cooperating with parents for vocational guidance and to offer recommendations based on the findings of the study.

The quantitative and qualitative approach was used for the research. Quantitative data were collected from questionnaires with teachers and questionnaires with students. Qualitative data have also been collected from the open questions of the respective questionnaires. The sample is random, from the population of 9th grade students and teachers who work with these students in the region of Pristina, from urban and rural settlements.

From the findings of the research, it results that in the largest number of cases career guidance and education for the students of their school is carried out through the elective course and special curricular activities, while the engagement of external experts for career counseling and guidance is carried out on a lower scale.

For a fair orientation in education, more than 2/3 of the students and teachers declare that the student's results are what should be taken into account the most in the choice of education and future orientation, then it is the choice of the student himself and the economic factor related to the possibility of finding work and earning.

From the analysis of the data and the discussions with the stakeholders, the conclusions and recommendations for the organization of information, education and career counseling for the relevant institutions have emerged.

Keywords: teachers, students, career guidance, experiences, profession, schools.

Hyrje

Me rritjen e mundësive profesionale dhe me zhvillimin e vazhdueshëm të profesioneve të reja, vendimet për zgjedhjen e profesionit bëhen gjithnjë e më komplekse. Vështirësitë para ose gjatë zgjedhjeve të arsimit dhe karrierës mund të shkaktojnë stres dhe tension, ndërsa shmangia ose shtyrja e procesit të vendimmarrjes mund të rezultojë në marrjen e vendimit nga dikush tjetër në vend të individit (Gati & Saka, 2001).

Zgjedhjet e shumta të gabuara të karrierës, zhgënjimet, pakënaqësitë, bredhjet dhe ndryshimet e shpeshta të shkollës dhe përsëritjet e klasës flasin shumë për rëndësinë e pyetjes se ku duhet shkuar pas shkollimit të obligueshëm. Nxënësit e klasave të nënta nuk janë mjaft të pjekur për të marrë vendime për zgjedhjen e një profesioni të ardhshëm. Në këtë moshë i riu nuk ka ende një imazh të qartë për veten, mundësitë dhe aftësitë e tij, dhe nuk është i informuar mjaftueshëm me situatën në tregun e punës, llojet e vendeve të punës dhe numrin e profileve arsimore që ofrohen. Prandaj, duhet kushtuar kujdes informimit të drejtë dhe të gjithanshëm të nxënësve, duke ua bërë të ditur se janë prirjet e tyre, aftësitë dhe faktorët e tjerë, si shëndeti, kushtet ekonomike apo rrethana të tjera sociale, që duhet të dominojnë në raport me dëshirat e tyre (Shala & Mekolli, 2018).

Orientimi profesional paraqet shqetësim edhe për prindërit. Familja, si një ndër faktorët më të rëndësishëm të zhvillimit të fëmijës, është jetësisht e interesuar për informimin dhe orientimin profesional të fëmijës për përparimin dhe zhvillimin e gjithanshëm të tij. Te një numër relativisht i madh i të rinjve, zgjedhja e profesionit bëhet kryesisht nën ndikimin e prindërve, prandaj është e dëshirueshme që të fillohet sa më herët me informimin dhe përgatitjen e fëmijëve për profesionin e ardhshëm. Kjo mund të arrihet vetëm nëse prindërit e përcjellin sistematikisht zhvillimin e fëmijëve të tyre dhe kështu kanë mundësi t'i zbulojnë prirjet e tyre, e në përputhje me to t'i orientojnë në drejtime përkatëse (Dërvodeli, 1997).

Në procesin e vendimmarrjes së nxënësve për orientim në karrierë, rol të rëndësishëm luajnë mësimitdhënësit. Mbështetja nga mësimitdhënësit mund të bëhet kryesisht përmes ofrimit të përmbajtjeve mësimore që kanë për qëllim

informimin dhe orientimin profesional, përmes lëndës zgjedhore *Orientim në karrierë*, si dhe përmes organizimit të aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare me nxënës.

Mësimdhënësit janë përgjegjës për t'i orientuar nxënësit në mënyrën më të mirë të mundshme. Ata duhet të jenë në gjendje t'u përgjigjen pyetjeve të tyre, si dhe atyre të prindërve të tyre. Përgjigjet e tyre, idetë, pritjet, mund të ndikojnë në zgjedhjen profesionale të të rinjve, për të cilët ata janë përgjegjës. Prandaj, ata duhet të jenë të vetëdijshëm se luajnë rol me rëndësi për orientim në karrierë. Ata, gjithashtu, duhet të jenë vazhdimisht të përditësuar me trajnime të reja, me rrethana të reja, por edhe me informacionet për profesione të reja. Bota profesionale po ndryshon me shpejtësi të madhe dhe shkolla duhet të ndjekë këtë evolucion për t'u paraqitur nxënësve të saj një botë profesionale sa më në përputhje me realitetin (Grauffel, 2016).

1. KONTEKSTI TEORIK

Zhvillimi, edukimi dhe orientimi për karrierë janë ndër çështjet më të rëndësishme jetësore. Zhvillimi për karrierë, siç përshkruhet nga Brown (2002), është një proces i zgjedhjes së një mundësie midis shumë profesioneve që janë në dispozicion në një shoqëri.

Orientimi në karrierë u referohet një sërë aktiviteteve, të cilat janë përcaktuar për të ndihmuar të rinjtë të zgjedhin drejtimet e tyre në arsim dhe punë dhe të përmbushin synimet e karrierës së tyre. Për këtë arsye, orientimi për karrierën është një çështje e rëndësishme e politikave për të gjitha vendet.

Sipas Rezolutës të 2004 të BE-së mbi Orientimin, orientimi i referohet një radhë aktiviteteve dhe u mundëson qytetarëve të çdo moshe dhe në çdo fazë të jetës së tyre të identifikojnë kapacitetet, kompetencat dhe interesat e tyre, për të marrë vendime mbi arsimimin, zhvillim të aftësive dhe profesionit, dhe për të menaxhuar rrugët e jetës individuale në mësim, punë dhe fusha të tjera, në të cilat mësohen dhe përdoren këto kapacitete dhe kompetenca (Rezoluta e BE-së, 2004).

Qendra Evropiane për Zhvillimin e Arsimit Profesional e përkufizon përgjithësisht orientimin në karrierë si "një grup aktivitete të ndërlidhura që synojnë ofrimin e strukturuar të informacionit dhe shërbimeve, në mënyrë që t'u mundësojë individëve dhe grupeve të çdo moshe të bëjnë zgjedhje në lidhje me arsimin, trajnimin ose një rrugë karriere" (CEDEFOP, 2019).

Orientimi për karrierë është bërë pjesë e rëndësishme e politikave të arsimit dhe punësimit në të gjitha vendet. Elementët përbërës të orientimit për karrierën janë informacioni për karrierën, edukimi për karrierën dhe këshillimi për karrierën.

Informimi për karrierën - konsiston në dhënien sistematike të informacionit të interesuarve për ofertën e AAP-së, kualifikimet e lidhura me profesionet e ndryshme, ofertën dhe kërkesën e tregut për këto profesione, shtigjet e karrierës që mund të ndjekë nxënësi në vijim të drejtimit profesional në AAP etj. Informacioni për karrierën është baza për ofrimin e shërbimeve të orientimit në karrierë. Ai përfshin të gjithë informacionin që i ndihmon njerëzit të bëjnë edukim të informuar, trajnim dhe zgjedhje profesionale gjatë gjithë jetës së tyre të punës. Një Qendër Informacioni për Karrierën mund të variojë nga një koleksion minimal burimesh të lidhura me karrierën, të vendosura në një seksion të një dhome të vetme, deri në një strukturë me shumë qëllime që strehon një koleksion të madh burimesh në të tre formatet (Swamy, D., Umesha, M. B. and Ramasesh, C. P). Informimi për karrierën përfshin informacionin për tregun e punës, programet e studimit, vendet e punës dhe drejtimit të mundshme të karrierës. Informacioni mund të bëhet me publikime/broshura, fletëpalosje, video-klipe, dokumentarë, përmes internetit etj.

Edukimi për karrierën - u referohet aktiviteteve që zhvillon shkolla për të ndihmuar nxënësit për orientim në karrierë, përmes fitimit të njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe sjelljeve për të menaxhuar jetën e tyre, të mësuarit dhe të punuarit. Edukimi për karrierën është përgjithësisht pjesë e kurrikulës përmes qasjes ndër kurrikulare apo si lëndë e veçantë, por, gjithashtu, edhe pjesë e aktiviteteve jashtë kurrikulare, ku nxënësit ftohen të marrin pjesë në "javën e karrierës" ose në panairë të karrierës, të vizitojnë vende pune, të ndjekin prezantime/biseda me prindër, me sipërmarrës etj.

Këshillimi për karrierën - ka për qëllim t'i ndihmojë nxënësit në marrjen e vendimeve për orientim në karrierë. Këshillimi kryhet në baza individuale ose në grupe të vogla, ku vëmendja fokusohet te problemet apo zgjedhjet specifike në lidhje me karrierën, me të cilat ballafaqohen nxënësit.

Për ndryshim nga dy elementet e para, që mund të ofrohen nga mësimdhënës apo staf jo i specializuar, këshillimi kërkon angazhimin e personave të specializuar (p.sh. psikologu i shkollës), apo ekspertëve të fushave të ndryshme.

Ofrimi aktual i shërbimeve të udhëzimit për karrierë në Kosovë mund të konsiderohet si i pamjaftueshëm dhe shumë modest, larg nga të qenit i krahasueshëm me shtetet e BE-së, madje edhe me ndonjë shtet fqinj në Evropën Juglindore. Këto shërbime janë duke u themeluar përbrenda institucioneve arsimore (Ofruesit e Arsimit të Lartë dhe Shkollat e Arsimit dhe Aftësisit Profesional - AAP) dhe tek institucionet, të cilat ofrojnë Shërbime për Vende Përkatëse Pune (Shërbimet Publike për Punësim - SHPP dhe portalet online për punësim). Fushëveprimi dhe shkalla e shërbimeve për karrierë, të ofruara nga këta aktorë, aktualisht janë shumë të dobëta për të adresuar në mënyrë efektive një numër të konsiderueshëm të përfituesve, prandaj numri i nxënësve/studentëve dhe punëkërkuësve të cilët pranojnë shërbime të këshillit për karrierë është i limituar. Megjithatë, janë krijuar disa modele nismash të Udhëzimit dhe Këshillimit për Karrierë, të ndërmarra gjatë dekadës së fundit në Kosovë nga ofruesit e arsimit të lartë, Shkollat AAP, Shërbimet Publike për Punësim dhe portalet private për punësim (EYE, 2014).

Kurrikula Bërthamë e Arsimit të mesëm të ulët, në kuadër të fushës Jeta dhe puna, përfshin Këshillimin dhe orientimin në karrierë. Këshillimi dhe orientimi në karrierë zhvillon te nxënësi aftësi për të zbuluar mundësitë e karrierës, me qëllim vendimmarrjeje për shkollimin e mëtejshëm në përcaktimin e profesionit të ardhshëm. Nxënësit informohen mbi tregun e punës dhe planifikimin për orientim profesional (Kurrikula Bërthamë, 2026).

Sipas Strategjisë së Arsimit 2022-2026 (2022), duke pasur parasysh faktin se këshillimi dhe orientimi në karrierë është shumë i rëndësishëm për një sistem funksional të AAP-së në vend, akti nënligjor për shërbimet e këshillimit në karrierë do të hartohet, standardet e cilësisë të shërbimeve të këshillimit në karrierë do të përcaktohen dhe kapacitetet e IAAP-ve për shërbimet e këshillimit dhe orientimit në karrierë do të rriten. Masa të veçanta do të ndërmerren edhe për promovimin e rëndësisë së AAP-së, si zgjidhje atraktive e aftësisë për punë dhe jetë, si dhe për inkurajimin e pjesëmarrjes së nxënësve, nga kategoritë e cënueshme sociale, sidomos për vajzat dhe gratë, të rinjtë me aftësi të kufizuara, si dhe grupet e nënpërfaqësuarat përmes bursave dhe stimujve të tjerë (Strategjia e Arsimit, 2022-2026).

Shkolla ofron mjedis ideal për të punuar në nxitjen e pjekurisë profesionale të nxënësve dhe ofrimin e ndihmës për të vendosur për një profesion të ardhshëm. Në shkollë është e mundur të organizohen një sërë aktiviteteve orientimi profesional që mund të drejtohen nga punonjësit të shkollës (për shembull, mësues të klasës, psikologë, pedagogë) ose bashkëpunëtorë të jashtëm dhe ekspertë që merren me orientimin profesional të të rinjve. Aktivitete të tilla mund të përfshijnë ofrimin e informacionit bazë për nxënësit përmes prezantimit të programeve të mëtejshme arsimore ose mundësive të punësimit, kryerjen e seminareve për të inkurajuar pjekurinë profesionale dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e zhvillimit të karrierës, referime në faqet e internetit ose qendrat e orientimit të karrierës, duke ofruar njohuri për cilësitë e veta, të rëndësishme për zgjedhjen e një karriere dhe dhënien e këshillave specifike për një profesion të përshtatshëm për nxënësin. Aktorë të ndryshëm mund të ofrojnë lloje të ndryshme të aktiviteteve të orientimit në karrierë, nga aktivitetet e njehershme deri tek ato të një natyre të vazhdueshme (Babarović & Šverko, 2017).

Për orientim në karrierë rol të madh kanë mësuesit, përmes praktikave të mësimit, përmes ofrimit të përmbajtjeve mësimore që kanë qëllim informimin dhe orientimin profesional, si dhe përmes organizimit të aktiviteteve të lira dhe aktiviteteve jashtë kurrikulare me nxënësit, duke i informuar për rëndësinë e orientimit dhe këshillimit për karrierën. Ky proces

fillon që në fëmijërinë e hershme në familje dhe institucione parashkollore, për të vazhduar pastaj në institucione shkollore, ku rol të madh luajnë mësuesit, duke informuar nxënësit, me synim ofrimin e mundësive që të zhvillojnë personalitetin, të përgatitën për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe të marrin orientim të drejtë për profesion (Hasani, 2022). Shkolla ka mundësi të mëdha për formimin e personalitetit për jetë dhe punë të ardhshme profesionale, si: formimi i qëndrimit të drejtë ndaj punës, zhvillimi i shprehive për punë, si dhe informimi dhe këshillimi profesional në kohë të duhur (Dërvodeli, 1997).

Mbështetja përmes kurrikulës dhe këshillimi për karrierë duhet të përfshihen që në fazat e hershme të edukimit. Kjo ndikon në rritjen e produktivitetit të institucioneve shkollore përballë mundësive të karrierës. Nxënësit, të cilët kanë plane apo vizione të karrierës, kanë më shumë tendencë që të qëndrojnë në shkollë dhe të përfshihen më shumë në edukimin e tyre (Brown & Brown, 2012; Eurydice, 2014).

Qëllim i përgjithshëm i shkollave është të lehtësojnë kalimin prej nivelit të mesëm të ulët në atë të mesëm të lartë, në nivelin e studimeve, si dhe në tregun e punës. Kjo mund të arrihet si përmes formësimit të njohurive dhe shkathësive të përgjithshme, ashtu edhe nëpërmjet orientimit dhe zgjedhjes së aktiviteteve dhe lëndëve, të cilat janë në fushën e interesit dhe aftësive të nxënësve.

Pedagogët dhe psikologët, duke parë potencialin e përgjithshëm të nxënësve, mund t'u ofrojnë atyre mbështetje emocionale dhe biseda lidhur me karrierën. Për më tepër, ata mund t'i orientojnë nxënësit që kanë prirje për lëndën e tyre, duke u siguruar mundësi për eksplorim mbi fushën e caktuar, me qëllim të ofrimit të saktë të informacionit mbi atë profesion (Allowey, Delley, Patterson, Walker, & Lenoy, 2004). Pedagogu i shkollës ka mundësi më të mira dhe më të mëdha të zbulojë vështirësitë ekzistuese në orientimin profesional, arsimon nxënësit dhe ndërmerr masa të duhura, duke koordinuar punën në realizimin e detyrave të orientimit profesional të nxënësve (Nuredini, 1999).

Mbështetje të vlefshme mund të japin edhe psikologët shkollorë dhe këshilltarët e karrierës, të cilët vlerësojnë zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve, interesat e tyre, aftësitë e tyre fizike dhe psikologjike dhe faktorët e tjerë personalë dhe mjedisorë, si dhe mund t'i informojnë për të gjitha mundësitë që ekzistojnë, me qëllim të mbështetjes për plane në drejtimin e karrierës. Pra, ata mund të bëjnë një vlerësim të nxënësve dhe përshtatshmërinë e tyre me fusha të caktuara. Kjo gjë mund të bëhet përmes vëzhgimeve brenda dhe jashtë klasës, testeve të karrierës, bisedës me mësimdhënës, prindër dhe aktorë të tjerë. Në këtë mënyrë, psikologët shkollorë dhe këshilltarët e karrierës mund t'i ndihmojnë të rinjtë të kanalizojnë më mirë mendimet e tyre (Suryadi, Sawitri, & Hanifa, 2018).

Prindërit janë këshilltarët dhe drejtuesit e parë të fëmijës së tyre në rrugën e tij të jetës, duke përfshirë rrugën e zhvillimit të tij profesional. Roli i tyre është i orientuar që t'i përgatisë fëmijët për jetë dhe në këtë mënyrë edhe zgjedhjen e duhur të profesionit. Mbështetja e prindërve konsiston në diskutimin lidhur me planet e fëmijëve për karrierë, me ofrimin e informatave rreth profesionit që fëmijët preferojnë, si dhe me pajtueshmërinë mbi zgjedhjen profesionale të fëmijëve të tyre (Jemini-Gashi, 2014).

Hulumtimet tregojnë se përkrahja e përgjithshme psiko-sociale prindërore, pra tregimi i një interesimi të vazhdueshëm për fëmijët ndikon më shumë të vendimmarrja në karrierë sesa sjelljet specifike në këtë drejtim (Keller & Whiston, 2008). Sipas një studimi tjetër nga Palos & Dabrot (2010), rezulton se prindërit preferojnë më shumë mbështetjen sociale sesa të marrin ndonjë veprim konkret për të orientuar vendimmarrjen e fëmijëve. Ata e konsiderojnë më të rëndësishme që fëmija ta gjejë vetë atë çfarë e ndjen të nevojshme dhe prindërit vetëm të jenë aty që ta përkrahin atë në çdo aspekt.

Në një linjë të drejtë me këto studime, rëndësia e familjes është theksuar edhe në kontekstin tonë. Një studim i bërë në Kosovë (Jemini-Gashi, 2013) ka treguar rëndësinë dhe ndikimin e lartë të faktorëve kontekstualë. Rezultatet nga ky studim tregojnë rëndësinë e faktorëve socialë në sigurinë e vendimmarrjes. Mbështetja familjare në çdo studim të realizuar në Kosovë del të jetë faktori me ndërlidhje më të lartë, madje edhe si faktori më

parashikues për sigurinë e vendimmarrjes për karrierë në mesin e të rinjve (Jemini-Gashi, 2014). Në një studim tjetër nga Jemini Gashi, Hyseni Duraku dhe Kelmendi (2019), të rinjtë kosovarë me mungesë të mbështetjes familjare kanë raportuar nivele të larta të pavendosmërisë për karrierë. Fëmijët që kanë mbështetjen e prindërve dhe që më parë kanë formuar edhe qëndrim të drejtë për punën, do të kenë shumë më pak probleme, sidomos në rastin kur duhet të orientohen në karrierë (Dërvodeli, 1997).

Gjetjet e studimeve në mënyrë të vazhdueshme theksojnë rolin që ka familja në procesin e zhvillimit, planifikimit dhe vendimmarrjes së të rinjve për karrierë. Për prindërit, shpesh është e vështirë të dinë se çfarë roli duhet të luajnë në orientimin arsimor të fëmijës së tyre. Është krejt e natyrshme të kesh frikë nga papunësia dhe të duash ta drejtosh fëmijën drejt një pune "të sigurt", por profesionet që punësojnë sot nuk do të jenë domosdo të njëjtat në vitet apo dekadën e ardhshme. Për më tepër, duke dashur me çdo kusht ta shtyjë fëmijën në një sektor që nuk korrespondon me shijet dhe aftësitë e tij, prindi rrezikon ta çojë atë në dështimin e shkollës. Prandaj, roli i prindërve konsiston mbi të gjitha në informimin e fëmijëve për llojet e ndryshme të profesioneve, këshillimin dhe mbështetjen e tyre në ndërtimin e projektit të tyre, duke marrë parasysh shijet e tyre dhe mënyrën se si ata parashikojnë të ardhmen e tyre (<http://www...>).

Bashkëmoshatarët dhe miqtë kanë rol të veçantë në procesin e vendimmarrjes në lidhje me karrierën. Gjatë viteve të para të jetës, familja dhe shkolla luajnë rol të rëndësishëm në formimin e identitetit, qëndrimeve dhe besimeve të fëmijës. Sidoqoftë, gjersa fëmija rritet, bashkëmoshatarët marrin përsipër të ndikojnë në bindjet ndaj botës së jashtme, duke përfshirë stilin e jetës, arsimin, madje dhe karrierën. Ky ndikim nga shokët e shoqet dhe nevoja për pranim shoqëror është më e theksuar në periudhën e adoleshencës (Zarrett & Eccles, 2006).

Roli i bashkëmoshatarëve në procesin e vendimmarrjes së të rinjve për karrierë është vënë në pah edhe nga studimet e realizuara në Kosovë. Gjatë një studimi të Jemini – Gashi (2014), është parë se të rinjtë me mbështetje nga bashkëmoshatarët kanë raportuar siguri më të lartë në vendimmarrje për karrierë, përderisa ata me mungesë të kësaj mbështetjeje, kanë raportuar

pavendosmëri për karrierë në nivele të larta (Jemini – Gashi, Hyseni Duraku & Kelmendi, 2019).

Qëllimi i studimit

Qëllimi i studimit është të analizojë dhe të identifikojë përvojat e shkollave për orientim profesional të nxënësve në zgjedhjen e profesionit, informimin e tyre, mbështetjen dhe bashkëpunimin me prindër për orientim profesional dhe të ofrojë rekomandime të bazuara në gjetjet e studimit.

Pyetjet e hulumtimit

1. Sa janë të informuar nxënësit për orientimin në karrierë?
2. Cilat janë përvojat e shkollave në orientimin e drejtë profesional?
3. Çfarë është mbështetja e mësimdhënësve për orientim profesional?

2. METODOLOGJIA

Modeli i hulumtimit

Modeli i hulumtimit është përshkruar, me qasje të përzier - cilësore dhe sasiore. Për të arritur qëllimin dhe objektivat e hulumtimit, janë përdorur metoda dhe instrumente që mundësojnë të sigurohen të dhëna sasiore dhe cilësore, në ndërlidhje me pyetjet mbi zgjedhjen e profesionit, informimin e nxënësve për orientimin në karrierë, praktikën e shkollave në orientimin e drejtë profesional dhe mbështetjen shkollës dhe prindërve për orientim profesional të nxënësve.

Popullata dhe mostra

Popullata e këtij studimi janë mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të mesme të ulëta të regjionit të Prishtinës. Nga ky popullacion është zgjedhur mostra e hulumtimit, prej 70 mësimdhënësve dhe 220 nxënësve të 14 shkollave të mesme të ulëta, pra një mostër prej gjithsej 290 respondentësh.

Nxënësit e përzgjedhur për këtë hulumtim janë nga klasat e 9-ta. Nga vendbanimet rurale janë 56.7%, kurse 43.7% nga ato urbane. Referuar gjinisë së nxënësve, 47.7% i takojnë gjinisë mashkullore, kurse 52.3% gjinisë femërore.

Mostrën e mësimdhënësve e përbejnë 70 mësimdhënës të anketuar në shkollat përkatëse. Nga ta, 62.5% prej tyre i takojnë gjinisë femërore, kurse 37.5% gjinisë mashkullore. Të moshës 31 deri 40 janë mbi 40%, të asaj 41 deri 50 janë 27.3%, kurse të moshës mbi 50-vjeçare 31.8%. Sa i përket kualifikimit, mësimdhënësit me bachelor, me fakultet 4 vjeçar dhe me master, kanë përafërsisht të njëjtën përqindje kualifikimi, me nga rreth 33%. Përvoja e të anketuarve është relativisht e madhe. 61.8% e mësimdhënësve kanë mbi 15 vjet përvojë pune, kurse 29.4% prej tyre kanë 11-5 vjet përvojë. Pjesa tjetër e mësimdhënësve, rreth 9% kanë më pak se 10 vjet përvojë. Numri më i madh i të anketuarve janë mësimdhënës të Gjuhës shqipe, të Gjuhës angleze, të Historisë dhe të TIK-ut, pastaj të Matematikës, Biologjisë, Kimisë, Edukatës muzikore, Artit figurativ dhe Edukatës qytetare.

Instrumentet dhe metodat

Në studim si instrument kryesor është përdorur pyetësi për mësimdhënës dhe pyetësi për nxënës. Pyetësi është përdorur për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore, sepse ai përmban edhe pyetje të hapura, të cilat mundësojnë marrjen e të dhënave cilësore. Pyetësi për mësimdhënës përbëhet nga 6 pyetje mbi të dhënat e përgjithshme demografike dhe të kualifikimit dhe 16 pyetje për të mbledhur të dhëna specifike për çështje të informimit, edukimit dhe orientimit të nxënësve për karrierën në shkollë. Pyetësi për nxënës përmban 4 pyetje mbi të dhënat e përgjithshme demografike dhe 18 që kanë të bëjnë me hulumtimin. Për realizimin e studimit është përdorur metoda statistikore dhe përshkruese, me anë të së cilave janë paraqitur rezultatet nga hulumtimi i realizuar në terren.

Procedura e mbledhjes së të dhënave

Në fazën e parë, përmes hulumtimit kabinetik, është bërë konsultimi i literaturës dhe analiza e dokumenteve dhe strategjive relevante për arsimin. Në fazën e dytë janë përgatitur instrumentet e hulumtimit, janë pilotuar dhe pas ndryshimeve dhe plotësimeve të nevojshme hulumtimi është realizuar në terren me mbledhjen e të dhënave përmes pyetësorëve.

Procedura e analizës së të dhënave

Të dhënat sasiore janë analizuar përmes metodës statistikore, përmes SPSS-it, dhe janë paraqitur në mënyrë grafike e tabelare. Përpunimi i të dhënave cilësore, të mbledhura nga pyetjet e hapura në pyetësorë, do të bëhet duke bërë nxjerrjen e temave dhe përshkrimin e tyre. Kjo qasje mundëson që problemet e ngritura të klasifikohen, të interpretohen dhe të përshkruhen në kategori tematike dhe të lidhen me pyetjet kërkimore, në bazë të së cilave pastaj do të nxirren edhe konkluzione nga hulumtimi dhe rekomandimet se si të veprohet në të ardhmen.


3. REZULTATET E HULUMTIMIT

Në këtë pjesë të raportit pasqyrohen rezultatet e dala nga përpunimi i të dhënave të siguruara nga hulumtimi mbi përvojat e shkollave për orientim në karrierë të nxënësve të klasave të 9-ta. Në tri pjesët e këtij kapitulli janë paraqitur rezultatet e tri aspekteve kryesore të hulumtimit: (i) informimit për zgjedhjen e shkollimit/profesionit të ardhshëm, (ii) mënyrës së organizimit dhe realizimit të edukimit për orientim në karrierë dhe (iii) bashkëpunimit dhe këshillimit me prindër për orientimin e nxënësve/fëmijëve në karrierë.

3.1. Informimi i nxënësve për orientim në karrierë

Informimi ka për qëllim që ta ndihmojë dhe ta përgatisë nxënësin për zgjedhjen e drejtë të arsimimit dhe profesionit të ardhshëm. Siç rezulton nga

të dhënat e hulumtimit, më shumë se gjysma e nxënësve kanë deklaruar se janë të informuar gjatë shkollimit për zgjedhjen e profesionit të ardhshëm, kurse 43.0% janë deri diku të informuar. Vetëm 4.7% prej tyre nuk janë fare të informuar gjatë shkollimit për zgjedhjen e profesionit të ardhshëm.



Grafiku 1. Informimi i nxënësve për orientim në karrierë

Të gjithë respondentët që kanë deklaruar se janë të informuar ose deri diku të informuar gjatë shkollimit për zgjedhjen e profesionit të ardhshëm specifikojnë se janë mësimdhënësit dhe prindërit ata prej të cilëve kanë marrë më së shumti informacione për zgjedhjen e drejtë të profesionit të ardhshëm të tyre, e që shprehur në përqindje është 90.8%, përkatësisht 86.2%. Si burime të tjera informacioni ata kanë përmendur internetin, lëndën e teknologjisë, familjen e ngushtë, të afërmit, shoqërinë, mediat, librat dhe broshurat e në dy a tri raste janë informuar përmes lëndës Orientim në karrierë dhe përmes lëndës zgjedhore.

Edhe sipas mësimdhënësve, nxënësit janë të informuar gjatë shkollimit për zgjedhjen e profesionit të ardhshëm. 28.6% prej tyre mendojnë se ata janë të informuar, kurse 68.6% mendojnë se nxënësit janë deri diku të informuar për orientimin në karrierë. Vetëm 2.9% prej tyre kanë deklaruar se nxënësit nuk kanë informacione për zgjedhjen e profesionit të ardhshëm.


Informimi i pamjaftueshëm i nxënësve për profesion mund të ketë për pasojë zgjedhje të gabuar të karrierës, zhgënjim, pakënaqësi dhe ndërrime të shpeshta të shkollës. Pothuajse të gjithë nxënësit e anketuar kanë deklaruar se mungesa e informacioneve për profesionet ndikon në zgjedhjen e gabuar

të profesionit, sepse nxënësit e kësaj mosha nuk kanë njohuri të mjaftueshme për llojin e profileve arsimore që ofrohen dhe gjenden në tregun e punës.

Sa i përket kohës për zgjedhjen e drejtimit në shkollën e mesme të lartë, pjesa më e madhe e nxënësve apo 87.1%, deklarojnë se prindërit e tyre i informojnë me kohë, kurse 12.4% këtë e bëjnë deri diku. Vetëm 0.5% janë shprehur se prindërit e tyre nuk i informojnë ata për orientim në karrierë. Sipas nxënësve, edhe nga mësimdhënësit ata (nxënësit) informohen me kohë për orientim në karrierë, por në një shkallë më të ulët. Mbi 2/3 e tyre shprehen se informohen me kohë nga mësimdhënësit, kurse rreth 22% deri diku. Pjesa tjetër e nxënësve deklarojnë se mësimdhënësit e tyre nuk e bëjnë këtë me kohë.


Një numër i vogël i të anketuarve janë shprehur se gjatë shkollimit nxënësit nuk janë të informuar për zgjedhjen e profesionit të ardhshëm. Sipas nxënësve, shkak kryesor i mungesës së informimit të duhur të nxënësve të klasës së nëntë është mungesa e këshillimoreve për informim dhe orientim profesional. Një pjesë të fajit të mungesës së informimit të duhur për orientim në karrierë këta nxënës e bartin në shkollë, te mësimdhënësit dhe te shërbimi pedagogjik-psikologjik (pedagogu, psikologu). Rreth 17% prej tyre mendojnë se prindërit janë shkaktarë të mungesës së informimit të duhur të nxënësve të klasës së nëntë.

Edhe sipas mësimdhënësve, shkak kryesor i mungesës së informimit të duhur të nxënësve të klasës së nëntë është mungesa e këshillimoreve për informim dhe orientim profesional (68.3%). Për ndryshim nga nxënësit, sipas mësimdhënësve, shkaqet e mosinformimit të nxënësve gjatë shkollimit, nuk qëndrojnë te mësimdhënësit apo në shërbimin pedagogjik-psikologjik. Sipas tyre, shkak i mungesës së informimit të duhur janë edhe prindërit. Tabela në vazhdim paraqet më në detaje se ku qëndrojnë shkaqet e mungesës së informimit të duhur të nxënësve sipas mësimdhënësve dhe sipas nxënësve.



Grafiku 2. Shkaqet e mungesës së informimit të duhur të nxënësve të klasës së nëntë

Informimi dhe edukimi për orientim në karrierë nuk realizohen vetëm nga mësimi i rregullt në shkollë. Ekzistojnë edhe shumë forma dhe mundësi tjera për informim, këshillim dhe orientim për zgjedhjen e drejtë të profesionit. Edhe sipas gjetjeve të studimit ka dalë se edukimi dhe informimi për orientim në karrierë në kuadër të mësimin është në shkallën më të ulët, sikurse edhe nga mjetet e komunikimit masiv. Sipas nxënësve, prindërit janë ata prej të cilëve më së tepërmi informohen nxënësit për të vazhduar pastaj me vizitat në shkollat profesionale: bisedat me mësimdhënësit, ligjëratat nga informimi dhe orientimi profesional, librat, broshurat, revistat, fletëpalosjet, filmat, videospotet e vizitat në kompani. Forma dominuese e informimit për profesionet e ardhshme, sipas mësimdhënësve, është vizita në shkollat profesionale me 75% të rasteve. Pas kësaj vijnë me radhë format e tjera, si vizita në kompani, me 57%, ligjëratat nga informimi dhe orientimi profesional me 52.9%, ekspozitat dhe panairët e profesioneve të ndryshme me 50 % dhe librat, broshurat, revistat, fletëpalosjet, filmat, videospotet me 36.8%. Pasojnë bisedat me mësimdhënësit me 35.3% dhe ato me prindër me 13.5% (shih tabelën në vijim).



Grafiku 3. Format që ndihmojnë informimin e nxënësve për orientim në karrierë

Mësimdhënësit në përgjigjet e tyre kanë specifikuar mënyrën e realizimit të këtyre formave të informimit dhe orientimit të nxënësve për zgjedhjen e profesionit të ardhshëm. Mënyra më e mirë e informimit të nxënësve për përzgjedhjen e profesionit është vizitat nëpër kompani të ndryshme ku nxënësit mund të shohin punën që bëhet aty nga afër dhe ligjëratat për orientim profesional nga profesionistët e kompanive shprehen shumica e të anketuarve. Institucionet arsimore janë vendi ku njerëzit e moshave të ndryshme fillojnë mësimin (arsimin). Ato ofrojnë një laramani të madhe të njohurive dhe hapësirave të të nxënësve, ku mësimdhënësit luajnë një rol të rëndësishëm që t'i sigurojnë të rinjtë në marrjen e vendimeve reale të profesionit të tij të ardhshëm - përgjigjet një mësimdhënësi. Mënyra më e mirë për informim dhe orientim të nxënësve në karrierë, është përmes reformimit të sistemit arsimor, klasifikimi i nxënësve në klasa dhe përgatitja e nxënësve për shkencë dhe për tregun e punës. Që nga klasa e 6-të të bëhet testimi dhe klasifikimi i nxënësve në dy drejtime: shkencor dhe shoqëror, dhe që nga aty të fillohet me ligjëratat dhe informime, vizitat, ekspozitat dhe panairt profesionale - ka pohuar një mësimdhënësi. Mësimdhënësit specifikojnë edhe mënyra të tjera të realizimit të informimit si leximi i librave, broshurave, revistave, fletëpalosjeve, shikimi i filmave, videospoteve e reklamave të profesioneve të ndryshme, pastaj frekuentimi i ekspozitave dhe panairëve të profesioneve të ndryshme, vizitat në shkolla

profesionale, bisedat dhe këshillat e mësimdhënësve dhe prindërve, aplikimi i lëndës orientim në karrierë si lëndë e obligueshme apo si lëndë me zgjedhje, pjesëmarrja në seminare dhe ligjërata të ekspertëve etj.

3.2. Përvojat e shkollave në edukimin dhe orientimin në karrierë

Organizimi dhe koordinimi i procesit të zgjedhjes profesionale është përgjegjësi e shkollave, por janë nxënësit ata që me angazhimin e tyre kërkojnë zgjidhjet e duhura me mësimdhënësit e tyre, me prindërit, qendrat për orientim në karrierë, me kompani e ekspertë të fushave të ndryshme dhe kështu hedhin bazat për të ardhmen e tyre të suksesshme profesionale. Organizimin e informimit dhe edukimit në karrierë, shkollat e zhvillojnë në forma të ndryshme: si lëndë zgjedhore, si lëndë kurrikulare, si pjesë e aktiviteteve të veçanta kurrikulare apo përmes angazhimit të ekspertëve të jashtëm për këshillim dhe orientim në karrierë. Nga gjetjet e hulumtimit rezulton se numri më i madh i mësimdhënësve, apo 57.8% prej tyre, orientimin dhe edukimin në karrierë për nxënësit e shkollës së tyre e realizojnë përmes lëndës zgjedhore. Si pjesë e aktiviteteve të veçanta kurrikulare, e aplikojnë 35.9%, kurse si tema ndërkurrikulare, 12.5%. Si angazhim i ekspertëve të jashtëm për këshillim dhe orientim në karrierë, janë përcaktuar 9.12% e mësimdhënësve. 7.8% nuk organizojnë asnjërin nga format e orientimit dhe edukimit në karrierë.





Figura 4. Organizimi i orientimit dhe edukimit në karrierë

Janë disa forma që përdoren për orientim dhe edukim në karrierë në shkollat në të cilat është realizuar studimi. Sipas 55.7% të mësimdhënësve, forma kryesore që përdoret në shkollat e tyre është vizita në shkolla profesionale. Një formë tjetër që përdoret nga 30% e mësimdhënësve është përdorimi i burimeve të informatave nga broshurat, prospektet, posterat dhe fletëpalosjet, kurse 27.1% realizojnë vizita në kompani. Një numër i konsiderueshëm shkollash organizojnë mësim shtesë për karrierën dhe profesionet, këshillime individuale, si dhe seminare dhe këshillime në grup. Vetëm 2.9% të mësimdhënësve realizojnë teste aftësish dhe teste psikometrike. 2 nga të gjithë mësimdhënësit e anketuar kanë pohuar se në shkollat e tyre nuk përdoret asnjë nga format e potencuara.

Në orientimin dhe edukimin në karrierë në shkolla janë përfshirë aktorë të shumtë, si mësimdhënësit, kujdestarët e klasave, prindërit, këshilltarët për orientim profesionalë e përfaqësues nga institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional. Sipas përgjigjeve të mësimdhënësve të anketuar, del se prindërit dhe kujdestarët e klasave janë ata që më shumti janë përfshirë në edukim dhe orientim në karrierë të nxënësve/fëmijëve të tyre apo shprehur në përqindje në 50.7% të rasteve, pasuar nga përfshirja e mësimdhënësve të lëndëve të tjera me 46.2%. Këshilltarët e angazhuar për orientim dhe edukim profesional dhe përfaqësuesit nga institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional janë përfshirë pothuajse në shkallë të njëjtë: 15.9%, përkatësisht 13% të rasteve.




Grafiku 5. Përfshirja në orientimin dhe edukimin në karrierë

Në pyetjen se në cilën moshë duhet të fillojë këshillimi për orientimin në karrierë, numri më i madh i mësimdhënësve (48.6%) përgjigjen se duhet të fillojë në moshën 11 deri 14 vjeç, kurse 41.4% prej tyre në moshën 14 deri 16 vjeç. Për grupmoshat 7 deri 11 vjeç dhe 16 deri 19 vjeç janë përcaktuar 5.7%, përkatësisht 5.6% e mësimdhënësve.

Aspekti i motivimit për orientim profesional është mjaft i rëndësishëm, pasi detyrat dhe qëllimet e profesionit pësojnë ndryshime në vazhdimësi. Në pyetjen se çka paraqet një orientim i drejtë në shkollimin e ardhshëm dhe zgjedhjen e profesionit, më shumë se gjysma e nxënësve janë deklaruar për opsionin *të kesh një profesion*, kurse 45.4% të bëhesh i pavarur materialisht. Arsye tjera për t'u përcaktuar për një orientim të drejtë në shkollim janë: të kesh një diplomë (41.2%), të kesh një punë ku mundesh gjithmonë të mësosh diçka e re (31.0%). Të zhvillohesh profesionalisht (29.6%) dhe të kesh një profesion që njihet dhe vlerësohet nga të tjerët (22.7%).


Për një orientim të drejtë në shkollim, sipas nxënësve, duhet marrë parasysh shumë faktorë. Mbi 70% prej tyre deklarojnë se rezultatet e nxënësit janë ato që duhet të merren parasysh më së tepërmi në zgjedhjen e shkollimit dhe orientimit të ardhshëm. Në pozitën e dytë, sipas tyre, është zgjedhja e vetë nxënësit me 46.9%. Faktori ekonomik që ka të bëjë me mundësinë për të gjetur punë (38.0%) dhe fitimin (39.4), është po ashtu një element që duhet të merret parasysh. Zgjedhja e prindit, opinioni i mësimdhënësve, kostoja e shkollimit dhe kohëzgjatja e studimeve, janë disa nga faktorët me më pak peshë për orientim të drejtë në karrierë.

Edhe për mësimdhënësit faktorët dominues që duhet të merren parasysh për një orientim të drejtë janë rezultatet e nxënësit (74.3%), zgjedhja e nxënësit (61.4%), si dhe mundësia për të gjetur punë (74.3%). Për dallim nga përgjigjet e nxënësve, ¼ e mësimdhënësve kanë deklaruar se edhe opinioni i tyre duhet të merret parasysh për orientim të drejtë në karrierë. Fitimi, zgjedhja e prindit dhe kostoja e shkollimit, janë faktorë me shkallë me të ulët përqindjeje për t'u marrë parasysh.



Grafiku 6. Zgjedhja e drejtë e profesionit

Në zgjedhjen e karrierës, sipas nxënësve, janë disa kritere që ndikojnë më shumë sot te të rinjtë dhe familjet e tyre. Gjetja e punës dhe perspektiva e punësimit janë kriteri dominues i 67% të nxënësve. Zhvillimi i ardhshëm personal i të riut dhe afërsia e shkollës janë kritere që po ashtu ndikojnë te të rinjtë dhe familjet e tyre në zgjedhjen e karrierës. Kohëzgjatja e studimeve, kostoja e studimeve dhe shpërblimi i pritshëm, janë disa kritere, ndikimi i së cilave reflektohet në një shkallë më të ulët ndikimi (shih tabelën në vazhdim).



Grafiku 7. Kriteret që ndikojnë në zgjedhjen e karrierës

Orientimi në karrierë është një vendim i rëndësishëm jetësor që i vendos të rinjtë përballë dilemave dhe vështirësive të shumta rreth zgjedhjes së profesionit të ardhshëm, të cilat mund të shkaktojnë stres dhe tension.

Shkollimi i mëtejshëm dhe zgjedhja e profesionit të ardhshëm, sipas 31.6% të nxënësve, paraqet shumë stres, kurse 53.0% prej tyre përgjigjen se në zgjedhja e profesionit kanë pak stres. Pjesa tjetër e nxënësve shprehen se nuk kanë ose nuk kanë fare stres. Për 15.3% të nxënësve, zgjedhja e profesionit paraqet shumë vështirësi, kurse për 64.7% të tyre paraqet pak vështirësi. Rreth 20% nga ta, pohojnë se nuk kanë ose nuk kanë fare vështirësi. Tabela në vazhdim paraqet më në detaje shkallën e stresit, vështirësisë, shqetësimit, dilemës dhe konfliktit.

Tabela 1. Stresi, vështirësitë, dilemat në zgjedhjen e profesionit të ardhshëm

	Po, shumë	Po, pak	Jo	Jo, fare	Totali
Stres	31.6	53.0	5.6	9.8	220
Vështirësi	15.3	64.7	16.7	3.3	220
Shqetësim/ brengë	14.3	50.5	28.6	6.7	220
Dilemë	15.9	33.3	38.2	12.6	220
Burim konflikti	7.7	16.3	36.1	39.9	220


Në pyetjen nxënësve, se cilat janë dy nga profesionet më të preferuara të tyre, ata kanë përmendur profesione të ndryshme. Profesionet më të preferuar sipas 23.6% të nxënësve është programer, pasuar nga ai i mjekut, me 16.1%, dhe i mësimdhënësit me 15.6%. Profesionet e tilla, si: arkitekt, dizajner, futbollist, polic, dentist dhe shkencëtar kompjuterike, kanë pothuajse të njëjtën përqindje (nga 7.0% deri në 9%). Profesionet e tjera të preferuara me një përqindje prej 4% deri në 6.5% janë: i avokatit, infermierit, automekanikut, frizerit, aktorit dhe elektrikistit, për të vazhduar pastaj me kontabilist/ekonomist, ushtar, banka/financa, pilot, gjyqtar, prokuror, piktor, noter, dizajn grafik, fizioterapeut, astrolog, doganier, farmacist, psikologe, stjuardesë etj. Profesionet më të preferuara për vajza janë: mësimdhënëse, mjek, arkitekthe, dizajnere dhe programere, kurse për djemtë janë: programer, futbollist, automekanik dhe stomatolog.

Më shumë se gjysma e nxënësve të anketuar kanë pohuar se ata tashmë janë përcaktuar për profesionin e tyre të ardhshëm, kurse 43.3% nuk e kanë bërë ende këtë.

Në pyetjen plotësuese, se në çka janë bazuar për këtë zgjedhje, pjesa dërmuese e tyre janë përgjigjur se thjesht u pëlqen dhe u përshtatet profesioni i zgjedhur. Disa të tjerë kanë përmendur arsyet ekonomike, fitimi, mundësia më e lehtë dhe koha më e shpejtë e punësimit. Ka edhe nga ata që e kanë zgjedhur profesionin si vazhdimësi e profesionit familjar. Një numër i madh i nxënësve nuk janë përgjigjur fare se në çka janë bazuar për zgjedhjen e profesionit të shënuar.

Në pyetjen se a mendoni se informimi dhe orientimi në karrierë duhet të mësohet si lëndë mësimore në shkollën e mesme të ulët, mbi 60% të nxënësve deklarojnë se informimi dhe orientimi në karrierë duhet të mësohen si lëndë mësimore në shkollën e mesme të ulët, kurse 12.6% prej tyre e mohojnë këtë. Rreth 25% nuk kanë ndonjë qëndrim nëse informimi dhe orientimi në karrierë duhet të mësohet si lëndë mësimore.

E njëjta pyetje u është bërë edhe mësimdhënësve. Përgjigjet e tyre dallojnë nga ato të nxënësve. 74.3% e mësimdhënësve pohojnë se informimi dhe orientimi në karrierë duhet të mësohen si lëndë mësimore në shkollën e mesme të ulët, kurse 20.0% prej tyre mendojnë se kjo lëndë nuk duhet të mësohet si lëndë mësimore. Vetëm 5.7% nga ta nuk kanë ndonjë mendim të prerë për këtë, duke deklaruar se nuk e dinë.



Grafiku 8. Përfshirja e informimit dhe orientimit në karrierë si lëndë mësimore

Aktivitetet shkollore që kanë ndërmarrë lidhur me orientimin në karrierë të nxënësve, sipas mësimdhënësve të anketuar, kryesisht kanë të bëjnë me vizitat në shkolla profesionale dhe vizitat në kompani të ndryshme. *Shkollat janë vazhdimisht ndërmerr aktivitete të shumta. Në çdo vit vizitojmë shkolla profesionale dhe nxënësit informohen për së afërmi nga mësimdhënësit dhe instruktoret e këtyre shkollave me kushtet dhe mundësitë e shkollimit. Përveç kësaj, ne kemi organizuar ligjërata me theks të veçantë për t'u orientuar më lehtë në drejtimet aktuale që kërkon edhe tregu i punës – përgjigjet një mësimdhënës. Edhe disa mësimdhënës të tjerë deklarojnë se ata çdo vit, me nxënësit e tyre të klasës së 9-të, organizojnë vizita njëditore në shkolla profesionale, ku informohen në detale nga mësimdhënësit, duke vizituar punëtoritë dhe kabinetet e këtyre shkollave. Me nxënësit e klasës së 9-të në fund të vitit shkollor organizohet një vizitë në shkollat profesionale në NN dhe kjo ka ndikuar shumë në zgjedhjen e profesioneve nga nxënësit, në dy shkollat profesionale të qytetit – pohon një tjetër mësimdhënës i anketuar.*

Zakonisht, para se të përfundojë mësimin klasa e 9-të, ne në shkollën tonë ftojme të vijnë mësimdhënës profesionistë nga shkollat e mesme, me qëllim të informimit të nxënësve për zgjedhjen e shkollës dhe profesionit të ardhshëm në këto ligjërata, ata prezantojnë kushtet dhe përparësitë për regjistrim në këto shkolla, duke theksuar profesionet më të kërkuara të së ardhmes - shprehet mësimdhënësi tjetër.

Aktivitete shkollore që kanë ndërmarrë disa shkolla lidhur me orientimin në karrierë të nxënësve kanë të bëjnë me vizitat në kompani publike apo private, me ç'rast nxënësit informohen nga ekspertë të kualifikuar të kompanive. Disa nga mësimdhënësit kanë shënuar edhe emrat e kompanive të vizituara.

Ne kemi organizuar punëtori shkollore (workshop, seminare) ku kemi diskutuar për prodhimin dhe kërkesat e tregut. Në njërin nga këto punëtori ka marrë pjesë edhe pronari i një kompanie private – deklaroi një mësimdhënës.


Disa nga mësimdhënësit kanë theksuar se aktivitetet shkollore që kanë ndërmarrë lidhur me orientimin në karrierë të nxënësve i zhvillojnë në kuadër të lëndës zgjedhore Edukimi dhe Orientimi në karrierë.

Disa nga mësimdhënësit kanë theksuar se kanë ndërmarrë disa aktivitete, por nuk i kanë specifikuar asnjë nga to.

3.3. Bashkëpunimi dhe mbështetja e prindërve për orientim në karrierë

Orientimi profesional i nxënësve është detyrë e përbashkët e prindërve, shkollës, institucioneve që ofrojnë këshilla profesionale dhe ekonomisë. Ai luan një rol të rëndësishëm, në mbështetje të nxënësve për t'u mundësuar atyre të zgjedhin karrierën e tyre profesionale në kushtet më të mira. Kjo mund të arrihet vetëm nëse prindërit dhe fëmijët e tyre ndërgjegjësohen për zgjedhjen profesionale në një fazë të hershme, nëse ata përgatiten dhe mbështeten plotësisht dhe nëse ekziston një bashkëpunim i mirë ndërmjet të gjitha palëve.


Në pyetjen se kush mund të ndihmojë dhe me kë duhet të këshillohen, numri më i madh i nxënësve, apo 86.6%, kanë deklaruar se janë prindërit ata të cilët ndihmojnë dhe me të cilët konsultohen më së shumti në zgjedhjen e profesionit të ardhshëm, ndërsa me mësimdhënësit e tyre këshillohen 42.6% e nxënësve. Një pjesë e nxënësve, apo rreth 30% e tyre, këshillohen me të afërmit e tyre. Nga pedagogu i shkollës dhe nga nxënësit e shkollave të mesme, nxënësit e anketuar kërkojnë më pak këshilla.



Grafiku 9. Këshillimi për zgjedhjen e profesionit të ardhshëm

Ndihma dhe këto këshilla, sipas nxënësve, do të ishin të nevojshme në vlerësimin e aftësive të tyre, në informatat për profesionet dhe në informatat

për mundësit e punësimit dhe perspektiven e punësimit. Mbështetja nga prindërit, sipas nxënësve, është shumë e madhe. Pjesa më e madhe e nxënësve (78.1%) deklarojnë se në zgjedhjen e profesionit kanë mbështetjen e prindërve, kurse 26.7% prindërit iu propozojnë atyre zgjidhje konkrete. 14.8% e prindërve, sipas nxënësve, nuk përzihen fare, kurse 1.4% u imponojnë shkollimin dhe profesionin sipas zgjedhjes së tyre.



Grafiku 10. Qëndrimi i prindërve, sipas nxënësve, në orientimin dhe zgjedhjen e profesionit

Institucionet arsimore dhe familja kanë përgjegjësi të përbashkët në edukimin dhe edukimin e fëmijës për atë kohë sa fëmija është i përfshirë në sistemin arsimor. Prandaj, duhet të ketë patjetër një bashkëpunim që është i rregullt, afatgjatë dhe i planifikuar, në mes të prindërve dhe shkollës. Në pyetjen se çfarë bashkëpunimi kanë ata me prindërit lidhur me orientimin në karrierë të fëmijëve të tyre, një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve shprehën se bashkëpunimi me prindër nuk është i mjaftueshëm, e disa prej tyre theksojnë se nuk kanë fare. Mësimdhënës të tjerë deklarojnë se ata kanë bashkëpunim të mirë me prindërit, por jo se interesohen konkretisht me orientimin në karrierë dhe zgjedhjen e profesionit të ardhshëm.

Kërkesë deri tash prej prindërve nuk kam pasur për orientim të tyre, por bashkëpunimi me ta është në nivel të duhur. Për orientim në shkolla profesionale nuk është që bisedohet shumë. Prindërit nuk janë kërkues në lidhje me orientimin e fëmijëve të tyre në karrierë, por kur kërkojnë pëlqimin tonë, atëherë ne jemi të gatshëm për bashkëpunim - përgjigjet një mësimdhënës.

Megjithatë, ka mësimdhënës që pohojnë se bashkëpunimi me prindër gjithmonë është në nivel dhe janë shumë bashkëpunues. *Me disa prindër kemi bashkëpunim të shkëlqyer dhe japim rekomandime për fëmijët e tyre se ku mund të gjejnë veten ata në bazë të suksesit dhe rezultateve që tregojnë. Ata kërkojnë ide, këshilla, mendim për njohuritë që ka fëmija dhe mundësitë për tregun e punës. Bashkëpunimi me prindër në këtë aspekt ka të bëjë me lehtësimin e marrjes së vendimeve nga fëmijët e tyre. Gjithherë i inkurajoj që mos t'u bëjnë presion fëmijëve në zgjedhjen e profesionit të tyre të ardhshëm – shprehet një mësimdhënës. Ne si mësimdhënës bashkëpunojmë me prindër lidhur me orientimin në karrierë, i sugjerojmë për përzgjedhjen e profesionit të nxënësve, por prapëseprapë ata e bëjnë vetë orientimin e fëmijëve të tyre – deklaron një tjetër mësimdhënës.*

Iniciativa të rëndësishme të prindërve për orientim në karrierë, sipas mësimdhënësve, nuk ka pasur. *Kemi pasur vetëm mbështetje morale për aktivitetet tona lidhur me orientimin në karrierë - përgjigjet një mësimdhënës. Kemi pasur nja dy-tri raste kur prindërit me iniciativën e tyre kanë mundësuar vizita në kompani private – pohon një tjetër mësimdhënës.*

3.4. Propozime, vërejtje, komente për orientimin në shkollim dhe zgjedhje të profesionit

3.4.1. Nxënësit:

- Për zgjedhjen e profesionit janë të nevojshme vizitat në shkolla të mesme, kompani të ndryshme, dhe bisedat me nxënësit, familjarët dhe prindërit;
- Edukimi dhe orientimi për zgjedhjen e profesionit të jetë lëndë e veçantë, sepse ne mund të marrim informata për profesione dhe pastaj të bëjmë zgjedhjen e duhur;
- Duhet të angazhohen profesionistë për secilin profesion p.sh. mjekë, programerë, arkitektë, gazetarë etj. dhe të na informojnë për këto profesione;
- Këshillime me nxënës individualisht;

- Të mbajmë nga një orë shtesë për orientim në karrierë për t'u informuar sa më shumë për profesionet;
- Të hapen qendra për orientim në karrierë;
- Të zgjedhim drejtimin që na pëlqen dhe që ka më shumë të ardhura;
- Të mbahet praktikë dhe kurse në shkollë për zgjedhjen e profesionit.

3.4.2. Mësimdhënësit:

- Nxënësit duhet të orientohen sipas suksesit që kanë treguar gjatë këtyre viteve;
- Të organizohen ligjërata të ndryshme, vizita në kompani, emisione televizive, ku do të duhej të ftoheshin edhe nxënësit etj.;
- Zhvillimi, edukimi dhe orientimi për karrierë të futet si lëndë mësimore, në nivelin e mesëm të ulët;
- Të ketë më shumë kontakte dhe bashkëpunim me shkollat profesionale për orientim më të lehtë në ato shkolla;
- Plan-programet mësimore të përmbajnë më shumë njësi mësimore për këshillim dhe orientim të nxënësve për karrierë;
- Vizita të ekspertëve profesionalë të fushave nëpër shkolla;
- Propozojnë lëndë zgjedhore për orientim në profesion, projekte të ndryshme, informacione nga prindërit etj.;
- Të futet si lëndë mësimore në klasën e 9-të orientimi në karrierë;
- Të ketë fushata të institucioneve, medias dhe shoqërisë për orientim të drejtë dhe të dobishëm për individët dhe shoqërinë në tërësi;
- Në mjetet e informimit të ketë më shumë emisione që lidhen me të ardhmen e profesionit dhe të tregohen shembujt e suksesit të personave që kanë arritur suksese në biznes;
- Të ketë lëndë zgjedhore nga klasa e 8-të, si lëndë orientimi në karrierë.

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

4.1. Përfundime

Nga analiza e rezultateve të studimit rezulton se pjesa më e madhe e nxënësve kanë deklaruar se janë të informuar gjatë shkollimit për zgjedhjen e profesionit të ardhshëm, kurse 43.0% janë deri diku të informuar dhe se janë mësimdhënësit dhe prindërit ata prej të cilëve kanë marrë më së shumti informacione për zgjedhjen e drejtë të profesionit të ardhshëm të tyre, e që shprehur në përqindje.

Sipas nxënësve dhe mësimdhënëësve, shkak kryesor i mungesës së informimit të duhur të nxënësve të klasës së nëntë është mungesa e këshillimoreve për informim dhe orientim profesional.

Nga gjetjet e hulumtimit rezulton se numri më i madh i mësimdhënëësve, apo 57.8% prej tyre, orientimin dhe edukimin në karrierë për nxënësit e shkollës së tyre e realizojnë përmes lëndës zgjedhore. Si pjesë e aktiviteteve të veçanta kurrikulare e aplikojnë 35.9%, kurse angazhimi i ekspertëve të jashtëm për këshillim dhe orientim në karrierë përfshihet me rreth 9%.

Mbi 60% të nxënësve dhe 74.3% të mësimdhënëësve deklarojnë se informimi dhe orientimi në karrierë duhet të mësohen si lëndë mësimore në shkollën e mesme të ulët, kurse 12.6% prej tyre e mohojnë këtë. Rreth 25% nuk kanë ndonjë qëndrim nëse informimi dhe orientimi në karrierë duhet të mësohen si lëndë mësimore.

Për një orientim të drejtë në shkollim, mbi 70% të nxënësve deklarojnë se rezultatet e nxënësit janë ato që duhet të merren parasysh më së tepërmi në zgjedhjen e shkollimit dhe orientimit të ardhshëm, pastaj është zgjedhja e vetë nxënësit dhe faktori ekonomik që ka të bëjë me mundësinë për të gjetur punë dhe fitim.

Nga gjetjet e hulumtimit rezulton se gjetja e punës dhe perspektiva e punësimit janë kriteri dominues i 67% të nxënësve. Zhvillimi i ardhshëm personal i të riut dhe afërsia e shkollës, janë kriterë që po ashtu ndikojnë te të rinjtë dhe familjet e tyre në zgjedhjen e karrierës.

Numri më i madh i nxënësve, apo 86.6%, kanë deklaruar se janë prindërit ata të cilët ndihmojnë dhe më të cilët konsultohen më së shumti në zgjedhjen e profesionit të ardhshëm, ndërsa me mësimdhënësit e tyre këshillohen 42.6% e nxënësve, kurse një numër më i vogël prej tyre, këshillohen me të afërmit e tyre apo edhe me pedagogun e shkollës.

4.2. Rekomandime

Bazuar në rezultatet e hulumtimit, nxjerrim këto rekomandime:

- Zhvillimi, edukimi dhe orientimi për karrierë të futen si lëndë mësimore në nivelin e mesëm të ulët;
- Plan-programet mësimore të përmbajnë më shumë njësi mësimore për këshillim dhe orientim të nxënësve për karrierë;
- Të bëhet ngritja e kapaciteteve e të gjithë mësimdhënësve për këshillim dhe orientim të nxënësve për karrierë;
- Mjetet e informimit të ofrojnë konsulencë përmes reflektimit të ekspertëve të fushës, ku do të ftoheshin edhe nxënësit;
- Shkollat të bashkëpunojnë me ekspertë profesionalë dhe praktikë të fushës.

Referenca

1. Alloway, N., Dalley, L., Patterson, A., Walker, K., & Lenoy, M. (2004). School students making education and career decisions: Aspirations, attitudes and influences. *Canberra: DEST*.
2. Babarović, T., & Šverko, I. (2017). Profesionalno usmjeravanje u osnovnim i srednjim školama iz perspektive učenika
3. Brown, D., & Associate (Eds.). (2002). *Career choice and development* (4th ed.). San Francisco, CA: Jossey-Bass.
4. Brown, D., & Brown, D. (2012). *Career information, career counselling, and career development*. Boston, MA: Pearson.
5. CEDEFOP (2019). The European Centre for the Development of Vocational Training, Annual Report 2019. Publications Office of the European Union, 2020, Luxembourg.

6. Dërvodeli, J., (1997). Informimi dhe orientimi profesional. Prishtinë
7. European Education Information Network (EURYDICE) European Centre for the Development of Vocational Training (Cedefop). (2014). *Tackling early leaving from education and training in Europe: strategies, policies and measures*. Education, Audio-visual and Culture Executive Agency, Brussels, Belgium.
8. EYE, (2014) Doracaku mbi udhëzimin dhe këshillimin për karrierë.
9. Gati, I., & Saka, N. (2001). High school students' career-related decision-making difficulties. *Journal of Counselling and Development*, 79(3), 331–340.
10. Grauffel, C. (2016). Orientation professionnelle des élèves de 11CO. Saint-Maurice
11. Hasani, L., (2021). Motivimi i nxënësve nga mësimdhënësit për orientim në karrierë në ShFMU (Punim masteri).
12. Jemini-Gashi, L., Duraku, Z. H., & Kelmendi, K. (2019). Associations between social support, career self-efficacy, and career indecision among youth. *Current Psychology*, 1–7.
13. Jemini-Gashi, L., (2021). Planifikimi dhe vendimmarrja për karrierë tek adoleshentët, Udhëzime teorike dhe praktike, Prishtinë.
14. Keller, B. K., & Whiston, S. C. (2008). The role of parental influences on young adolescents' career development. *Journal of Career Assessment*, 16(2), 198–217.
15. MASHTI, (2022). Strategjia e Arsimit 2022-2026. Prishtinë
16. MASHTI, (2016). Kurrikula bërthamë e arsimit të mesëm të ulët të Kosovës (klasat VI, VII, VIII dhe IX), (e rishikuar).
17. Naz, A., Saeed, G., Khan, W., Khan, N., Sheikh, I., & Khan, N. (2014). Peer and Friends and Career Decision Making: A Critical Analysis. *Middle East Journal of Scientific Research*, 22(8), 1193–1197. DOI: 10.5829/idosi.mejsr.2014.22.08.21993.
18. Nuredini, V., (1999). Orientimi profesional i nxënësve. Prishtinë.
19. Paloş, R., & Drobot, L. (2010). The impact of family influence on the career choice of adolescents. *Procedia-Social and Behavioural Sciences*, 2(2), 3407–3411.
20. Statovci-Shala, S. & Mekolli, S. (2018). Orientimi profesional i nxënësve të klasës së 9-të në Republikën e Kosovës. *Novacioni, arsimi. Kërkimi dhe shkenca në funksion të zhvillimeve globale* (244-256), Ulqin.
21. Suryadi, B., Sawitri, D. R., & Hanifa, F. (2018). Career orientation of senior secondary school students. In *SHS Web of Conferences* (Vol. 42, p. 00005). EDP Sciences.

22. Swamy, D., Umesha, M. B. and Ramasesh, C. P. Career information resources and services at Mysore university library: an overview. Marrë nga: [Untitled-1 \(core.ac.uk\)](#)
23. Zarrett, N. & Eccles, J. (2006). The passage to adulthood: Challenges of late adolescence. *New directions for youth development*, 2006(111), 13–28.

Nga interneti

<http://www.gralon.net/articles/enseignement-et-formation/ecole/article-orientation-scolaire---ce-qu-il-faut-savoir-pour-bien-choisir-1187.htm>

PËRGATITJA MËSIMDHËNËSVE PARA SHËRBIMIT NË KOSOVË: SFIDAT DHE MUNDËSITË

Selim Mehmeti

Abstrakt

Ky studim shqyrton programet universitare për përgatitjen e mësimitdhënësve para shërbimit në Kosovë. Përdor qasjen cilësore në hulumtim, modelin studim rasti, për analizë të Programit Fillor dhe Programit Master për Mësimdhënie Lëndore në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë. Janë shqyrtuar aspektet e ndërlidhjes së përshkrimeve të programeve të studimit dhe të kurseve të programeve, me qëllimet dhe rezultatet e pritura të programeve të studimit, me kompetencat për mësimitdhënës dhe kërkesat e kurrikulës së bazuar në kompetenca. Pjesëmarrës në studim përmes intervistave me shkrim ishin 5 edukatorë të mësimitdhënësve dhe 11 mësimitdhënës fillestarë (1–2 vjet përvojë në mësimitdhënie). Të dhënat cilësore të mbledhura janë analizuar përmes metodës së analizës tematike.

Gjetjet tregojnë se Programi i studimit për arsim fillor dhe Programi Master për mësimitdhënie lëndore, përfshijnë elemente nga fushat kryesore të zhvillimit të kompetencave të mësimitdhënësve, me dominim të traditës në përmbajtje akademike. Mënyra se si janë integruar kërkesat dhe risitë e kurrikulës së arsimit parauniversitar në përmbajtjet e programeve për mësimitdhënës të ardhshëm, akoma nuk reflekton përfarim të duhur të programeve me kontekstin e shkollës dhe me nevojat e mësimitdhënësve fillestarë. Gjetjet e studimit tregojnë për nevojën e reflektimit institucional ndaj zhvillimit të programeve dhe syllabuseve lëndore, për të siguruar ndërlidhje të qëndrueshme me kompetencat për mësimitdhënës, me kërkesat e kurrikulës shkollore dhe temat kroskurrikulare me interes për shoqërinë dhe gjeneratat e ardhshme. Rekomandimet e nxjerra nga ky studim mund të shërbejnë si bazë për studime të mëtejme, rishikim të politikave të sistemit për përgatitjen e mësimitdhënësve të ardhshëm dhe të programeve për mësimitdhënës para shërbimit, me qëllim që sistemi për përgatitjen e mësimitdhënësve të reformohet dhe të sigurojë përgatitje cilësore të mësimitdhënësve të ardhshëm.

Fjalë çelës: *programe për përgatitjen e mësimitdhënësve, edukatorë të mësimitdhënësve, mësimitdhënës para shërbimit, mësimitdhënës fillestarë, zhvillim i mësimitdhënësve, sigurim i cilësisë.*

Pre-service teacher preparation in Kosovo: Challenges and opportunities

Selim Mehmeti

Abstract

This study examines the university programs for pre-service teacher training in Kosovo. It uses the qualitative approach in research, the case study model, for the analysis of the Primary Program and the Master's Program for Subject Teaching at the Faculty of Education in Prishtina.

Aspects of the relationship between the descriptions of the study programs and the courses of the programs, with the goals and expected results of the study programs, with the competences for teachers and the requirements of the curriculum based on competences are reviewed. Participants in the study through written interviews were 5 teacher educators and 11 beginning teachers (1-2 years of teaching experience). The qualitative data collected were analyzed through the thematic analysis method.

The findings show that the study program for primary education and the Master's program for subject teaching, include elements from the main areas of the development of teachers' competencies, with the dominance of tradition in academic content. The way in which the requirements and innovations of the pre-university education curriculum have been integrated into the contents of the programs for future teachers does not yet reflect a proper alignment of the programs with the context of the school and the needs of beginning teachers.

The findings of the study point to the need for institutional reflection on the development of programs and subject syllabi, to ensure sustainable connections with the competencies for teachers, with the requirements of the school curriculum and cross-curricular topics of interest to society and future generations. The recommendations derived from this study can serve as a basis for further studies, review of the policies of the system for the preparation of future teachers and of the programs for pre-service teachers, in order that the system for the preparation of teachers be reformed and ensure quality preparation of future teachers.

Keywords: teacher preparation programs, teacher educators, pre-service teachers, beginning teachers, teacher development, quality assurance.

Hyrje

Përgatitja universitare e mësimdhënësve të ardhshëm në arsimin parauniversitar është faza e parë e zhvillimit të karrierës së mësimdhënësve. Në këtë fazë zhvillohen bazat e mendimit profesional të mësimdhënësve për mësimdhënien dhe nxënien, nxënësin, klasën dhe shkollën. Në kontekstin e Kosovës dhe me gjerë, përgatitja e mësimdhënësve u referohet politikave dhe procedurave të dizajnuara për pajisjen e mësimdhënësve të ardhshëm me njohuri, qëndrime, sjellje dhe shkathtësi, të cilat iu duhen që ta kryejnë në mënyrë efektive detyrën e tyre në klasë, shkollë dhe komunitetin e gjerë (Fakulteti i Edukimit, 2021).

Në dekadën e fundit janë dy zhvillime thelbësore në nivel të politikave të sistemit arsimor në Kosovë që lidhen me përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit. Ndryshimi i parë lidhet me reformën kurrikulare në arsimin parauniversitar, ndërsa ndryshimi i dytë lidhet me orientimin strategjik për zhvillimin e mësimdhënësve në karrierë.

Reforma kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë, e reflektuar në dokumentet Korniza Kurrikulare për Arsim Parauniversitar dhe në Kurrikulat Bërthamë për nivelet formale të arsimit (MASHT, 2016), karakterizohet me një ndryshim të thellë në qasje, nga një qasje e bazuar në përmbajtje dhe objektiva mësimore në një qasje të bazuar në kompetenca dhe rezultate mësimore, nga një qasje e bazuar në lëndë mësimore në një qasje të integruar në fusha të kurrikulës. Ky ndryshim përbën sfidë më vete për sistemin arsimor në Kosovë, përfshirë edhe sistemin për përgatitjen e mësimdhënësve të ardhshëm.

Në anën tjetër, Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë (MASHT, 2017) ka përcaktuar pritshmëri të reja për mësimdhënës, përfshirë edhe pritshmëritë për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit dhe për fazën e hyrjes në profesionin e mësimdhënësit. Pritjet e përcaktuara me këtë dokument përbejnë bazën e kompetencave të mësimdhënësve të organizuara në katër fusha të mësimdhënies, të cilat duhet të reflektohen në

programet universitare për përgatitjen e mësimitdhënësve të ardhshëm, krahas kërkesave specifike të lidhura me programet e studimit për mësimitdhënie.

Në kontekstin e sistemit arsimor në Kosovë, Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) mbështet zbatimin e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Akreditimi/riakreditimi e programeve të studimit merr për bazë standardet e përgjithshme për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, mirëpo për programet e studimit për mësimitdhënës të ardhshëm nuk ka kërkesa të veçanta për standardet e profesionit të mësimitdhënësit/ kompetencat e përgjithshme dhe kërkesa të lidhura me reformën kurrikulare në arsimin parauniversitar.

Thellimi i të kuptuarit se si janë përfshirë në programet për përgatitjen e mësimitdhënësve, standardet e profesionit të mësimitdhënësit - kompetencat e përgjithshme dhe kërkesa të lidhura me reformën kurrikulare në arsimin parauniversitar, nxiti kryerjen e këtij studimi. Krahas analizës së programeve për përgatitjen e mësimitdhënësve, ky studim trajton edhe pikëpamjet e edukatorëve të mësimitdhënësve dhe të mësimitdhënësve fillestarë (1 – 2 vjet përvojë në mësimitdhënie) lidhur me programet dhe përgatitjen fillestare të mësimitdhënësve.

1. Shqyrtimi i literaturës – konteksti i përgatitjes së mësimitdhënësve para shërbimit

Përgatitja e mësimitdhënësve para shërbimit ose përgatitja fillestare e mësimitdhënësve (më tutje në tekst PFM) paraqet hapin e parë apo fazën e parë drejt zhvillimit të karrierës së mësimitdhënësve, rrugëtimit profesional të një mësimitdhënësi (Caena, 2014). Kjo fazë luan një rol kyç në përcaktimin e cilësisë dhe sasisë së mësimitdhënësve të ardhshëm (Musset, 2010).

PFM përkufizohet si një kombinim i arsimit para shërbimit dhe fazës së hyrjes në profesionin e mësimitdhënësit - induksionit. Formimi i mësimitdhënësve para shërbimit përfshin rrugët alternative të arsimimit formal në fusha të veçanta të studimit dhe aftësimit praktik e pedagogjik që mësimitdhënësit e ardhshëm duhet të kryejnë për të marrë kualifikimin mësimitdhënës dhe për të marrë të drejtën për t'u punësuar në një shkollë për

të filluar me ushtrimin e profesionit të mësimitdhënës. Induksioni është një element i formimit në shërbim, përfshin aktivitetet e organizuara për të mbështetur mësimitdhënës të fillestarë, si mentorimi formal dhe joformal, trajnimet, sesionet mbështetëse, puna me kolegët etj. (OECD, 2019).

Gjithnjë e më shumë në dokumente të politikave arsimore që promovojnë sistemin e karrierës së mësimitdhënësve, PFM është e konceptuar si pjesë e brendshme e vazhdimësisë së rritjes dhe zhvillimit profesional të mësimitdhënësve (Komisioni Evropian, 2015). Kjo reflektohet edhe në modelin e rrugës së formimit/edukimit të mësuesve të promovuar nga OECD (2019), model i cili pasqyrohet në figurën 1.




Figura 1. Modeli i rrugës së formimit/edukimit të mësuesve (OECD, 2019) - përshtatur nga Roberts-Hull, K., B. Jensen dhe S. Cooper (2015), Një qasje e re: Reformimi i edukimit të mësuesve në Australi

Sipas Burns dhe Köster (2016), në sistemin e përgatitjes së mësimitdhënësve veprojnë aktorë të shumtë, të cilët kanë rol dhe ndërlidhen me formësimin e mësimitdhënësve të ardhshëm, prandaj kjo shpesh e vështirëson identifikimin dhe adresimin e duhur të sfidave që lidhen me përgatitjen cilësore të mësimitdhënësve të ardhshëm (sipas OECD, 2019).

Njohja e aktorëve dhe e rëndësisë së aspekteve kulturore e historike të sistemit për PFM përbën orientimin fillestar në identifikimin dhe adresimin e sfidave që lidhen me sistemin e përgatitjes së mësimitdhënësve të ardhshëm, siç paraqitet në figurën 2.




Figura 2. Aktorët dhe rëndësia kulturore e historike e sistemit për PFM – përshtatur sipas Burns dhe Köster (2016) - Burimi OECD (2019)

Elementet nga figura numër 2, për aktorët dhe rëndësinë kulturore e historike të sistemit për PFM, janë signifikante për shumicën e sistemeve arsimore. Figura tregon se ofruesit e programeve për mësimitdhënës bartin barrën dhe përgjegjësinë kryesore për programet dhe përgjithësisht PFM.

Në dy dekadat e fundit, ka pasur ndryshime në strukturën dhe organizimin e programeve universitare për mësimitdhënës të ardhshëm në vendet e BE-së dhe jo vetëm, nga niveli i studimeve Bachelor në studime Master në mësimitdhënie. Sipas raportit të Komisionit Evropian (2021), si rezultat i zhvillimeve të Arsimit të Lartë në zonën evropiane dhe procesit të Bolonjës,

shumë sisteme arsimore kanë reformuar sistemet e përgatitjes së mësimdhënësve para shërbimit për të përshtatur një strukturë të re me Bachelor dhe Master. Në shumicën e sistemeve arsimore evropiane programet që përgatisin mësimdhënës për arsimin e mesëm të ulët çojnë në diplomë Master (Eurydice, 2021).

Standardet e mësimdhënies apo kompetencat e mësimdhënies janë segmenti më i rëndësishëm i reformës së përgatitjes së mësimdhënësve në vendet e BE-së. Përdoret Korniza e BE-së për mbështetjen e zhvillimit të kompetencave të mësimdhënësve, e cila ka përcaktuar kompetenca që duhen zotëruar nga mësimdhënësit për përmbushjen e rolit të tyre të ri. Korniza ka përcaktuar tri kategori të kompetencave të mësimdhënësve: Njohuritë dhe të kuptuarit; Shkathtësitë dhe Prirjet: besimet, qëndrimet, vlerat, përkushtimi. Dhe, për secilën kategori ka përcaktuar fushat e kompetencës për mësimdhënës (Komisioni Evropian, 2013).

Definimi i kompetencave të mësimdhënies përben orientimin e qartë drejt aspekteve që duhet të përfshihen në programet për PFM. Sipas Caena (2011, 2014) kompetencat e mësimdhënies janë kombinime komplekse të njohurive, shkathtësive, të kuptuarit, vlerave dhe qëndrimeve, që çojnë në veprime efektive në situata të ndryshme. Mësimdhënësia është shumë më shumë sesa një detyrë dhe përfshin vlera ose supozime në lidhje me edukimin, mësimnxënien dhe shoqërinë, koncepti i kompetencave të mësimdhënësve mund të rezonojnë ndryshe në kontekste të ndryshme kombëtare (sipas Fakulteti i Edukimit, 2021).

Zhvillimi dhe implementimi i programeve për përgatitjen e mësimdhënësve, krahas referimit në standardet e mësimdhënies, ndërlidhet me përgatitjen teorike dhe praktike për profesionin e mësimdhënësit. Ky proces duhet të referojë edhe reformën kurrikulare, kontekstin dhe specifikat e nivelit të arsimit për të cilin përgatiten mësimdhënësit e ardhshëm.

Sipas Caena (2014), kurrikulat për përgatitjen fillestare të mësimdhënësve duhet të marrin për bazë tri fusha që lidhen me kurrikulën shkollore: (i) aspektet/metodologjitë e fushës lëndore; (ii) aspektet transversale/pedagogjike (lidhja e njohurive në mënyrat e të nxëniesve,

kurrikulat shkollore dhe strategjitë për t'u marrë me diversitetin në klasë); dhe (iii) praktikën mësimore dhe mbikëqyrjen e përparimit të nxënësve (Caena, 2014).

Këtë orientim e reflektojnë edhe raportet e studimeve të publikuara nga Komisioni Evropian (2015) dhe OECD (2019 / TALIS 2018) për përgatitjen fillestare të mësimit nënxënësve. Ato theksojnë se ofruesit universitarë të programeve për mësimit nënxënës, marrin në konsideratë tri elemente kryesore, të cilat i përfshijnë në programet gjegjëse:

- (i) Njohuritë akademike të lëndës(ve) që duhen përvetësuar;
- (ii) Teoritë e mësimit nënxënës, duke përfshirë këtu aftësitë mësimit nënxënës dhe mbështetjen për nxënësit dhe të nxënës;
- (iii) Përvetësimin e praktikës në klasë.

Integrimi i këtyre elemente në programet universitare për mësimit nënxënës para shërbimit dallon ndërmjet sistemeve arsimore. Sipas raportit të Komisionit Evropian (Eurydice, 2015), mësimit nënxënës nga vendet e BE-së që kanë përfunduar një program të përgatitjes fillestare për mësimit nënxënës, 80% e tyre kanë pohuar përgatitja e tyre në fakultet i përfshinte të tri elementet kryesore të përshkruara më sipër.

Krahas aspekteve përmbajtjesore të programeve për përgatitjen e mësimit nënxënësve, cilësia e ofrimit të programeve për PFM lidhet edhe me tërheqjen e kandidatëve cilësorë për profesionin e mësimit nënxënës. Studimet e fundit pranimin e studentëve në programet për mësimit nënxënës e rendisin si njërin nga prioritetet kyçe në përgatitjen për profesionin e mësimit nënxënës (IZHA, 2016). Rëndësia e kufizimit të numrit të personave që bëhen mësimit nënxënës përmes kriterëve të pranimit në programet për përgatitjen e mësimit nënxënësve theksohet edhe nga Schleicher (2012).

Studimet nga TALIS që referojnë analizën e gjendjes në vendet e OECD lidhur me tërheqjen e kandidatëve cilësorë për profesionin e mësimit nënxënës i sugjerojnë sistemet arsimore që përzgjedhjen e kandidatëve në programet për mësimit nënxënës, ta bëjnë bazuar në kompetencën akademike dhe në

motivimin e tyre për të dhënë mësim, pasi që kjo fazë është thelbësore për të siguruar mësim dhe mësimdhënie cilësore në shkolla (OECD, 2019).

Në anën tjetër, faza e hyrjes në profesion është fazë e përshtatjes me kulturën e punës me nxënës, e zhvillimit dhe avancimit të mëtejshëm të kompetencave për mësimdhënie (Eurydice, 2015). Njihet si një fazë shtytëse e motivimit për të fituar dhe përditësuar kompetencat përgjatë karrierës së mësimdhënësve. Njëkohësisht, njihet si një fazë me shumë trauma për fillestarët, nëse për ta nuk është parapërgatitur një plan dhe program i mbështetjes dhe lehtësimit për përshtatje me kontekstin real të punës me nxënës (Mehmeti, 2018). Kjo fazë fillon me punësimin e mësimdhënësit dhe përfshin vitet e para (1-2 vjet) të mësimdhënies, me dallime në varësi të ofrimit nga sistemet arsimore.

Sipas Ingeroll (2012), hyrja në profesion është një reformë arsimore, koha e secilës ka ardhur. Nuk ka një model të vetëm, përkundrazi modelet e ndryshme kanë evoluar bazuar në nevojat dhe kontekstin lokal. Fazat e zhvillimit në karrierë, ndryshojnë nga kontekstet e sistemeve arsimore dhe konteksti lokal. Pa marrë parasysh se si janë përcaktuar këto faza, ato janë të njëjta për jetën profesionale të shumicës së mësimdhënësve. Ka raste kur mësimdhënësit i zhvillojnë vetë shkathtësitë e tyre, por një mënyrë më efektive është që t'i zhvillojnë shkathtësitë përmes një procesi të strukturuar të zhvillimit të vazhdueshëm profesional (Goddard & Buleshkaj, 2018).

1.1. Konteksti i përgatitjes së mësimdhënësve para shërbimit në Kosovë

Në kontekstin e arsimit në Kosovë, në dy dekadat e fundit, sistemi i përgatitjes së mësimdhënësve para shërbimit (PFM) ka kaluar nëpër një periudhë të ndryshimeve të vazhdueshme strukturore, në drejtim të avancimit të kualifikimit të mësimdhënësve nga kualifikimi dyvjeçar i Shkollave të Larta Pedagogjike në kualifikim bachelor. Sipas Saqipi (2020), në Kosovë në dekadën e fundit ka vazhduar tendenca e ngritjes së kërkesave për kualifikim si mjet për rritjen e cilësisë, duke vendosur që programet që përgatisin mësimdhënës në ciklin lëndor të përfundojnë me

gradën Master (Saqipi, 2020). Kualifikimi mësimdhënës, nga viti 2016 është pjesë e Ligjit për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës.

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Kosovë (2011) ka përcaktuar se të gjitha programet universitare që qojnë drejt kualifikimit për mësimdhënës duhet që më së voni deri në fillim të vitit akademik 2012/2013 të jenë ekuivalente me programet e ciklit të dytë prej 300 ECTS, që përmbajnë komponenten akademike, profesionale dhe pjesën praktike. Me akte nënligjore janë përcaktuar detajet për Sistemin e Licencimit dhe Karrierën e Mësimdhënësve.

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2023, i fundit për Sistemin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie (MASHTI, 2023), kohëzgjatja e studimeve për përgatitjen e mësimdhënësve duhet të jetë si në vijim:

- i. Kohëzgjatja e studimeve për përgatitjen e mësimdhënësve parashkollor dhe fillor, së paku 240 ECTS, prej tyre së paku 25 ECTS nga praktika profesionale;*
- ii. Kohëzgjatja e studimeve për përgatitjen e mësimdhënësve lëndorë, së paku 300 ECTS, 180 ECTS përgatitje akademike dhe 120 ECTS (MA) komponenti pedagogjik dhe praktik, prej tyre së paku 15 ECTS nga praktika profesionale; dhe*
- iii. Kohëzgjatja e studimeve për përgatitjen e mësimdhënësve të profilit të shkollave profesionale (AAP), së paku 240 ECTS përgatitje profesionale nga fusha e studimit. Ndërsa, për përgatitjen plotësuese në aspektin pedagogjik dhe praktik pritet të përcaktohet me akte të tjera nënligjore.*

Referuar Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë (2012), institucionet publike të arsimit të lartë janë përgjegjëse për ofrimin e programeve të përgatitjes së mësimdhënësve të ardhshëm. Këto programe ofrohen në Fakultetet e Edukimit në Kosovë, të cilat janë pjesë e pesë universiteteve publike, si në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë. Krahas Fakulteteve të Edukimit (më tutje në tekst FE), edhe disa Fakultete të Universitetit të Prishtinës ofrojnë programe për PFM, si për Edukim Fizik dhe Sporte,

Edukim Artistik, Gjuhë të huaja etj. FE në Prishtinë ka numrin më të madh të programeve të studimit për mësimdhënie, dy programe Bachelor dhe programin e studimit Master, me 8 specializime një lëndore.

Të gjitha programet për përgatitjen e mësimdhënësve kalojnë në procedurat e akreditimit, të vendosura nga Agjencia për Akreditim e Kosovës. Dokumenti bazë të cilin e përdor AKA për vlerësimin e të gjitha programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, përfshirë edhe programet për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit është Manuali për Akreditim. Manuali i akreditimit të programeve, nuk përmban standarde të veçanta për vlerësimin e programeve për përgatitjen e mësimdhënësve, akreditimi/riakreditimi përmban fusha dhe standarde për të gjitha programet e arsimit të lartë (AKA, 2022).

Modeli ekzistues i përgatitjes së mësimdhënësve para shërbimit në sistemin arsimor të Kosovës është i kombinuar, i njëkohshëm dhe i njëpasnjëshëm. Modeli i njëkohshëm zbatohet për përgatitjen fillestare të mësimdhënësve për edukimin në fëmijërinë e hershme dhe në arsimin fillor. Sipas këtij modeli, studentët ndjekin njëkohësisht kurset e zhvillimit akademik dhe pedagogjik njëkohësisht dhe marrin diplomë Bachelor të arsimit në fushën përkatëse.

Ndërsa, për mësimdhënës lëndorë në arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë (gjimnaze) ndiqet modeli i njëpasnjëshëm. Sipas këtij modeli, studentët së pari marrin diplomën e tyre akademike në nivelin Bachelor (180 ECTS) në departamentin përkatës dhe pastaj vazhdojnë arsimimin e nivelit Master në elementet pedagogjike dhe praktike të mësimdhënies prej 120 ECTS në FE.

Në raport me kompetencat që duhen zotëruar nga mësimdhënësit, Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë (KSZhMK) përcakton fushat e mësimdhënies dhe standardet e profesionit të mësimdhënësit, të zbërthyer në kompetenca për mësimdhënës (MAShT, 2017).

Tabela 1. Fushat e mësimdhënies dhe standardet e profesionit të mësimdhënësit në Kosovë

Fushat e mësimdhënies	Standardet e profesionit të mësimdhënësit
Vlerat profesionale, qëndrimet dhe sjelljet	1. Njeh dhe i mbështet vlerat dhe kriteret kryesore që janë vendosur nga MASHT-i/Përgjegjësi karshi detyrimeve dhe obligimeve të punës;
Njohuritë profesionale dhe të kuptuarit	2. Demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve dhe mësimin;
	3. Demonstron njohje të kurrikulës/përmbajtjes lëndore dhe metodikës së didaktikës profesionale të lëndës;
Shkathtësitë dhe praktika profesionale	4. Planifikon zbatim efektiv të mësimdhënies dhe mësim-nxënies;
	5. Planifikon vlerësimin e vazhdueshëm (vlerësimin për të mësuar), ofron komente kthyesë dhe raporton sa i përket mësimin të nxënësve;
Mësimi dhe angazhimi profesional	6. Angazhohet për zhvillim të vazhdueshëm profesional;
	7. Angazhohet profesionalisht me kolegë, prindër dhe bashkësi.

Referuar dokumentit të KSZhMK, këto fusha të mësimdhënies, standardet për mësimdhënës dhe treguesit e performancës, janë referenca kryesore për PFM, zhvillim të programeve, përkrahje dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm, vlerësim të performancës dhe për promovim të mësimdhënësve në karrierë. Nuk ka ndonjë analizë se sa dhe si janë integruar fushat e mësimdhënies dhe pritshmëritë për mësimdhënës në programet për PFM.

Faza e hyrjes në profesionin e mësimdhënësit – induksioni, sipas dokumentit të KSZhMK është konceptuar të jetë pjesë integrale e sistemit të zhvillimit

të mësimdhënësve në karrierë. Mirëpo, për këtë fazë akoma nuk është zhvilluar një program i veçantë dhe rrjedhimisht nuk zbatohet në mënyrë formale. Gjithsesi, nuk mund të thuhet se nuk ka mbështetje për mësimdhënësit fillestarë në Kosovë, në mungesë të një programi të veçantë, mbështetja që bëhet është e fragmentuar dhe joformale. Reforma kurrikulare e filluar në vitin 2011, e dinamizuar me zbatim në shkallë vendi nga vitit shkollor 2016/2017, përbën një ndryshim që referon edhe në programet për PFM. Filozofia dhe koncepti i reformës së fundit kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë, ka për bazë zhvillimin e kompetencave (MASHt, 2016). Roli i mësimdhënësit sipas reformës kurrikulare nuk është më që të bartë informacione, por të ofrojë një mjedis të përshtatshëm të nxënësve ku të gjithë nxënësit janë të përfshirë në aktivitetet mësimore dhe mund të zotërojnë kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve për nivelet përkatëse të arsimit.

Zhvillimi i kompetencave, mësimdhënia dhe të nxënësve të integruar dhe të ndërlidhur, janë dy nga pesë parimet bazë të reformës kurrikulare, janë parime bazë që flasin për rolin e ri të mësimdhënësve ndaj mësimdhënies dhe punës me nxënës. Kjo tregon se kurrikula e re vë në lëvizje mendimin e mësimdhënësve drejt qasjes së bazuar në rezultate (Saqipi, Asunta & Korpinen, 2014). Kjo qasje e konceptuar në reformën kurrikulare, shtron nevojën e përafrimit të kurrikulës për PFM me kontekstin e ri të punës së shkollës dhe mësimdhënësve për të hartuar dhe zbatuar kurrikulën që shkolla duhet ta ofrojë për nxënësit e saj.

Kushtet për pranimin e të studentëve në programet për mësimdhënës, tërheqja e kandidatëve në programet për profesionin e mësimdhënësit, si dhe nevojat për mësimdhënës, bazuar në nevojat e sistemit të arsimit parauniversitar, mbesin çështje të rëndësishme të cilat duhet studiuar më në detaje, në kuadër të një analize më gjithëpërfshirëse të kontekstit të sistemit për përgatitjen fillestare të mësimdhënësve në Kosovë.

1.2. Qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore

Përgatitja e mësimdhënësve të rinj në kontekstin e ndryshimeve të vazhdueshme në arsim dhe e pritshmërive për mësimdhënës është fushë

studimi e rëndësisë së veçantë. Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë programet për përgatitjen e mësimitdhënësve para shërbimit në Kosovë nga perspektiva e kompetencave për mësimitdhënës dhe e reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar, si dhe të sjellë një vështrim të përgjithshëm të mendimeve të edukatorëve të mësimitdhënësve dhe të vetë mësimitdhënësve fillestarë për programet për përgatitje të mësimitdhënësve para shërbimit.

Kërkesat e shoqërisë kosovare për të përmirësuar cilësinë e arsimit, e reflektuar mjaft kritike në raportet e vlerësimeve ndërkombëtare, në të cilat Kosova ishte pjesëmarrëse në dekadën e fundit (PISA (2015, 2018, 2022), PIRLS (2021) dhe TIMSS (2019)), kërkojnë që sistemi për përgatitjen e mësimitdhënësve të reformohet dhe të sigurojë përgatitje cilësore të mësimitdhënësve të ardhshëm. Sepse, siç theksojnë Barber and Mourshed (2007), cilësia e një sistemi arsimor nuk mund të tejkalojë cilësinë e mësuesve të tij. Në këtë drejtim, nxitja për hapjen e debatit në komunitetin arsimor për cilësinë e përgatitjes së mësimitdhënësve para shërbimit dhe kontributi me orientime për të përmirësuar dhe avancuar programet për përgatitjen e mësimitdhënësve para shërbimit janë synim kryesor i këtij studimi.

Pyetjet kërkimore që e udhëheqin këtë studim janë si në vijim:

- Si reflektohen pritshmëritë për kompetencat e mësimitdhënësve dhe kërkesat e kurrikulës së bazuar në kompetenca në programet për përgatitjen mësimitdhënësve para shërbimit?
- Çfarë është mendimi i edukatorëve të mësimitdhënësve dhe i mësimitdhënësve fillestarë për sistemin dhe programet për përgatitjen e mësimitdhënësve të ardhshëm?
- Cilat janë sfidat më të mëdha dhe cilat janë zgjidhjet e mundshme për të përmirësuar dhe avancuar programet për përgatitjen e mësimitdhënësve të ardhshëm në Kosovë?

2. Metodologjia

Studimi përdori qasjen hulumtuese cilësore, modelin studim rasti. Zakonisht studim rasti në një hulumtim përfshin një ose më shumë raste në thellësi dhe adreson pyetjet dhe çështjet e hulumtimit (Matthews & Ross, 2010). Në fokus të rastit studimor, në këtë hulumtim, janë programet e studimit për PFM në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë, jo çka ndodh gjatë proceseve në këtë fakultet. Është përzgjedhur ky dizajn i hulumtimit cilësor me qëllim që të hedhim dritë mbi programet për PFM, t'i prezantojmë rezultatet e studimit për të gjitha palët e interesit (Manninen, 2014), në mënyrë që ato të merren në konsideratë për studime të mëtejme, si dhe gjatë zhvillimit të politikave dhe rishikimit e përditësimit të programeve për PFM nga ofruesit.

Mbledhja e të dhënave përbëhet nga analiza e dokumenteve dhe intervistat. Fillimisht është bërë analiza e programit të studimit për Arsim Fillor dhe programit të studimit Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializim) në FE në Prishtinë së bashku me syllabuset e lëndëve/kurseve nga këto programe. Analiza e programeve për PFM u organizua në formatin e kërkesave kryesore të syllabuseve, përfshirë përshkrimin e lëndës, qëllimin dhe rezultatet e pritura të nxënies, metodologjinë e mësimdhënies dhe të vlerësimit, literaturën bazë, literaturën shtesë etj.

Nga intervistat realizuara në kuadër të këtij studimi, raportojmë për 16 intervista të kryera, 5 prej tyre me personel akademik - edukatorë të mësimdhënësve që lidhen edhe me sigurimin e cilësisë së programeve për përgatitjen e mësimdhënësve, dhe 11 intervista me mësimdhënës fillestarë me përvojë 1-2 vjet në ushtrimin e profesionit. Edukatorët e mësimdhënësve u përzgjedhën qëllimshëm, për nga roli dhe përfaqësimi i programeve Bachelor dhe Master për mësimdhënës (Tabela 2). Ndërsa mësimdhënësit fillestarë u përzgjedhën në bazë të caktimit të rastësishëm të mostrës së përzier nga një listë prej 30 mësimdhënësve fillestarë të siguruar nga komuna të ndryshme të Kosovës (Tabela 3). Intervistat gjysmë të strukturuar janë bërë më shkrim në kohëzgjatje 40 – 45 minuta.

Tabela 2. Karakteristikat e mostrës së stafit akademik – edukatorëve të mësimdhënësve

Stafi akademik & Menaxhimi (n=5)	Kualifikimi	Fusha	Roli në programet për PFM
Stafi 1	Prof. i Asocuar	Psikologji	Prodekane për Çështje Mësimore - Studimet Master
Stafi 2	Prof. i Asocuar	Teknologji	Prodekan për Çështje Mësimore - Studimet BA
Stafi 3	Prof. i Asocuar	Matematikë	Mësimdhënës
Stafi 4	Profesor i rregullt	Kimi	Mësimdhënës
Stafi 5	Prof. i Asocuar	Biologji	Mësimdhënës

Tabela 3. Karakteristikat e mostrës së mësimdhënësve fillestarë

Mësimdhënës (n=11)	Kualifikimi	Përvoja	Programi
Mësimdhënësi 1	Bachelor	1 vit	Programi fillor
Mësimdhënësi 2	Master	2 vjet	Programi lëndor - Histori
Mësimdhënësi 3	Bachelor	1 vit	Programi fillor
Mësimdhënësi 4	Bachelor	1 vit	Programi fillor
Mësimdhënësi 5	Bachelor	2 vjet	Programi lëndor - Matematikë
Mësimdhënësi 6	Bachelor	2 vjet	Programi fillor
Mësimdhënësi 7	Master	1 vit	Programi lëndor - Biologji
Mësimdhënësi 8	Master	1 vit	Programi lëndor - Fizikë
Mësimdhënësi 9	Master	1 vit	Programi lëndor – Edukatë qytetare
Mësimdhënësi 10	Bachelor	2 vjet	Programi fillor
Mësimdhënësi 11	Master	2 vjet	Programi lëndor - Matematikë

Intervistat kanë përfshirë tri fusha kryesore, e përveç të dhënave të përgjithshme personale të informacionit. Fusha e parë përfshinte pyetje në lidhje me: (i) sistemin për PFM, (ii) programet për PFM, (iii) sfidat dhe mundësitë e funksionimit dhe reformimit të sistemit për PFM në Kosovë.

Të dhënat u analizuan përmes metodës së analizës tematike. Sipas Grbich (2007), analiza është procesi i segmentimit, kategorizimit dhe rilidhjes së aspekteve të të dhënave përpara interpretimit të tyre përfundimtar (sipas Matthews & Ross, 2010). Metoda e analizës tematike e përdorur për këtë studim ndihmoi të shqyrtojme termat dhe konceptet e shfaqura më shpesh në tekst (Vogrinc & Saqipi, 2020), të krijojmë fraza dhe fjali për të formuar tema në bazë të pyetjeve kërkimore dhe grupim të temave në kategori të përgjithshme para interpretimit përfundimtar.

3. Gjetjet kryesore

Gjetjet pasqyrojnë pyetjet kërkimore të studimit dhe janë të organizuara në tri pjesë. Në pjesën e parë pasqyrohen gjetjet nga analiza e programeve për PFM, në pjesën e dytë prezantohen gjetjet nga përpunimi dhe interpretimi i të dhënave të siguruara nga intervistat me stafin akademik të ofruesve të programeve për PFM, edukatorët e mësimdhënësve. Kurse në pjesën e tretë prezantohen përmbledhja e gjetjeve nga intervistat me mësimdhënës fillestarë.

3.1. Gjetjet nga analiza e programit fillor dhe programit të studimit Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializim)

3.1.1. Përmbledhje e gjetjeve nga analiza e programit fillor

Referuar dokumentit të publikuar nga FE për programin Fillor, qëllimi i programit Fillor është t'u ofrojë studentëve njohuri, aftësi dhe vlera të nevojshme për të kryer profesionin e mësuesit në arsimin fillor. Programi synon të pajisë studentët me njohuritë e përmbajtjes kurrikulare për nivelin e dhënë dhe me njohuritë dhe aftësitë pedagogjike të nevojshme për të dhënë

një mësimdhënie efektive. Programi synon t'u mundësojë studentëve që të jenë të përgatitur për të përballuar me detyrat dhe pritjet e profesionit të mësuesit, duke përfshirë të kuptuarit e mjedisit të përshtatshëm të të mësuarit, planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës, si dhe kuptimin e faktorëve që ndikojnë në të mësuarit e suksesshëm. Programi synon të përgatisë mësues të rinj që të jenë të gatshëm të kontribuojnë në zhvillimin e shkollës dhe profesionit të mësuesit, duke ndjekur trendët bashkëkohore në mësimdhënien cilësore duke përfshirë integrimin e teknologjisë dhe përshtatjen e mësimdhënies së tyre me specifikat e studentëve.

Për arritjen e qëllimit të Programit Fillor, synimeve të programit dhe rezultateve të pritura të programit, janë hartuar 63 syllabuse për lëndë të ndryshme, ku 34 prej tyre janë syllabuse për lëndë të obligueshme, ndërsa 29 syllabuse për lëndë me zgjedhje të cilat në parim duhet të përzgjidhen nga studentët në bazë të kriterëve të përcaktuara nga FE (Fakulteti i Edukimit, 2021a).

Në dokumentin bazë të programit Fillor, në bazë të të cilit është akredituar programi deri më 30 shtator 2024, janë përshkruar të gjitha kurset, syllabuset. Në përshkrime të kurseve në kuadër të dokumentit për programin e studimit të akredituar, kryesisht vihet theksi në qëllimin e kursit dhe përmbajtjen që trajtohet në kuadër të secilit kurs, detajet e lëndëve/kurseve pasqyrohen në syllabuset përkatëse.

Syllabuset e Programit Fillor kanë strukturë të njëjtë, duke përfshirë të dhëna bazike të lëndës, përshkrimin e lëndës, qëllimet e lëndës, rezultatet e pritura të nxënies, metodologjinë e mësimdhënies dhe të vlerësimit, kriteret e vlerësimit, planin e dizajnuar të mësimit – ligjëratat sipas javëve, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese.

Gjetjet pasqyrojnë pyetjen e hulumtimit që lidhet me programet për PFM. Gjetjet janë të organizuara në katër tema. Diskutimi i temave nxjerr në pah strukturën e unifikuar, por edhe veçori dalluese në mes të kurseve të programit fillor të studimit të cilat ndikojnë në përmbushjen e qëllimit të programit fillor dhe rezultateve të pritura. Një përmbledhje e gjetjeve të rezultateve nga analiza e programit të studimit për Arsim fillor, pasqyrohet në temat në vijim.

(i) Dizajni i programit, ndërlidhja e përshkrimeve të lëndëve/kurseve me qëllimet dhe rezultatet e pritura të programit

- *Dizajni i programit fillor ka elemente të informimit nga kërkimi dhe teoria mbi PFM, duke përfshirë edhe kërkesat për mësimdhënës. Kryesisht ndiqet një format/model i njëjtë i përshkrimit të kursit, përshkrimeve të qëllimit dhe rezultateve të pritura.*
- *Ka raste kur përshkrimi i lëndës në formularin e syllabusit nuk përputhet me përshkrimin në dokumentin e akreditimit të programit Fillor. Në këto raste, në syllabus, theksi i përshkrimit vihet në rëndësinë e lëndës/kursit, apo në shpjegimin e parimeve të të mësuarit se në aspektet që trajton dhe mbulon kursi.*
- *Në disa përshkrime të kurseve, qëllimet e lëndës nuk janë specifikuar, ngatërrohen përshkrimi i lëndës me qëllimin e lëndës ose iu referohen njohurive, shkathtësive dhe kompetencave me gjuhë të përgjithësuar, pa ndonjë ndërlidhje me vlerat profesionale, qëndrimet dhe sjelljet. Në raste të caktuara, edhe pa ndërlidhje me përmbajtjen e kursit.*
- *Në raport me rezultatet e pritura të nxënies, kemi dallime të shumta. Ka raste kur rezultatet e pritura janë të integruara në një paragraf, jo të ndara në mënyrë specifike, ka raste ku është vendosur vetëm një rezultat specifik, si dhe ka raste kur nuk janë zëbërthyer fare rezultatet e pritura – syllabusi është pa rezultatet të pritura.*
- *Në shumë raste shkrimi i rezultateve të nxënies reflektohet me formulime të pastanadizuara, disa në njëjës, disa në shumës (p.sh. Dallon, Dallo, Dallojnë, Të dallojnë, Të dallon...), disa me folje aktive dhe disa me folje pasive (të njohin, të kuptojnë, të dinë... apo kuptojnë, njohin, dinë.)*
- *Në disa kurse qëllimet e lëndës dhe rezultatet e pritura të nxënies nuk dallojnë, janë të njëjta.*
- *Në disa kurse nuk përputhën qëllimi i lëndës, rezultatet e të nxënies dhe temat/ligjëratat e përcaktuara për javë në kuadër të semestrit.*

(ii) Ndërlidhja e programit të studimit dhe lëndëve/kurseve të programit me kompetencat për mësimdhënës dhe kërkesat e kurrikulës së bazuar në kompetenca

- *Në përgjithësi, dizajni i programit fillor i reflektuar te qëllimi dhe profili i programit të studimit dhe te rezultatet e pritura të programit, ka elemente ndërlidhëse me kompetencat për mësimdhënës dhe me kurrikulën.*
- *Jo të gjitha përshkrimet e kurseve pasqyrojnë mundësitë për informim dhe praktikë për zhvillim të kompetencave për mësimdhënës. Vetëm në një-dy, kurse janë përfshirë në literaturën bazë dokumente të rëndësishme që lidhen me kompetencat e mësimdhënësve, siç janë për shembull Korniza për zhvillimin e mësimdhënësve, Korniza Evropiane, Korniza për kompetencat digjitale etj.*
- *Elementet e planifikimit mësimor të kurrikulës së bazuar në kompetenca reflektohen më shumë tek kurset e praktikës pedagogjike.*
- *Referimi në parimet dhe kompetencat kryesore nuk përfaqësohet në nivelin e pritur në syllabuset e lëndëve, si në raport me rezultatet e të nxënit, ashtu edhe në metodologji të mësimdhënies dhe të vlerësimit, por edhe në literaturën bazë.*
- *Syllabuset pak kanë elemente të qasjes se integruar për të siguruar lidhje në mes të fushave kurrikulare që përfshihen në arsimin fillor.*
- *Shkencat e natyrës në arsimin fillor është integruar, ndërsa në kursin Mësimi në natyrë, ligjëratat javore janë të fokusuara në tema nga Kimia dhe Fizika.*
- *Çështjet ndërkurrikulare të përcaktuara si tema me interes për shoqërinë, të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë për Arsimin Fillor, si Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia etj., preken në mënyrë të fragmentuar në tërësinë e kurseve të Programit fillor, nuk ka ndonjë fokus të veçantë në mbulimin e tyre.*
- *Është sipërfaqësor fokusi në zbatimin e TIK në mësimdhënie dhe të nxënë, në vlerësim, zhvillim të aftësive digjitale për qëllim të të nxënit; krijim të përmbajtjeve digjitale etj. Kompetenca digjitale në mësimdhënie nevojitet të zhvillohet në tërësinë e programit.*

(iii) Qasjet ndaj njohurive akademike të lëndës(ve) dhe komponentëve psikologjike-pedagogjike – didaktike dhe praktike

- *Përmbushen kërkesat bazë në raport me numrin e kurseve që mbulojnë njohuritë akademike dhe komponentët tjera që lidhen me mësimdhënien.*
- *Natyrshëm, mësimdhënësit, disiplina e të cilëve është Pedagogjia, në lëndët e tyre reflektojnë më shumë elementet që lidhen me komponentët psikologjike, pedagogjike dhe didaktike.*
- *Në tërësinë e kurseve, dominon fokusimi në përmbajtje lëndore, me dominim niveli i njohjes dhe të kuptuarit.*
- *Ka mungesë të kurseve të veçanta apo edhe e qasjeve për zbatim të aspekteve që zhvillim të shkathtësive të mësimdhënies së diferencuar në klasa gjithëpërfshirëse, menaxhimit të klasës, ballafaqimit dhe bashkëpunimit me komunitetin, integrimin ndërfaqor, integrimin e përmbajtjeve ndërkurrikulare etj.*
- *Komponenti praktik është e përfshirë në katër lëndë obligative të emërtuara Praktika pedagogjike I-IV. Përshkrimet nga njëri kurs i praktikës pedagogjike në tjetrin kurs shihen si vazhdimësi e praktikave paraprake.*
- *Dimensioni i praktikës pedagogjike shpesh reflektohet me pritshmëri të kërkesave të teorisë së edukimit, si p.sh. shpjegojnë filozoftë dhe strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies dhe vlerësimit të nxënësve; analizojnë aspekte të teorive dhe stileve të të nxënësve, të nxënësve ndërvepruese etj.*

(iv) Qasjet ndaj metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit

- *Janë në fokus të përshkrimit të programit, mirëpo përcaktimi i aspekteve metodologjike në syllabuset e lëndëve, nuk reflektohet të jetë udhëhequr nga udhëzimet dhe orientimet e programit të akredituar.*
- *Domionon ligjërimi si një qasje kryesore e metodologjisë së përshkruar në syllabuset e lëndëve.*
- *Dizajni i mësimi i organizuar në ligjërata tregon se temat – kryesisht organizohen për të përcjellë konceptet bazë të lëndës/kursit dhe për të organizuar javët e vlerësimit për studentë.*
- *Në një pjesë të konsiderueshme të kurseve nuk përcillen me literaturë nga kërkimi dhe teoria e zhvillimeve të reja mbi profesionalizmin e mësimdhënësve. Ka raste kur është dhënë literaturë bazë dispensa e mësimdhënësit të lëndës, ose artikuj nga ndonjë reviste që nuk lidhet me kërkimet shkencore në edukim (për shembull është dhënë literaturë bazë një punim nga revista “Shkëndija”).*
- *Qasja ndaj vlerësimit është e diktuar nga formati i shkrimit të syllabuesve dhe pasqyrohet më shumë si teknike ku përcaktohen metodat dhe teknikat e vlerësimit dhe ndarjet e peshës (përqindjes) në vlerësim për secilën metodë apo teknikë.*
- *Qasja në vlerësim në përgjithësi reflektohet të jetë tradicionale, e përcjellë me disa shembuj të mirë ku në mesin e metodave të vlerësimit, përfshihet edhe analiza artikujve shkencor të zgjedhur, reflektime për tema të caktuara, projekti grupor etj.*
- *Kursi Vlerësimi në arsim, ka shumë aspekte tematike që lidhen me vlerësimin, nga sistemi i vlerësimit, vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare, deri te vlerësimi i mësimdhënësve. Një format i tillë i kursit për mësues fillor nuk siguron përgatitjen e mësuesve për të implementuar vlerësimin e bazuar në kompetenca. Kursi nuk trajton në esencë qasjet metodologjike të vlerësimit në praktikë, vlerësimin formues, informatat kthyes, vlerësimin përmbledhës etj.*
- *Ka dallime të theksuara në kriteret e vendosjes së notës, në disa kurse nota 6 vendoset me 55-60%, në disa me 50-59% në disa me 55-64 %.*

3.1.2. Përmbledhje e rezultateve nga analiza e programit të studimit Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializim)

Programi i studimit Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializim) është akredituar për periudhën 1 tetor 2021 - 30 shtator 2024. Programi përfshin 8 specializime:

- Mësimdhënia e Matematikës;
- Mësimdhënia e Fizikës;
- Mësimdhënia e Kimisë;
- Mësimdhënia e Biologjisë;
- Mësimdhënia e Historisë;
- Mësimdhënia e Gjeografisë;
- Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut;
- Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Qëllimi i përgjithshëm i programit Master në Mësimdhënie lëndore është që të avancojë më tutje kompetencat moderne të mësimdhënies dhe të praktikës pedagogjike, krahas atyre akademike. Programi synon të përgatisë studentë me njohuri të mësimdhënies bashkëkohore, me kompetenca të lidhura me përmbajtjen e lëndës së fushave të tjera kurrikulare etj.

Për arritjen e qëllimit të programit të studimit MA Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializim), synimeve të programit dhe rezultateve të pritura të programit, për secilin specializim është zhvilluar përmbajtja e programit dhe e kurseve të organizuara në 4 semestra, me qëllim marrjen e 120 ECTS dhe kualifikimin master në mësimdhënie lëndore. Programi i ka të përshkruara gjithsej 15 kurse të përgjithshme dhe kurset specifike për secilin specializim, numri i të cilave dallon ndërmjet specializimeve (Fakulteti i Edukimit, 2021b).

Syllabuset e Programit Master i mësimdhënies lëndore kanë strukturë të njëjtë të syllabuseve. Syllabuset përfshijnë të dhënat bazike të lëndës, përshkrimin e lëndës, qëllimet e lëndës, rezultatet e pritura të nxënies, metodologjinë e mësimdhënies dhe të vlerësimit, kriteret e vlerësimit, planin

e dizajnuar të mësimet – ligjëratat sipas javëve, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese.

Diskutimi i temave nga analiza e programit të studimit Master dhe syllabuseve lëndore, nxjerr në pah të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet specializimeve dhe brenda kurseve të një specializimi. Meqë nuk është qëllim më vete krahasimi në mes të specializimeve lëndore, gjetjet janë organizuar në katër temat kryesore dhe prezantohen të integruara për të gjitha specializimet.

(i) Dizajni i programit, ndërlidhja e përshkrimeve të lëndëve/kurseve me qëllimet dhe rezultatet e pritura të programit

- *Dizajni i programit përfshin 23 kurse të përgjithshme dhe 10 kurse specifike për secilin specializim, me përjashtim të specializimit Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut, i cili ka të përcaktuara 15 kurse specifike.*
- *Elementet përbërëse të dizajnit të programit dhe të syllabuseve janë të njëjta. Njëjtë edhe fokusi në metodologji të mësimdhënies dhe në praktikë pedagogjike.*
- *Ka dallime në disa kurse në përshkrimin i lëndës së bërë në formularin e syllabusit kundrejt përshkrimit në dokumentin e akreditimit të programit Master.*
- *Jo në të gjitha syllabuset përputhen përshkrimi i lëndës, qëllimi dhe rezultatet e pritura me ligjëratat e përcaktuara për t'i zhvilluar.*
- *Qasja se si përvijohen qëllimet e lëndës dhe rezultatet e pritura të nxënies është e ndryshme në disa lëndë. Ndryshimet vërehen në organizim dhe në përmbajtje. Në disa raste janë të njëjta, ose rezultatet e nxënies nuk i përgjigjen qëllimeve të lëndës, ose qëllimet janë jashtë kontekstit të lëndës, apo janë vendosur rezultate të cilat nuk janë të ndërlidhura me tema ose veprimtari praktike të mbuluara nga kursi përkatës etj.*

- Në raport me rezultatet e të nxënit, në syllabus të ndryshëm ka shumë raste kur rezultatet e të nxënit janë vendosur kryesisht në nivel të njohurive, me formulime të përgjithshme, të pastandardizuara për nga elementet përbërëse të rezultateve, me përdorim të foljeve pasive, me ndryshim të përdorimit të numrit njëjës apo shumës, etj.
- Në një numër të syllabuseve theksi i përshkrimit vihet në rëndësinë e lëndës/kursit, jo në aspektet kryesore të përmbajtjes që adreson lënda/kursi përkatës.
- Në disa kurse, edhe pse janë kurse që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënit, kryesisht kanë tema teorike, pa rezultate të nxënit që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënit në situata praktike.

(ii) Lidhja e programit me kompetencat për mësimdhënës dhe kërkesat e kurrikulës së bazuar në kompetenca

- Ka elemente ndërlihdhëse me kurrikulën e bazuar në kompetenca, por me një fokus në lëndë të veçanta edhe për fushat e integruara (Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi).
- Qasja e integruar nuk reflektohet në disa nga kurset obligative të lidhura me metodologjinë e të nxënit. Janë përcaktuar kurse të veçanta, si për shembull kursi për gjuhë, kursi për letërsi, kurse për lexim letrar.
- Për lëndën edukatë qytetare, e cila është pjesë e fushës kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi, nuk ka specializim të veçantë. Kjo lëndë mbulohet vetëm me një lëndë/kurs me zgjedhje Mësimdhënia për Edukatë Qytetare.
- Në përpjekje për të zhvilluar të nxënit interdisiplinar në një program të caktuar, është përzgjedhur vetëm një koncept dhe është bërë lëndë e veçantë (kurs me zgjedhje - Keqkonceptimet në të nxënit e kimisë).
- Jo të gjitha përshkrimet e kurseve (kurseve të përgjithshme dhe e kurseve specifike për specializimet) pasqyrojnë informimin dhe lidhjen me kompetencat për mësimdhënës, përfshirjen e elementeve bazë të kërkesave për mësimdhënës që dalin nga Korniza për zhvillimin e

mësimdhënësve në Kosovë, Korniza Evropiane, Korniza për kompetencat digjitale.

- *Gjuha e kompetencave kryesore nuk përfaqësohet në nivelin e pritur si në syllabuset e kurseve të përgjithshme, ashtu edhe në syllabuset e kurseve specifike për specializimet master.*
- *Përfaqësimi i elementeve të filozofisë së kurrikulës së bazuar në kompetenca, rezultateve të nxënit dhe e kërkesave për transformim të mësimdhënies është periferik, si në raport me rezultatet e të nxënit, ashtu edhe në përcaktimet për metodologji të mësimdhënies dhe të vlerësimit, por edhe në literaturën bazë të vendosur në syllabuset e lëndëve të specializimeve;*
- *Çështjet ndërkurrikulare të përcaktuara në Kurrikulat Bërthamë (KB 2 dhe KB 3), si tema me interes për shoqërinë, si Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media, dhe Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, etj. preken në mënyrë të fragmentuar, apo nuk ka një qasje të integruar ndaj përfshirjes së tyre në kurset lëndore të secilit specializim.*
- *Kursi Shfrytëzimi i teknologjisë në arsim (lëndë e përgjithshme për të gjitha specializimet) ka një fokus relativisht të mirë në zbatimin e TIK në mësimdhënie dhe të nxënë, në vlerësim, zhvillim të aftësive digjitale për qëllim të të nxënit; krijim të përmbajtjeve digjitale etj. Mirëpo, kjo qasje nuk reflektohet edhe në kurset tjera ku është e nevojshme kompetenca digjitale në mësimdhënie.*

(iii) Qasjet ndaj njohurive akademike të lëndës(ve) dhe komponentëve psikologjike-pedagogjike – didaktike dhe praktike

- *Programi i studimit master në tërësinë e tij është i bazuar në konceptin ‘mësimdhënia e bazuar në teori dhe praktikë, mirëpo kjo qasje nuk duket shprehimisht në përmbajtjet e të gjitha kurseve të përgjithshme dhe në kurset specifike për specializimet dhe në literaturën bazë dhe plotësuese.*

- *Njohuritë akademike për specializimet përkatëse fitohen në programet Bachelor të njësisve akademike përkatëse, kjo theksohet te qëllimi i programit të studimit. Mirëpo, nuk ka ndonjë orientim hyrës në përshkrimet e programeve lëndore se si programi i ri do të thellojë të kuptuarit për konceptet kyçe që mësohen në kurrikulat e shkollës së mesme të ultë dhe atë të lartë, nivele këto për të cilat përgatiten studentet Master në specializime lëndore;*
- *Marrë në përgjithësi, komponentët psikologjike-pedagogjike – didaktike mbulohen gjatë programit të studimit master, mirëpo në përshkrimet e kurseve vërehet fokusimi në përmbajtje lëndore të kursit përkatës, në disa kurse kryesisht në nivel të njohjes.*
- *Ka tri kurse të përgjithshme të cilat specifikojnë qëllimin dhe pritshmëritë e praktikës pedagogjike. Ato janë integruar si kurse të obligueshme në të gjitha specializimet, për të cilët nuk ka dallime. Kjo le të kuptohet se shumë aspekte metodologjike të veçanta për specializimet përkatëse, nuk trajtohen nga veçantitë e specializimeve, apo ky aspekt është i varur nga bartësit e praktikës pedagogjike.*

(iv) Qasjet ndaj metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit

- *Udhëhiqen në bazë të formatit të shkrimit të syllabuesve, specifikave të specializimeve dhe profilit të mësimdhënësve zhvillues të syllabuseve të lëndëve përkatëse.*
- *Referuar programit Master në Mësimdhënie lëndore, qëllimi i përgjithshëm i programit është të avancojë më tutje kompetencat moderne të mësimdhënies dhe të praktikës pedagogjike. Ky qëllim nuk reflektohet në qasjet ndaj metodologjisë të përshkruar në syllabuset e lëndëve, por edhe në konceptet dhe temat e disa lëndëve.*
- *Ka shembuj të mirë ndaj qasjes metodologjike në disa kurse, mirëpo në përgjithësi, në përcaktimet për metodologji, dominon ligjërimi si një qasje kryesore e metodologjisë.*

- *Dizajni i mësimi i organizuar në ligjërata tregon se temat – kryesisht organizohen për të përcjellë konceptet bazë të lëndës/kursit, për të cilat në shumë raste qasja metodologjike e përcaktuar në syllabuse, nuk shkon përtej përmbajtjes së temave.*
- *Qasja ndaj të nxënit të bazuar në kërkim, ndaj mësimdhënies reflektuese, mësimdhënies së diferencuar, janë sipërfaqësore. Ose disa kurseve që konsiderohen tejet të rëndësishme për mësimdhënien siç është për shembull Mësimdhënia e diferencuar, janë kurse zgjedhore që nuk siguron mbajtjen e tyre në të gjitha specializimet;*
- *Edhe qasjet që lidhen me zhvillim të shkathtësive të mësimdhënies për menaxhim të klasës, integrimin ndërfaqësor, integrimin e përmbajtjeve ndërkurrikulare, nuk janë të përfshira mjaftueshëm në përcaktimet për metodologji të mësimdhënies.*
- *Në disa raste vërehet tendencë për parcializim të qasjeve metodologjike sipas koncepteve të lëndës/kursit. Për shembull brenda një kursi për mësimdhënien dhe të nxënit përcaktohen deri në 7 ligjërata të veçanta për Mësimdhënien dhe të nxënit për koncepte të ndryshme: 1. Mësimdhënia dhe të nxënit për kulturën dhe grupet sociale; 2. Mësimdhënia dhe të nxënit për shoqërinë njerëzore; 3. Mësimdhënia dhe të nxënit për tokat... Kjo qasje reflekton qasje tradicionale ndaj mësimdhënies dhe të nxënit.*
- *Vërehet qasje sipërfaqësore në disa kurse ndaj mbarështrimit të temave për mësimdhënien dhe të nxënit, apo ka mungesë të thellimit në përmbajtje të temave për mësimdhënien dhe të nxënit. P.sh. ka raste kur për një ligjëratë janë planifikuar shumë tema për ligjërim që lidhen me mësimdhënien, si: Kriteret e modernizimit shkencor e didaktikë të mësimi; Metodatat e mësimdhënies, epërsitë, kufizimet; Metodatat me në qendër mësuesin; Metodatat me në qendër nxënësin; Metodatat e hulumtimit etj.*
- *Qasja ndaj vlerësimit është e diktuar nga formati i shkrimit të syllabuesve. Mënyra e vendosjes së të dhënave për metodatat e vlerësimit është më shumë teknike, me elemente tradicionale.*

- *Qasjet me disa elemente më kreative ndaj vlerësimit reflektohen në kursin Vlerësimi në Edukimin nga Kimia. Në specifikat e kurseve të specializimeve tjera lëndore për komponentin e vlerësimit ka më shumë aspekte të përgjithshme të vlerësimit, edhe pse ato mbulohen në kursin e përgjithshëm për të gjitha specializimet: Vlerësimi në arsim.*
- *Nuk ka unifikim në përdorimin e koncepteve, përdoren koncepte të ndryshme në raport me vlerësimin si p.sh. Vlerësimi i parë intermediar; Vlerësimi i dytë intermediar; Testimi 1 dhe 2; Provimi gjysmësemestral.*
- *Ka dallime të theksuara në kriteret e vendosjes së notës, në disa kurse nota 6 vendoset me 50 – 60%, 55-60%, në disa me 50-59% në disa me 55-64 %. Pragu i kalueshmërisë është 70% e të gjithë komponentëve vlerësues në praktikën pedagogjike.*

3.2. Gjetjet nga intervistat me edukatorët e mësimdhënësve

Gjetjet kryesore të hulumtimit me edukatorët e mësimdhënësve janë të organizuara në tri tema kryesore. Ato të cilat janë përmbledhur në tabelën 4.

(i) **Sistemi për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit – PFM**

- *Edukatorët e mësimdhënësve reflektojnë dallime në varësi të rolit që kanë lidhur me informimin për politikat arsimore dhe dokumentet tjera të sistemit për PFM, si dhe për shfrytëzimin e tyre për zhvillimin e programeve për PFM.*
- *Theksohet se praktika e zhvillimit të programeve për PFM varet nga:*
 - *rregullimet në sistemin për PFM, të cilat në zbatim theksohet se lenë për t'u diskutuar;*
 - *politikat e brendshme të ofruesit të PFM për sigurim të cilësisë;*
 - *qasja e ofruesit ndaj punës bazuar në dokumentet e sistemit dhe dokumentet e brendshme.*

- *Koordinimi në mes të bartësve kryesorë që lidhen me funksionimin e sistemit për PFM theksohet se është i fragmentuar, jo mirë i informuar dhe shpesh i atakuar nga ndryshimet e shpeshta në sistemin për PFM.*
- *Koordinimi dhe harmonizimi për përgatitjen e PFM vlerësohet se është kriter shumë i rëndësishëm për të ngritur cilësinë në arsimimin e mësimdhënësve të ardhshëm.*
- *Mekanizmat e përzgjedhjes kandidatëve në programet për mësimdhënës të vendosur në vitet e fundit, theksohet se janë duke u sfiduar nga rënia e interesimit për studime në disa programe për mësimdhënës, specifikohen programet e mësimdhënies Matematikë dhe Fizikë.*
- *Mbahet evidencë për trendët e regjistrimit dhe diplomimit të studentëve në programet për mësimdhënës, por nuk ofrohen shumë detaje si përdoren evidencat për planifikime të mëtejme për regjistrim të studentëve të rinj;*
- *Çështja e planifikimeve për studentë theksohet se ka filluar të diktohet nga trendi i ndryshimit të nxënësve të arsimit parauniversitar, për të cilin theksohet se nuk ka një qasje të mirë institucionale për përgjigje ndaj nevojave për mësimdhënës të ardhshëm.*
- *Në procesin e akreditimit theksohet se nuk përdoren fushat dhe standardet e mësimdhënies, mbi bazën e të cilave duhet të dizajnohen programet për PFM;*
- *Mungesa e një sistemi cilësor të mentorimit të studentëve në praktikën pedagogjike në shkolla ndërlihet me mos zbatimin e sistemit të gradimit të mësimdhënësve.*

(ii) Reflektimi në programe të studimit i fushave të zhvillimit të kompetencave të mësimdhënësve dhe kërkesave të reformës së kurrikulës në arsimin parauniversitar

- *Sipas edukatorëve të mësimdhënësve, praktika e zhvillimit të programeve për PFM në parim udhëhiqet nga fushat e zhvillimit të*

kompetencave të mësimdhënësve, të cilat shfrytëzohen me sipas specifikave të lëndëve/kurseve.

- *Fushat e mësimdhënies që lidhen me zhvillimin e vlerave dhe krijimin e qëndrimeve shihen si më pak të adresuara në programin e studimit. Për këtë iu referohen analizës së gjendjes në Planin zhvillimor të FE (2022 – 2026).*
- *Ekziston konsensusi se në programet për PFM janë integruar mirë komponentët si: Komponenti akademik - njohuritë akademike të lëndës(ve); Komponenti psikologjik, pedagogjik dhe didaktik për punë me nxënës; dhe Komponenti praktik i programeve për punë të studentëve me nxënës. Mirëpo, shumica theksojnë se janë vetëkritikë se në praktikë nuk zhvillohen të balancuara këta komponentë, të cilët varen shumë nga komponenti e mësimdhënies së edukatorëve të mësimdhënësve.*
- *Programet për përgatitjen e mësimdhënësve përshkruhen me sfida të shumta, si në raport me fokusimin më shumë në përmbajtje lëndore (kryesisht në nivel të njohjes), ashtu edhe me elemente të përmbajtjeve të vjetruara të didaktikës/ave lëndore.*
- *Konceptet e reformës kurrikulare, si mësimdhënia e bazuar në kompetenca, mësimdhënia e integruar, mësimdhënia me nxënësin në qendër, individualizimi dhe mësimdhënia e diferencuar në klasa gjithëpërfshirëse, vlerësohet se nuk janë të përfshira dhe të trajtuara mjaftueshëm në kuadër të specializimeve lëndore.*
- *Në përgjithësi, të kuptuarit e filozofisë së kurrikulës së bazuar në kompetenca dhe rezultate të të nxënësve dhe transformimi i mësimdhënies në këtë drejtim shihen si një sfidë më vete.*
- *Edukatorët e mësimdhënësve theksojnë se kërkimi shkencor është komponent i programeve të përgatitjes së mësimdhënësve, i reflektuar në lëndët/kurset obligative dhe me zgjedhje, por jo mjaftueshëm në praktikën e punës me studentë.*

(iii) Sigurimi i cilësisë së programeve për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit (PEM)

- *Reflektohet besim në sistemin i sigurimit të cilësisë së programeve për PFM. Njëkohësisht shtrohen kërkesa për ndryshim të qasjes ndaj vlerësimit të programeve akademike në bazë të standardeve dhe kompetencave të profesionit të mësimdhënësit, përdorimit të standarde cilësore në raport me programet për mësimdhënës etj.*
- *Funksionalizimi i mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë tek institucionet që ofrojnë programe për përgatitjen e mësimdhënësve, shihet sfidë më vete, e cila për tu tejkaluar kërkon qasje institucionale nga të gjithë ofruesit e programeve për mësimdhënës.*
- *Në raport me cilësinë e përgatitjes së mësimdhënësve, mendimi është i ndryshëm në mesin e edukatorëve të mësimdhënësve. Me dominim në drejtim të cilësisë së lartë të përgatitjes së mësimdhënësve, me vetëm një rast, ku theksohet cilësi e ulët e përgatitjes së mësimdhënësve të ardhshëm.*
- *Cilësia e përgatitjes së mësimdhënësve të ardhshëm në programet lëndore theksohet së është e varur nga cilësia e hyrjes – studentëve që regjistrohen. Ngrihet shqetësimi se ka disa vite që studentët e shkëlqyeshëm nuk e shohin si prioritet Fakultetin e Edukimit dhe punën në arsim.*
- *Në raport me vlerësimin e lartë për cilësinë e përgatitjes së mësimdhënësve, theksi vihet kryesisht te përmbajtja akademike, procesi dhe numri i të diplomuarave.*
- *Konferencën vjetore ndërkombëtare KICER (2021, 2022, 2023) e shohin si një mundësi për të ofruar njohje dhe praktika të reja shkencore me synim përmirësimin e cilësisë së programeve për PFM dhe përgjithësisht përmirësimin e cilësisë në arsim.*

Nga këndvështrimi i edukatorëve të mësimdhënësve, ndryshimet e shpeshta në kurrikulat e arsimit parauniversitar, në normativat për mësimdhënës, dhe në dokumentet tjera që lidhen me PFM, shihen si një element që ka sfiduar

ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm për PFM. Gjithashtu, referuar këtyre ndryshimeve, theksohet se nuk është arritur të sigurohet përputhja e programeve me politikat shtetërore që lidhen me profesionin e mësimit, kur kemi parasysh kurrikulën e re dhe organizimin e saj në fusha kurrikulare.

Rezultatet nga perspektiva e edukatorëve të mësimit tregojnë se ka një lëvizje para në drejtim të përfshirjes në programe të komponentëve si: Komponenti akademik - njohuritë akademike të lëndës(ve); Komponenti psikologjik, pedagogjik dhe didaktik për punë me nxënës; dhe Komponenti praktik i programeve për punë të studentëve me nxënës. Kompetenca e mësimit tek edukatorët e mësimit theksohet se shpesh e sfidon integrimin në praktik të këtyre komponentëve. Në këtë drejtim, zbatimi i komponentit praktik të programeve për punë të studentëve me nxënës del të jetë më sfidues.

Gjetjet sipas pikëpamjeve të edukatorëve të mësimit tregojnë se programet për përgatitjen e mësimit përshkruhen me sfida të shumta, me një fokus më të madh në përmbajtjet lëndore, me përmbajtje të vjetruara të didaktikës, me mungesë të lëndëve ose të zbatimit të tyre për zhvillim të shkathtësive të mësimit së diferencuar në klasa gjithëpërfshirëse, menaxhimit të klasës, ballafaqimit dhe bashkëpunimit me komunitetin, integrimin ndërfaqor, integrimin e përmbajtjeve ndërkurrikulare etj.

Vlerësohet tradita e ndërtuar në qasjen institucionale ndaj akreditimit/riakreditimit të programeve për mësimit. Përgjithësisht reflektohet besim në sistemin e sigurimit të cilësisë së programeve për PFM. Për këtë përdoret referenca në raportet e akreditimit dhe vlerësimet e studentëve dhe të vetë stafit mësimit, si dhe nga analiza të brendshme. Theksohet se Agjencia e Kosovës për Akreditim nuk ka kërkesa dhe nuk praktikon një dokument apo standarde të veçanta për vlerësimin e programeve për PFM.

Edukatoret e mësimit shpalosën disa sfida, me të cilat përballen në raport me programet e studimit dhe përgjithësisht me sigurimin e cilësisë së programeve për përgatitjen e mësimit para shërbimit, si:

- *Transformimi i mësimdhënies drejt mësimdhënies dhe të nxënit aktiv për të zhvilluar kompetencat të kulturës demokratike për vlerat, qëndrimet, shkathtësitë dhe njohuritë.*
- *Të kuptuarit e filozofisë së kurrikulës së bazuar në kompetenca dhe rezultate të të nxënit.*
- *Integrimi në programe të studimit i kërkesave të reformës kurrikulare të arsimit parauniversitar.*
- *Mungesa e strategjive zhvillimore të fakulteteve të edukimit,*
- *Mundësitë e kufizuara për të tërhequr nxënësit me potencial të mirë si rrjedhojë e orientimit në fusha të tjera si (teknologjia, etj.).*
- *Mungesa e vlerësimit të programeve akademike mbi bazën e standardeve dhe kompetencave të profesionit të mësimdhënësit, standarde jo shumë përmbajtjesore (më tepër kuantitative) të akreditimit të programeve.*
- *Vlerësimi i programeve nga ekspertë të ndryshëm, të cilët nuk përdorin të njëjtin standard ose nuk mund të krahasojnë programet mes vete, në nivel vendi.*
- *Kapacitetet e personelit akademik/mësimdhënës dhe cilësia e mësimdhënës.*
- *Aspektet organizative dhe të menaxhimit të procesit mësimor të diplomimit dhe të mbikëqyrjes së praktikave pedagogjike etj.*

Gjithashtu, gjetjet e studimit me edukatorë të mësimdhënësve tregojnë se ata tashmë i kanë identifikuar disa mundësi, orientime për vetëpërmirësim dhe avancim të PFM. Ato reflektohen kryesisht nga prodekanët për Çështje Mësimore. Në raport me programet dhe mësimdhënien nga edukatorët e mësimdhënësve, mundësitë i shohin në:

- *Integrimin e qasjes së të nxënit të bazuar në kërkim.*
- *Përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe të nxënë.*

- *Planifikimin e rezultateve të të nxënit përtej njohurive, si dhe rritjen e rezultateve të nxënit për zhvillimin e shkathtësive dhe vlerave të studentët mësimdhënës.*
- *Ngritjen e cilësisë së praktikës pedagogjike, mentorimit dhe udhëheqjes gjatë praktikës.*
- *Zhvillimin e shkathtësive për reflektim si mjet për zhvillim profesional të mësimdhënësve të rinj.*
- *Zhvillimin e shkathtësive kërkimore dhe vendimmarrjes së bazuar në të dhëna.*
- *Zhvillimin e punës praktike në fakultet (simulimet) etj.*

Ndërsa, në raport me sigurimin e cilësisë së programeve për PFM, mundësitë për përmirësim dhe avancim i shohin te:

- *Aplikimi i standardeve për mësimdhënës në akreditim/riakreditim të programeve për përgatitjen e mësimdhënësve të ardhshëm.*
- *Zhvillimi i planifikimeve strategjike dhe i politikave të brendshme për sigurim të cilësisë dhe zbatimi i tyre, nga fakultetet që përgatisin mësimdhënës të ardhshëm.*
- *Vendimmarrja e bazuar në të dhëna nga të gjithë aktorët relevantë.*
- *Zhvillimi i mekanizmave për vlerësim të performancës së stafit akademik.*
- *Rishikimi i programeve bazuar në të dhëna dhe informata kthyese të studentëve, stafit akademik, punëdhënësve të mësimdhënësve, të diplomuarve, etj.*
- *Përgatitje e programit të studimit Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializim) në bashkëpunim me fakultetet të cilat i përgatisin studentët në nivelin Bachelor;*
- *Integrimi i teknologjisë në të gjitha programet si lëndë obligative;Krahasueshmëria ndërkombëtare (BE) e programeve për përgatitje të mësimdhënësve.*

3.3. Gjetjet nga intervistat me mësimdhënës fillestarë

Të kuptuarit në thelb të asaj që konsiderohet përgatitje e duhur për të ushtruar profesionin e mësimdhënësit mund të vijë nga mësimdhënësit fillestarë, të cilët para 1-2 vjetësh kanë filluar të ushtrojnë profesionin e mësimdhënësit. Prandaj, në këtë studim është marrë edhe mendimi i mësimdhënësve fillestarë për përgatitjen universitare të tyre për të ushtruar profesionin e mësimdhënësit.

Rezultatet me mësimdhënësit fillestarë të përfshirë në këtë studim tregojnë se ata kanë përvoja të ndryshme në mësimdhënie, kanë pikëpamje të përafërta sa i përket cilësisë së përgatitjes universitare të mësimdhënësve para shërbimit. Gjetjet kryesore janë organizuar në katër tema kryesore.

Përvoja fillestare në mësimdhënie. Përvoja fillestare në mësimdhënie përshkruhet me dallime të ndikuara nga niveli i përgatitjes universitare (BA dhe MA), tradita e punës së shkollës ku mësimdhënësit fillestarë kanë filluar të ushtrojnë profesionin e mësimdhënësit, mentorimi dhe këshillimi nga drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit më përvojë, si dhe nga mundësia për përfshirje në programet e trajnimit në vitet e para të përvojës së punës.

Në përgjithësi, mësimdhënësit e intervistuar përvojën e tyre fillestare në ushtrimin e profesionit e përshkruajnë si një përvojë të mirë, e përcjellë me vështirësi dhe sfida të ndryshme, ballafaqim me situata reale, emocione, përgjegjësi dhe frikë në arritjen e rezultateve të pritura.

Ishte një fillim më stresues se sa kam menduar dhe dëgjuar, solli të kuptuarit se sa stresuese është realisht të qenit një mësuese (m/6)⁴.

Pjesa më dobishme e përvojës fillestare në mësimdhënie reflektohet në mënyra ndryshme nga mësimdhënësit fillestarë të intervistuar, në varësi të përvojës që kanë kaluar. Jo të gjitha përvojat e dobishme lidhen me situata nga puna me nxënës, por nga mënyra se si e kanë parë përparimin e tyre.

Pjesa më e dobishme e përvojës sime fillestare ka qenë të përmirësuarit e të shprehurit para masës (m/5).

⁴ Paraqet mësimdhënësin sipas numrit rendor të raportuar në mostrën e mësimdhënësve fillestarë.

Ka disa tema të përbashkëta që flasin për dobi të fituara gjatë përvojës fillestare, tema që lidhen me adaptimin në punën me nxënës, pastaj me bashkëpunimin me kolegë mësimdhënës, bashkëpunimin me prindër, praktikimin e qasjeve metodologjike të mësimdhënies dhe vlerësimit të nxënësve etj.

Në anën tjetër, mësimdhënësit fillestarë kur i përshkruajnë sfidat e përvojës fillestare në mësimdhënie i lidhin kryesisht me planifikimin mësimor në ndërlidhje me kërkesat e kurrikulës, vlerësimin e nxënësve, menaxhimin e numrit të madh të nxënësve (iu referohen klasave me nxënës mbi 30 nxënës), të kuptuarit e personaliteteve të të gjithë nxënësve me të cilët punojnë, veprimi me korrektësi ndaj situatave të ndryshme me nxënës etj.

Sfidat, të cilat unë kryesisht i kam hasur, kanë qenë gjetja e një balancimi midis një natyre të qetë dhe të dashur, si dhe një natyre për disiplinë të drejtë dhe korrekte ndaj nxënësve (m/2).

Mësimdhënësit fillestarë, kur flasin për sfidat me të cilat janë ballafaquar në përvojën e tyre fillestare në mësimdhënie, ato kryesisht i ndërlidhin me përgatitjen jo të duhur për t'u ballafaquar më lehtë me këto sfida, me mungesë të mbështetjes nga shkolla dhe me mungesë të trajnimeve në vitet e para të përvojës së tyre në mësimdhënie.

Në mesin e mësimdhënësve të intervistuar, gjashtë prej tyre shprehen se kanë arritur t'i menaxhojnë sfidat me ndihmën e të afërmeve që kanë përvojë në mësimdhënie, me këshillim nga mësimdhënësit kolegë, por edhe nga angazhimi personal.

Në shumicën e situatave kam kërkuar gjithmonë këshilla nga persona të cilët kanë qenë me përvojë në arsim, sidomos nga koleget e aktivitetit, si dhe kam rishqyrtuar literaturën e përdorur gjatë studimeve (m/6).

Edhe pse gjashtë mësimdhënës të intervistuar janë shprehur se kanë marrë këshilla dhe përkrahje nga kolegët e tyre mësimdhënës me përvojë, mbështetja profesionale nuk tregohet të ketë qenë e organizuar dhe sistematike, e përcjellë me ndonjë planifikim të mentorimit zyrtar në nivel shkolle.

Kam marrë ndihmë vetëm kur unë kam kërkuar. Shpesh jam ndier jo mirë për të kërkuar ndihmë nga drejtori i shkollës ose ndonjë mësues të mësimit me përvojë (m/11).

Në shumicën e rasteve tregohet se mbështetjen e vetme e kishin dërgimin në trajnimin për zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca.

Vlerësimi për cilësinë e përgatitjes universitare të mësuesve para shërbimit. Nga një mundësi vlerësimi me shkallët e vlerësimit 1-10 për cilësinë e përgatitjes universitare të mësuesve para shërbimit, mësuesit e përfshirë në këtë studim vlerësojnë në këtë mënyrë: një mësues me shkallën 5 (cilësi e ulët), shtatë mësues me shkallën 6, një mësues me shkallën 7, dhe dy mësues me shkallën 8.

Bazuar në përvojën fillestare në mësuesi, mësuesit e intervistuar vlerësojnë se gjatë studimeve janë përgatitur më mirë për: *Njohuritë akademike të lëndës(ve) që duhen përvetësuar.*

Deri në një masë janë përgatitur për fushat:

- *Teoritë e mësimit;*
- *Mësimi dhe angazhimi për zhvillim të vazhdueshëm profesional;*
- *Përdorimi i teknologjive në mësim;*
- *Vlerat profesionale, besimet, qëndrimet dhe sjelljet në mësuesi.*

Ndërsa, pak ose disa janë përgatitur për fushat që lidhen me:

- *Psikologjinë zhvillimore për punë me nxënës;*
- *Praktikat e mësimit - duke përfshirë qasjet metodologjike, menaxhimin e nxënësve dhe klasës, shkathtësitë në përdorimin e materialeve dhe burimeve mësimore etj.*
- *Punën me kurrikulën - planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës së bazuar në kompetenca;*
- *Shkathtësitë dhe praktika profesionale për vlerësimin e nxënësve (vlerësimi formues dhe vlerësimi përmbledhës).*

Fushat e programeve për përgatitjen e mësimeve të vlerësuara më pak ose disi nga mësuesit e intervistuar ndërlidhen kryesisht me cilësinë e praktikës pedagogjike, e cila vlerësohet se nuk është shumë efektive në shkollat ku organizohet, nuk përfshin ballafaqimin me situatat reale të ushtrimit të mësimit, duke filluar nga planifikimi real i mësimit deri te vlerësimi i nxënësve për kohën e mësimit.

Nuk është shumë efektive praktika pedagogjike në shkollë. Gjatë praktikës, nuk kemi arritur të përvetësojmë shkollësit e mësimit (nga mosdija e mësuesit mentor ose nga mosdëshira për të dhënë informata nga ana e tyre). Sfidat e mia fillojnë nga plotësimi i ditarit personal gjatë praktikës pedagogjike, sepse gjatë shkrimit të orës mësimore mësuesja mentore shkruante diçka tjetër, mirëpo në realitet ishte shumë mbrapa me planifikim. Kësisoj, më është dashur “të gënjej”, të imagjinoj e të shkruaj pozitivisht mbarëvajtjen e procesit mësimor (m/1).

Edhe pse i kam bërë tri praktikat pedagogjike, nuk është se kam mësuar shumë, apo më kanë shërbyer shumë kur kam filluar të ushtroj profesionin e mësimit (m/7).

Nga të gjithë mësuesit e intervistuar, vetëm tre prej tyre ndajnë mendimin se praktika pedagogjike gjatë studimeve u ka ndihmuar që të jenë më të suksesshëm në përvojën fillestare në mësime.

Efkti i praktikës pedagogjike në vitin e parë të punës sime në ushtrimin e profesionit të mësimit ka qenë i rëndësishëm, sepse nëpërmjet saj kam fituar përvojë në mësime dhe në menaxhimin e klasës (m/3).

Sugjerimet e mësimeve fillestare për përmirësimin e programeve universitare për përgatitjen e mësimeve të ardhshme.

Mësuesit e intervistuar, duke shikuar nga perspektiva e nevojave të tyre të shpërfaqura gjatë përvojës fillestare në mësime, e konsiderojnë prioritet përmirësimin e programeve universitare për përgatitjen e mësimeve të ardhshme. Sugjerimet për përmirësim kryesisht përfshijnë fushat e programeve për përgatitjen e mësimeve për të cilat janë shprehur se pak apo disi janë përgatitur për mësime fillestare.

Pra, orientimet për përmirësim të programeve lidhen me vendosjen e fokusit në psikologjinë zhvillimore për punë me nxënës, praktikat e mësimdhënies - përfshirë qasjet metodologjike, menaxhimin e nxënësve dhe klasës, shkathhtësitë në përdorimin e materialeve dhe burimeve mësimore etj., planifikimin dhe zbatimin i kurrikulës së bazuar me kompetenca, si dhe vlerësimin e nxënësve – përfshirë vlerësimin formues dhe vlerësimin përmbledhës. Për të gjitha këto fusha sugjerohet të ndërlihen me praktikën pedagogjike, e cila, sipas tyre, duhet të përmbushë nevojat reale të punës me nxënës, të ushtrimit të profesionit të mësimdhënësit.

Mendoj që duhet të përfshihen më shumë lëndë metodologjike, kurse të praktikave pedagogjike me periudha më të gjata, trajnime që kanë të bëjnë me përgatitjen e studentit në përdorimin/zbatimin e teknikave dhe metodologjive të ndryshme në praktikë (m/3). Duhet fokusuar te praktikat e mësimdhënies, duke përfshirë qasjet metodologjike, vlerësimin e nxënësve, menaxhimin e nxënësve dhe klasës, shkathhtësitë në përdorimin e materialeve dhe burimeve mësimore etj. (m/2).

Praktika pedagogjike duhet të fuqizohet në mënyrë që mësimdhënësit e ardhshëm të mos ballafaqohen me sfida dhe situata të vështira...(m/8).

Një fokus më i madh duhet të jetë në kurrikulën për të cilën ne përgatitemi (disa gjera janë shpjeguar shkel e shko, edhe kur kam kërkuar përgjigje për disa çështje realisht nuk kam marrë përgjigje ose përgjigjet i kam marrë tejet sipërfaqësore). Profesorët bashkë me studentët duhet të jenë më kreativë në realizimin e shumë aktiviteteve, jo gjithçka të jetë e mbuluar vetëm me ligjërata (m/1).

Sugjerimet për mbështetjen e mësimdhënësve fillestarë nga shkollat - drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit me përvojë. Mësimdhënësit fillestarë të intervistuar e shohin tejet të rëndësishëm ndryshimin e praktikës së pritjes dhe të mbështetjes nga shkollat të mësuesve fillestarë. Ata mentorimin dhe këshillimin e mësimdhënësve fillestarë në nivel të shkollës e shihnin nga një perspektivë e detyrave dhe përgjegjësive në nivel shkolle, që kanë obligim të ofrojnë mbështetje për të gjithë mësimdhënësit fillestarë.

Sugjerimet për mbështetjen e mësimdhënësve fillestarë nga shkollat prekin pothuajse të gjitha fushat e punës praktike të mësimdhënies, duke filluar me aspektet e planifikimit mësimor, informimin rreth nxënësve dhe punën me ta, menaxhimin e situatave për të përballuar sfidat fillestare, por edhe me përkrahje në ambientimin me shkollën. Sugjerimet shkojnë deri tek ofrimi i mundësive të mësimdhënësve fillestarë për të ndjekur trajnime në bazë të nevojave të identifikuar përmes monitorimit të orëve të para në mësimdhënie reale.

Drejtoret të jenë më ndihmues e përkrahës për mësimdhënësit e rinj, sidomos me ambientimin në shkollë, në krijimin e planeve, në dhënien e informacioneve për nxënësit e asaj shkolle (m/1).

Mësimdhënësit me përvojë jo vetëm që duhet të jenë bashkëpunues me mësimdhënësit fillestarë dhe t'i mbështesin ata, por edhe duhet të jenë të kujdesshëm mos të paragjykojnë për punën e tyre (m/7).

Mësimdhënësit fillestarë duhet të ndihmohen rreth mënyrës së hartimit të planeve, të ketë komunikim me të shpeshtë me ta dhe të japin sa më shumë ndihmë në menaxhimin e situatave të ndryshme që mund të përballen si fillestarë (m/5). Mësimdhënësit fillestarë duhet të përfshihen nga shkolla në trajnimet adekuate, të cilat lidhen me nevojat e mësimdhënësve, të identifikuar pas monitorimit të disa orëve të mësimi (m/2).

Sugjerimet e mësimdhënësve kanë një ndërlidhje me sugjerimet e edukatorëve të mësimdhënësve në raport me programet dhe mësimdhënien me studentët mësimdhënës të ardhshëm.

4. Diskutime dhe konkluzione

Përgatitja e mësimdhënësve para shërbimit paraqet hapin e parë drejt zhvillimit të karrierës së mësimdhënësve. Kjo fazë e zhvillimit të karrierës është e lidhur ngushtë me programet universitare për mësimdhënie, të cilat kanë në fokus formimin mësimdhënësve të ardhshëm, apo përgatitjen e tyre me kompetenca të duhura për mësimdhënie kreative dhe krijuese, me atë që duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë në praktikën e punës me nxënës.

Programet për PFM, të analizuara në këtë studim, karakterizohen me elemente unifikuese në strukturë dhe njëkohësisht me dallime në vendosjen e aspekteve përmbajtjesore që lidhen me kontributin për përmbushjen e pritshmërive për mësimdhënës dhe të kërkesave të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar. Dallimet e programeve për PFM, reflektohen edhe në diskutimet me edukatorët e mësimdhënësve dhe me mësimdhënësit fillestarë.

Referuar pyetjeve kërkimore, **së pari**, ne diskutojmë gjetjet nga analiza e programeve për përgatitjen e mësimdhënësve të ardhshëm, me një fokus të veçantë në përfshirjen e pritshmërive për kompetencat e mësimdhënësve dhe të kërkesave të kurrikulës së bazuar në kompetenca në programet për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit në Kosovë.

Analiza e programeve për përgatitjen e mësimdhënësve të ardhshëm tregon se programet karakterizohen me elemente unifikuese në strukturë dhe me dallime në kontributin për përmbushjen e pritshmërive për mësimdhënës dhe të kërkesave të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar. Dallimet rrjedhin nga konteksti i zërthimit të qëllimeve dhe pritshmërive të programeve në lëndë/kurse përkatësisht në përshkrimet në syllabuse të lëndëve.

Analiza e programeve tregon se qasja e praktikuar në ndërlidhjen e përshkrimeve të lëndëve/kurseve me qëllimet dhe rezultatet e pritura të programit është një sfidë, e cila reflektohet në programet për përgatitjen e mësimdhënësve të analizuara në këtë studim. Kjo qasje sfidon përpjekjet për të siguruar kurrikulë koherente dhe gjithëpërfshirëse për të mbuluar të gjitha fushat e njohurive dhe për zhvillim të aftësive praktike në një mënyrë sinergjike me njohuritë teorike (OECD, 2019).

Gjetjet nga studimi tregojnë se përfshirja e kompetencave për mësimdhënës dhe e kërkesave të kurrikulës së bazuar në kompetenca në programet për PFM është e adresuar në mënyrë të ndryshme. E para, me një qasje mundësuese në përshkrime të programeve dhe syllabuseve të lëndëve. E dyta, me një qasje të kufizuar në përshkrim të syllabuseve të lëndëve që janë të fokusuar në përmbajtje. Të dy këto qasje janë të varura nga faktorët si

kapacitetet dhe mësimdhënia e edukatorëve të mësimdhënësve, të cilët nuk ishin objekt trajtimi në këtë studim.

Vlerësojmë se mënyra se si është bërë përfshirja në programet për PFM, e kompetencave për mësimdhënës dhe e kërkesave të kurrikulës së bazuar në kompetenca, nuk është e mbështetur në kërkesa nga procesi i akreditimit dhe në kërkesa formale të drejtuara nga organet përgjegjëse të Ministrisë së Arsimit. Argumentojmë se fleksibiliteti i lënë te bartësit e programeve dhe të lëndëve përkatëse ka sjellë dallime në konceptim të kurrikulës për mësimdhënës, siç është përshkruar në këtë analizë.

Elementi tjetër i identifikuar është mungesa e kurseve të veçanta apo edhe e qasjeve për zbatim të aspekteve që lidhen me zhvillimin e shkathtësive të mësimdhënies së diferencuar në klasa gjithëpërfshirëse, menaxhimin e klasës, integrimin ndërfaqor, integrimin e përmbajtjeve ndërkurrikulare etj. Të gjitha këto aspekte janë kërkesa të kurrikulës së bazuar në kompetenca dhe jo vetëm. Përfshirja e këtyre aspekteve në programe, ndër të tjera, mundëson të tejkalojmë edhe sfidën madhore që lidhet me të siguarit e përfitimit të nxënësve nga metodologjitë inovative (Rexhaj et al., 2009).

OECD-ja në studimin *Përmirësimi i sistemeve fillestare për përgatitje të mësimdhënësve* thekson nevojën që në radhë të parë të kërkohet të sigurohet përafrimi i kurrikulës për përgatitjen e mësimdhënësve me kontekstin e shkollës (OECD, 2019). Një orientim i tillë është theksuar edhe nga Caena (2014), i cili thekson se të kurrikula e formimit të mësimdhënësve të ardhshëm duhet të pasqyrojë nevojat në ndryshim të sistemit shkollor (Caena, 2014).

Ndërsa analiza e programeve Bachelor dhe Master në mësimdhënie tregon se qasjet ndaj njohurive akademike dhe praktike, në programet para shërbimit, në parim janë standarde të udhëhequra nga përcaktimi ligjor për zhvillimin e mësimdhënësve në karrierë (MASHTI, 2023), në bazë të të cilit përcaktohen ECTS për njohuritë akademike dhe praktike. Ndërsa sa u përket komponentëve psikologjikë-pedagogjikë-didaktikë, në raport me strukturën lëndore, është e njëjtë, mirëpo në përshkrime të një pjese e konsiderueshme të lëndëve/kurseve dominon fokusimi në përmbajtje lëndore.

Kjo qasje e pasqyruar në programet për PFM nuk reflekton përpjekjet e sistemit tonë arsimor për të siguruar ndikim pozitiv në arritjet e nxënësve. Dëshmitë kërkimore shkencore tregojnë se njohuritë pedagogjike kanë më shumë ndikim në arritjet e nxënësve sesa njohuritë për përmbajtjen e lëndëve (Musset, 2009). Nevojitet një fokus më i madh ndaj praktikës pedagogjike, e cila në raport me qasjen që udhëhiqet në shkolla del të jetë mjaft sfiduese.

Në raport me qasjet ndaj metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit, gjetjet e studimit tregojnë se ka qasje kreative në disa kurse, mirëpo dominon ligjërimi si një qasje kryesore e metodologjisë së përshkruar në syllabuset e lëndëve. Në anën tjetër, në shumicën e lëndëve/kurseve, dizajni i mësimi i organizuar në ligjërata tregon se temat kryesisht organizohen për të përcjellë konceptet bazë të lëndës/kursit. Nevojitet një fokus më i përqendruar në qasjet metodologjike dhe pedagogjike, sepse pedagogjia është vetë kurrikula, ajo që ka rëndësi është se si mësohen gjërat, e jo çfarë mësohet (Wiliam, 2015).

Me gjithë përpjekjet për ndryshim të qasjeve të metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit, në programe vazhdojnë të mbahen shumë elemente të paradigmes tradicionale të mësimdhënies dhe vlerësimit, e cila kryesisht fokusohet në përmbajtje. Ndryshimi i kësaj paradigme është në përgjegjësinë e edukatorëve të mësimdhënësve, prandaj nevojitet krijimi i një strategjie për vetëpërmirësim, duke përdorur të dhëna për rishikime formuese dhe plane të përmirësimit (OECD, 2019).

Së dyti, në këtë studim diskutojmë gjetjet nga mendimi i personelit akademik - edukatorëve të mësimdhënësve për sistemin, programet për mësimdhënësit e ardhshëm dhe sigurimin e cilësisë së programeve. Gjetjet tregojnë se edukatorët e mësimdhënësve sistemin për përgatitjen e mësimdhënësve e shohin mjaft kompleks, të përcjellë me ndryshime të shpeshta që kanë ndikuar në cilësinë e përgatitjes së mësimdhënësve të rinj. Gjithashtu, gjetjet tregojnë se edukatorët e mësimdhënësve, në varësi të rolit që kanë, reflektojnë dallime lidhur me informimin për politikën arsimore dhe dokumentet e tjera të sistemit për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit, shfrytëzimin e tyre në zhvillimin e programeve dhe të kurrikulave të programeve.

Në një situatë të tillë, kur nuk ka përgjigje institucionale ndaj sfidave të sistemit për përgatitjen e mësimit të ardhshëm dhe nuk është i plotë përdorimi i dokumenteve zhvillimore të sistemit, siç janë standardet për mësimit dhe kërkesat e reformës kurrikulare, kemi të bëjmë me mungesë të kulturës institucionale për të shpërndarë informatën dhe një formë të heshtur për të monitoruar adresimin e kërkesave dhe përgjegjësi që dalin nga sistemi për përgatitjen e mësimit të ardhshëm. Sipas Zeichner (2005), kultura institucionale mund të jetë një mjedis mundësues dhe kufizues për punën e edukatorëve të mësimit të ardhshëm (sipas Kaçaniku, 2023).

Gjetjet nga shqyrtimi i pikëpamjeve të edukatorëve të mësimit të ardhshëm lidhur me programet për përgatitjen e mësimit të ardhshëm para shërbimit janë në përputhje me gjetjet nga analiza e programeve, sa u përket argumenteve që lidhen me fokusimin më shumë në përmbajtje lëndore dhe mungesës të lëndëve ose e zbatimit të tyre për zhvillim të shkathët të mësimit të ardhshëm të diferencuar në klasa gjithëpërfshirëse, menaxhimit të klasës, integrimin ndërfushor, integrimin e përmbajtjeve ndërkurrikulare, pastaj për të kuptuarit e filozofisë së kurrikulës së bazuar në kompetenca dhe transformimin e mësimit të ardhshëm.

Sa i përket sigurimit të cilësisë së programeve për përgatitjen e mësimit të ardhshëm para shërbimit, edukatorët e mësimit të ardhshëm ideojnë mundësi dhe shtojnë kërkesa të argumentuara për ndërveprim të gjitha palëve të interesit që lidhen me sistemin e përgatitjes së mësimit të ardhshëm (nga politikëbërësit deri të kandidatët për mësimit të ardhshëm). Në këtë drejtim, nga edukatorët e mësimit të ardhshëm, ndër të tjera, kërkohet ndryshim i qasjes ndaj mësimit të ardhshëm me studentë - mësimit të ardhshëm të ardhshëm, ndaj vlerësimit të programeve për mësimit të ardhshëm, duke u bazuar në përdorim të standardeve dhe kompetencave të profesionit të mësimit të ardhshëm dhe të standardeve cilësore për akreditim të programeve.

Sipas OECD (2019), siguri i një sistemi të përgatitjes së mësimit të ardhshëm gjithëpërfshirës, koherentë, përkatës dhe të përditësuar vazhdimisht, kërkon angazhime institucionale dhe reflektime kolektive, kërkon një vizion të përbashkët, qeverisje strategjike rreth PFM dhe ngritje të kapaciteteve në të gjitha nivelet (OECD, 2019).

Së treti, ne diskutojmë rëndësinë e informatave kthyesë të mësimit në fillestarë përmes këtij studimi. Studimi ynë tregon se diskutimi me mësimit në fillestarë siguron mjaft evidencë për aspektet që lidhen me cilësinë e përgatitjes së mësimit në fillestarë, për sfidat dhe nevojat e tyre.

Gjetjet nga studimi tregojnë se sfidat dhe nevojat e mësimit në fillestarë dallojnë nga praktikat e shkollave ku drejtorët e shkollave dhe mësimit me përvojë ofrojnë mentorim dhe këshillim, edhe pse shpesh joformal, si dhe nga mundësia e përfshirjes në trajnime të mësimit në fillestarë.

Mësimit në fillestarë vështirësitë kryesore në përvojën e tyre fillestare i lidhin me mungesën e përvojës dhe të kompetencës së tyre për planifikimin mësimor në ndërlidhje me kërkesat e kurrikulës, vlerësimin e nxënësve, menaxhimin e numrit të madh të nxënësve, zhvillimin dhe përdorimin e materialeve dhe burimeve mësimore digjitale.

Orientimet për përmirësim të programeve për përgatitjen e mësimit në fillestarë para shërbimit, që referohen nga mësimit në fillestarë, lidhen me vendosjen e fokusit në psikologjinë zhvillimore për punë me nxënës, praktikat e mësimit - përfshirë qasjet metodologjike, menaxhimin e nxënësve dhe klasës, shkathtësitë në përdorimin e materialeve dhe burimeve mësimore etj., planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës së bazuar me kompetenca, si dhe vlerësimin e nxënësve – përfshirë vlerësimin formues dhe vlerësimin përmbledhës.

Të gjitha diskutimet me mësimit në fillestarë dhe gjetjet e tjera në këtë studim shtrojnë nevojën për futjen në sistem dhe funksionalizimin e fazës së hyrjes në profesion në kontekstin e arsimit në Kosovë. Hyrja në profesion është një reformë arsimore, koha e secilës ka ardhur (Ingeroll, 2012). Mosreagimi institucional vetëm sa do të vazhdojë të lejojë një shpërndarje në zhvillimin e mësimit në karrierë. Nevojiten veprime konkrete dhe të planifikuara mirë, për t'u mundësuar mësimit në fillestarë mentorim, këshillim, trajnime shtesë dhe forma të tjera të përkrahjes për përshtatje me praktikën e mësimit dhe me kulturën e punës në shkollë (Mehmeti, Rraci & Bajrami, 2019).

Në përfundim, gjetjet kryesore nga studimi tregojnë se përgatitja mësimdhënësve para shërbimit është një proces dinamik, me një infrastrukturë komplekse të proceseve, programeve dhe elementeve të tyre.

Studimi arrin në përfundim se programet Bachelor dhe Master për mësimdhënës kanë një mbulesë bazike të pritshmërive të kompetencave për mësimdhënës dhe të kërkesave të kurrikulës së bazuar në kompetenca, me dallime në qasje metodologjike dhe me dominim të fokusit në përmbajtje lëndore në kurse të ndryshme. Nga mënyra se si janë integruar kompetencat për mësimdhënës, kërkesat e kurrikulës së arsimit parauniversitar në përmbajtjet e programeve për mësimdhënës të ardhshëm, nuk reflektohet përfarim i duhur i programeve me kërkesat e sistemit, kontekstin e shkollës dhe nevojat e mësimdhënësve fillestarë.

Shumë aspekte të identifikuara nga analiza e programeve të studimit janë theksuar edhe nga edukatorët e mësimdhënësve dhe mësimdhënësit fillestarë, si sfida dhe mundësi për përmirësimin dhe avancimin e sistemit dhe të programeve për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit. Disa nga sfidat e identifikuara lidhen me qasjen ndaj zhvillimit të programeve të studimit, transformimin e mësimdhënies për të përgatitur mësimdhënës të ardhshëm me kompetenca të duhura për mësimdhënie, me kompetencat të kulturës demokratike, me kompetenca digjitale etj. Pastaj me kapacitetet e personelit akademik/mësimdhënës dhe cilësinë e mësimdhënës, kapacitetet organizative dhe të menaxhimit të procesit mësimor dhe të mbikëqyrjes së praktikave pedagogjike.

Në anën tjetër, mundësitë për përmirësim dhe avancim të programeve për përgatitjen e mësimdhënësve të ardhshëm, të reflektuara dhe të sugjeruara nga edukatorët e mësimdhënësve dhe mësimdhënësit fillestarë, janë thirrje për maksimizim të veprimeve institucionale për të adresuar disa nga gjetjet e raportuara në këtë studim dhe për tejkaluar disa nga sfidat që pengojnë përgatitjen cilësore të mësimdhënësve të ardhshëm.

Rekomandime

Bazuar në rezultatet e studimit, dalin dy–tri rekomandime që lidhen me politikat arsimore dhe programet e studimit për përgatitjen e mësimitdhënësve të ardhshëm.

- **Rekomandime për politikat arsimore:** (i) Politikat që rregullojnë sistemin e përgatitjes së mësimitdhënësve duhet të rishikohen, për të siguruar cilësi të përgatitjes së mësimitdhënësve dhe koherencë me sistemet ndërkombëtare të avancuara për përgatitjen e mësimitdhënësve; (ii) Akreditimi dhe riakreditimi i programeve për përgatitjen e mësimitdhënësve të ardhshëm duhet të vendosë kritere për referim të programeve në fushat dhe standardet e mësimitdhënies; (iii) Duhet të zhvillohet dhe zbatohet një sistem efektiv i komunikimit të politikave për mësimitdhënës të ardhshëm, i cili, ndër të tjera, duhet të përfshijë standardet për mësimitdhënës, ndryshimet në kurrikula dhe kërkesat e nevojat për mësimitdhënës të ardhshëm.
- **Rekomandime për programet e studimit për përgatitjen e mësimitdhënësve të ardhshëm:** (i) Programet duhet të jenë në koherencë me standardet dhe kompetencat për mësimitdhënës, kërkesat dinamike të kurrikulës së arsimit parauniversitar në Kosovë; (ii) Nevojitet rikonceptim i qasjes ndaj ndërlidhjes së programeve me syllabuset e lëndëve/kurseve dhe elementet përmbajtjesore të tyre, për të siguruar arritjen e qëllimeve dhe rezultateve të të nxëniet të programeve; (iii) Programet duhet të sigurojnë më shumë zhvillim të shkathtësive hulumtuese, analitike dhe të zgjidhjes së problemeve të studentët, në përdorimin e teknologjive dhe metodologjive moderne, në zhvillim të aftësive të transferueshme (Fakulteti i Edukimit, 2022).

Gjetjet kryesore nga studimi hapin perspektivën për studime të mëtejshme, për eksplorim më të plotë të problematikës së studiuar, pasi ky studim ishte i limituar në mbulimin e të gjitha aspekteve që lidhen me sistemin e përgatitjes së mësimitdhënësve të ardhshëm në Kosovë. Si referencë kryesore

për një studim më të thelluar të të gjithë komponentëve të sistemit të përgatitjes së mësimdhënësve të ardhshëm, sugjerojmë modelin e përshtatur Burns dhe Köster (2016), për thellim dhe njohje të plotë të të gjithë aktorëve dhe institucioneve që lidhen me sistemin dhe programet për mësimdhënës të ardhshëm, të rëndësishme kulturore e historike të tërë sistemit kosovar për përgatitjen e mësimdhënësve të ardhshëm, krahasuar edhe me trendët dhe zhvillimet e reja të promovuara nga OECD-ja (OECD, 2019).

REFERENCAT

- Agjencia e Kosovës për Akreditim (2022). Manuali i akreditimit. <https://akreditimi.rks-gov.net/ep-content/uploads/2020/10/AKA-Manuali-i-Akreditimit-i-plotesuar-2022-1.pdf>
- Alashwal, M. (2019). Essential Professional Qualities and Skills of an Effective and Modern Teacher. *American Journal of Educational Research*, 7(12), 983-988. <http://pubs.sciepub.com/education/7/12/13/index.html>
- Barber, M., & Mourshed, M. (2007). How the world's best performing systems come out on top. file:///C:/Users/Botek/Downloads/Hoë_the_world_s_best-performing_school_systems_come_out_on_top.pdf
- Bicaj, A. & Berisha, F. (2013). Teacher preparation reforms in Kosovo. *Journal of Education Culture and Society* No. 1_2013. DOI: 10.15503/jecs20131-199-208. [file:///C:/Users/Admin/Doënloads/akobylarek,+JECs+1\(2013\)+199-208.pdf](file:///C:/Users/Admin/Doënloads/akobylarek,+JECs+1(2013)+199-208.pdf)
- Caena, F., (2014). Initial teacher education in Europe: an overview of policy issues. EUROPEAN COMMISSION. file:///C:/Users/Botek/Doënloads/initial-teacher-education_en.pdf
- Demi, A., Rraci E. & Bajrami K. (2018). Pensionimi i parakohshëm për shkaqe shëndetësore - Rasti i mësimdhënësve. <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/11/31-Pensionimi-i-Parakohshem-i-Mesimdhenesve-Report-ALB-05.pdf>
- European Commission (2012). Supporting the Teaching Professions for Better Learning Outcomes. <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=SĚD:2012:0374:FIN:EN:PDF>

- European Commission (2013). Supporting teacher competence development for better learning outcomes.
[file:///C:/Users/Botek/Downloads/Supporting teacher competence development.pdf](file:///C:/Users/Botek/Downloads/Supporting%20teacher%20competence%20development.pdf)
- European Commission/EACEA/Eurydice (2018, January). *Teaching Careers in Europe: Access, Progression and Support*. Eurydice Report. Luxembourg: Publications Office of the European Union. Education, Audiovisual and Culture Executive Agency. <http://eurydice.indire.it/ep-content/uploads/2018/02/Teaching-Careers-in-Europe.pdf>
- European Commission/EACEA/Eurydice, (2015). The Teaching Profession in Europe: Practices, Perceptions, and Policies. Eurydice Report. Luxembourg: Publications Office of the European Union. <https://www.anefore.lu/wp-content/uploads/2015/09/EURYDICE-THE-TEACHING-PROFESSION.pdf>
- European Commission/EACEA/Eurydice, 2021. Teachers in Europe: Careers, Development and Well-being. Eurydice report. Luxembourg: Publications Office of the European Union.
https://eurydice.eacea.ec.europa.eu/sites/default/files/2022-06/teachers_in_europe_2020_chapter_2_0_0.pdf
- Wiliam, D. (2015), Embedding Formative Assessment: Practical Techniques for K-12 Classrooms. https://www.learningsciences.com/wp-content/uploads/2020/06/efa_lookinside_2.pdf
- Fakulteti i Edukimit. (2021). Politika për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë në përgatitjen e mësimdhënësve në Kosovë. Fakulteti i Edukimit – Universiteti I Prishtinës: QATEK. <https://edukimi.uni-pr.edu/desk/inc/media/84FF287A-D6AB-4ACC-85CF-11F278D41156.pdf>
- Goddard, J. T. dhe Buleshkaj, O. (2018). Drejt një modeli të ri të integruar dhe të bazuar në Shkollë të Zhvillimit Profesional dhe të Karrierës së Mësimdhënësve në Kosovë. Koncept dokument i pabotuar dhe i përgatitur për Projektin e Përmirësimit të Sistemit të Arsimit (ESIP). Prishtinë, Kosovë: MASHT.
- Ingersoll, R. M. (2012). *Beginning teacher induction: What the data tell us*. Kappan Magazine, 93(8), 47-51.
https://repository.upenn.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1239&context=gse_pubs
- Instituti i Zhvillimit të Arsimit (2016), Formimi Fillestar i Mësuesve në Institucionet e Arsimit të Lartë Shqiptar. Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZhA), Tiranë,

<https://ascap.edu.al/ep-content/uploads/2017/03/Raporti.pdf> (shkarkuar me 16 Shkurt 2021).

- IZHA dhe UNICEF (2018). Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor. Tiranë, Shqipëri.
<https://www.unicef.org/albania/media/2016/file/STANDARDS%20OF%20THE%20PROFESSIONAL%20DEVELOPMENT%20FOR%20THE%20PRE%20SCHOOL%20TEACHERS.pdf>
- Kaçaniku, F., (2023). Quality initial teacher education in the grip of teacher educator ‘academic tribes and territories’, Education Inquiry. <http://orcid.org/0000-0002-9521-2975>
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008). Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-068 (2008). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 21 maj 2008, Prishtinë.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011). Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës. Ligji Nr. 04/L-032 (2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 17/16 shtator 2011, Prishtinë.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2012). Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2016). Ligji për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës. Ligji nr. 05/1-066 (2016). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 38 / 21 nëntor 2016, Prishtinë. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ligj-per-profesionet-e-rregulluara-ne-republiken-e-kosoves-gznr38-21-nentor-2016.pdf>
- Manninen, J. (2014). Evaluation report: Qualitative stakeholder evaluation of the first year of implementation of new Kosovo curriculum. Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE-ja dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë.
- Matthews, B./ Ross, L (2010): METODAT E HULUMTIMIT. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Qendra për Arsim Demokratik (CDE). Tiranë.
- Mehmeti, S. (autor), Rraci, E. & Bajrami, K. (2019). Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve në Kosovë. Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN. http://ëë.keen-ks.net/site/assets/files/1467/zhvillimi_profesional_i_mesimdhenesve_ne_kosove_alb-1.pdf

Kërkime Pedagogjike

- Mehmeti, S., (2018). Përvojat e mësimdhënësve fillestarë në Kosovë. Kërkime Pedagogjike - përmbledhje punimesh, 2018, (f. 6-39). Prishtinë, Kosovë: Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar). Prishtinë.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2017). Korniza strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë. MASHT. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/04/kornize-strategjike.pdf>
- Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit (2023). Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2023 Për sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie. MASHTI. <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-14-2023-per-sistemin-e-licencimit-dhe-karrieren-ne-mesimdhenie/>
- Musset, P. (2010), "Initial Teacher Education and Continuing Training Policies in a Comparative Perspective: Current Practices in OECD Countries and a Literature Review on Potential Effects", OECD Education Working Papers, No. 48, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/5kmbpnh7s47h-en>.
- Nikoçeviq Kurti, E. & Saqipi, B. (2022). Toward developing a qualitative mentoring program for pre-service teachers: Kosovo's experience. Issues in Educational Research, 32(2), 634-658. <http://www.iier.org.au/iier32/nikoceviq-kurti.pdf>
- OECD (2019), A Flying Start: Improving Initial Teacher Preparation Systems, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/cf74e549-en>.
- OECD (2019), TALIS 2018 Results (Volume I): Teachers and School Leaders as Lifelong Learners, TALIS, OECD Publishing, Paris. <https://doi.org/10.1787/1d0bc92a-en>
- OECD (2022), "Content of initial teacher education (2021): For loëer secondary teachers (general subjects) in public institutions", in Education at a Glance 2022: OECD Indicators, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/5b34c551-en>.
- Rapti, D. (2009). *Përpykjet për një politikë të unifikuar evropiane në sferën e edukimit të mësuesve*. Botimi i Institutit të Kurrikulës dhe Trajnimit: Mësuesit dhe cilësia e arsimit – sfida globale e shekullit XXI, (f. 46 -53). Tiranë, Shqipëri.
- Rexhaj, Xh., Mula, M., Hima, A. (2009). Hartimi i politikave dhe praktikave për përgatitjen e mësuesve për arsimim përfshirës në kontekst të diversitetit social dhe kulturor. Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF).

- Saqipi, B. **, Asunta, T., Korpinen, E. (2014). Understanding the context of teacher professionalism in education systems undergoing transition – Kosovo case. International Conference on Education & Educational Psychology 2013. Procedia - Social and Behavioral Sciences 112 (2014) 635 – 646. F.637.
- Schleicher, A. (2012), Ed., Preparing Teachers and Developing School Leaders for the 21st Century: Lessons from around the World, OECD Publishing.
<http://dx.doi.org/10.1787/9789264xxxxxx-en>
- Vula, E., Berisha, F. and Saqipi B., (2015). Introducing Teacher Mentoring in Kosovo Schools – Potential and Challenges for Sustainability. C E P S Journal | Vol.5 | No 4 | Year 2015.
<https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1129003.pdf>
- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit (2021a). Programi i studimit: Programi Fillor. Akredituar për periudhën 1 tetor 2021 - 30 shtator 2024. Prishtinë, Kosovë: Fakulteti i Edukimit. <https://edukimi.uni-pr.edu/desk/inc/media/2966E68F-D781-43A7-8677-5BE5AA4C76BD.pdf>
- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit (2021b). MA Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializim). Akredituar për periudhën: 1 Tetor 2021 - 30 Shtator 2024. Prishtinë, Kosovë: Fakulteti i Edukimit.
<https://edukimi.uni-pr.edu/desk/inc/media/8D883A09-5DF5-4387-801A-30B5AAB21854.pdf>
- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit (2022). Plani zhvillimor i Fakultetit të Edukimit 2022-2026. Prishtinë, Kosovë: Fakulteti i Edukimit. <https://edukimi.uni-pr.edu/desk/inc/media/355E556F-0EE6-4F57-967F-A62D4247F55A.pdf>
- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”. (2017). *Manual trajnimi për mësimdhënësit Mentorë (Programet Bachelor)*. Prishtinë, Kosovë: Fakulteti i Edukimit (me ndihmën e projektit TEMPUS, të financuar nga BE-ja).
- Vogrinc, J. & Saqipi, B. (2020). Hulumtimi në shkencat e edukimit - këndvështrime konceptuale dhe metodologjike. Tiranë, Shqipëri: Albas.
- Zgaga, P., (2013). The Future of European Teacher Education in the Heavy Seas of Higher Education.
https://www.researchgate.net/publication/253955019_The_future_of_European_teacher_education_in_the_heavy_seas_of_higher_education/link/00b4952c526611979d000000/download

ANALIZË E TEKSTEVE SHKOLLORE TË LETËRSISË NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË KOSOVË

Safete Statovci-Shala
Instituti pedagogjik i Kosovës
Safete.shala@rks-gov.net

Abstrakt

Qëllimi i këtij hulumtimit është të bëhet një analizë e teksteve aktuale shkollore të letërsisë, prej klasës së dhjetë deri në klasën e dymbëdhjetë, në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë.

Metodat që janë përdorur në këtë hulumtim janë: metoda përshkruese, metoda komperative, e analizës së dokumentacionit, përmes së cilave është bërë mbledhja e të dhënave dhe analiza e ligjeve, udhëzimeve strategjive, rregulloreve, raporteve të hulumtimit dhe botimeve të tjera rreth kësaj teme.

Instrumentet e përdorura për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore janë pyetësori për nxënës dhe intervistat gjysmë të struktura me mësimdhënës të shkollave të arsimit të mesëm të lartë, të 7 regjioneve të Kosovës. Hulumtimi është realizuar në 7 gjimnaze, me 216 nxënës dhe 20 mësimdhënës.

Sipas rezultateve të hulumtimit, pjesa më e madhe e nxënësve deklarojnë se në tekstet shkollore të letërsisë njësitë mësimore janë të gjata dhe hartuesit e teksteve shkollore nuk i përfillin standardet për tekstet shkollore dhe kanë informata që nuk na nevojiten.

Rezultatet e këtij studimi pritet të ndikojnë në rishikimin dhe ndryshimin e teksteve shkollore, zvogëlimin e të metave që kanë tekstet shkollore dhe përfshirjen më të madhe të periudhave letrare dhe disa shkrimtarëve shqiptarë të periudhave të ndryshme, të përfshihen në tekstet shkollore të letërsisë.

Rekomandimet për përmirësimin e teksteve shkollore të letërsisë janë që njësitë mësimore të jenë të thjeshta dhe të kuptueshme, duke i bërë ato sa më funksionale për nxënësit dhe mësimdhënësit. Nxënësit shprehin mendimin që tekstet e tilla të mos jenë të gjata, por të ofrojnë një përmbajtje që është e lehtë për t'u kuptuar.

Fjalët çelës: analiza e teksteve shkollore, letërsia, nxënësit, mësimdhënësit.

Analysis of literature textbooks in upper secondary education in Kosovo

Safete Statovci-Shala

Abstract

The aim of this research is to conduct an analysis of current literary school texts, from the tenth to the twelfth grade, in higher secondary education in Kosovo.

The methods used in this research include descriptive methods, comparative methods, and document analysis, through these methods, data collection and analysis of laws, strategic guidelines, regulations, research reports, and other publications on this subject were conducted.

The instruments used for collecting quantitative and qualitative data include questionnaires for students and semi-structured interviews with high school teachers in the 7 regions of Kosovo. The research was carried out in 7 high schools, involving 216 students and 20 teachers.

According to the research results, the majority of students state that literary school texts have lengthy instructional units, and the authors of school texts do not adhere to the standards for educational texts. Additionally, these texts contain information that is deemed unnecessary.

The results of this study are expected to influence the revision and modification of school texts, reducing the shortcomings of school texts, and incorporating a broader range of literary periods and Albanian writers from various eras into literary school texts.

Recommendations for improving literary school texts include simplifying instructional units to make them more comprehensible and functional for both students and teachers.

Students express the opinion that such texts should not be lengthy but should offer content that is easy to understand.

Key words: analysis of school texts, literature, students, teachers.

Hyrje

Ky hulumtim është një kontribut, sado modest, në zbardhjen e këtyre aspekteve në një dritë të re dhe sipas metodologjive bashkëkohore hulumtuese, analizuese dhe trajtuese për teorinë pedagogjike, metodike dhe letrare, në frymën e kompetencës shkencore adekuate.

Kjo temë ka një rëndësi të veçantë, sepse vlerat e letërsisë për nxënësit ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në formimin e tyre njerëzor e intelektual, por veçanërisht në përvetësimin e kulturës së leximit dhe të asaj të shkrimit, si parakushte për arritje në formimin profesional dhe të përgjithshëm të nxënësve në rrugën e tyre jetësore.

Tekstet shkollore të letërsisë kanë një rol shumë të rëndësishëm të përdorimit, edukimit të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të ardhmen.

Pavarësisht vlerësimeve të shumta, ka një mungesë të dukshme hulumtimi të thelluar dhe të përmbajtjeve të plota, i fokusuar në përmbajtjen letrare të përfaqësuar në këto tekste. Ky hulumtim synon të adresojë këtë boshllëk, duke u fokusuar në veçanti në vlerat artistike të pjesëve letrare brenda materialeve arsimore të klasave dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë. Synimi i këtij hulumtimi është të japë një kontribut, megjithëse modest, në hedhjen e dritës mbi këto aspekte nëpërmjet një perspektive të re, duke përdorur metodologji bashkëkohore hulumtuese për teorinë pedagogjike, metodikën dhe teorinë letrare, brenda kornizës së njohurive shkencore adekuate për këto tekste shkollore.

Rëndësia e këtij hulumtimi qëndron në ndikimin drejtpërdrejt të vlerave letrare mbi nxënësit, duke ndikuar jo vetëm në zhvillimin e tyre intelektual, por edhe në formimin e karakterit njerëzor. Kultivimi i kulturës së leximit dhe shkrimit, theksuar nga studimi i letërsisë, prezantohet si një parakusht thelbësor për zhvillimin profesional dhe personal të përgjithshëm.

Me gjithë vlerësimet e shumta që janë bërë, qoftë nga nivelet kompetente institucionale, qoftë nga autorë të ndryshëm, rreth përmbajtjeve të teksteve aktuale shkollore në Kosovë, nuk ka pasur ndonjë hulumtim të thelluar dhe me qasje gjithëpërfshirëse për këtë problematikë, në tërësinë e tij, fokusuar

në vlerat artistike të pjesëve letrare të përfaqësuara në tekstet shkollore të nivelit shkollor.

Nga ana tjetër, nuk mund të paramendohet kurrfarë niveli solid i komunikimit pa kulturën e leximit, e në këtë kontekst përmbajtjet e teksteve shkollore të letërsisë kanë një rol të domosdoshëm në përditshmërinë e aktiviteteve të nxënësve, ngase para se të fillojnë të pranojnë përmbajtjen e një vepre letrare në mënyrë tërësore, ata kanë qasje në përmbajtjet fragmentare të tyre, të paraqitura në tekstet përkatëse shkollore. Prandaj, këtë aspekt ndikues jemi munduar ta nxjerrim nga përgjigjet e nxënësve, për të parë se një përmbajtje letrare e caktuar sa ka ndikim në formimin e një kulture të caktuar komunikimi, duke i pasur parasysh nivelet e ndryshme të komunikimit, pra nga ai i ngathtë, te një nivel solid, apo edhe te një nivel komunikimi efektiv, si shkallë e kërkuar dhe e admirueshme.

KONTEKSTI TEORIK

Cilësia e përmbajtjeve e teksteve shkollore të letërsisë edhe mund të diskutohet, duke pasur parasysh faktin se hartimi i një teksti letrar, dhe jo vetëm letrar, është punë e vështirë, e cila kërkon njohje të thella letrare dhe përgjithësisht krijuese, përjashto ato teknike, që nuk janë më pak të rëndësishme për produktin final të librit.

Tekstet shkollore janë tipare të rëndësishme të çdo fushe akademike. Së pari, ato kapin kërkimin aktual në fusha lëndore; së dyti, ato janë baza që nxënësit të njihen me përmbajtjen e tyre; dhe e treta, ato përdoren shpesh nga mësuesit për përgatitjen e planeve të tyre mësimore dhe së bashku me nxënësit të analizojnë temat aktuale në tekstet shkollore. Kështu, tekstet shkollore përpiqen të japin një pasqyrë sistematike dhe të plotë të një disipline. Ka shumë tekste të ndryshme, për çdo fushë dijeje dhe disipline; çdo botues i shquar, ka një tekst shkollor për fushat kryesore të trajtuara, për shembull, ka të paktën tri tekste shkollore për të zgjedhur midis tyre.

Sipas Ligjit për botimin e teksteve shkollore (2007), kemi këtë përkufizim: “Teksti shkollor është libër themelor dhe i obligueshëm, që shërben si mjet

dhe burim i dijes për fushën e caktuar, me përdorimin e të cilit arrihen objektiva edukativo-arsimore (MASHT, 2007, f. 22”).

Zhvillimi i teksteve shkollore është i domosdoshëm për të shfrytëzuar potencialin e ofruar nga teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit. Kjo nevojë theksohet nga Devetaku-Gojani (2009), e cila thekson rëndësinë e teksteve shkollore me standarde të larta cilësore në realizimin e tyre. Në mënyrë të veçantë, ky tekst nxit mendimin kritik mes materialeve mësimore dhe mundësive që prezanton teknologjia moderne, një temë e rëndësishme në tërë literaturën shkencore. ”Gjithashtu, tekstet shkollore duhet të zhvillohen në lidhje me mundësitë e ofruara nga teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit dhe duhet të pasqyrojnë standarde të një cilësie të lartë sa i përket realizimit të tyre” (Devetaku-Gojani, 2009, f. 110).

Në rrugën drejt një arsimit të avancuar dhe ndryshimit shoqëror, tekstet mësimore zbulojnë rolin e tyre kryesor. Siç shprehet Koliqi (2014), ato shërbejnë si burime të pasura të informacionit për nxënësin dhe mësimdhënësin. Përforcuar nga aftësia e tyre për të nxitur mendimin kritik, pavarësinë dhe kreativitetin e nxënësit, këto tekste ofrojnë më shumë se një rrugë drejt një arsimit të pasur dhe të ndryshuar. Lehtësisht të përdorshme si mjete të domosdoshme për zhvillimin e një mjedisi arsimor.

“Tekstet mësimore janë burime të përshtatshme informacioni për nxënësin (dhe mësuesin), nxisin të menduarit kritik, pavarësinë dhe kreativitetin e nxënësit. Janë lehtësisht të përdorshme dhe me çmim të lirë (ose falas). Ato janë mjete shumë të rëndësishme të arsimit dhe ndryshimit social të nxënësit” (Koliqi, 2014, f. 57).

„Hartimi i tekstit shkollor nuk është rithënie mekanike e programit mësimor, por tregon konkretizimin e tij personal, të orientuar drejt garancisë së një procesi mësimor efektiv” (Mari & Rozhje, 2002, f. 45)

Në krijimin letrar brenda kontekstit arsimor, Matoshi (2008) thekson një sfidë të vështirë hartimin e teksteve letrare pa u nënshtruar kritereve ideore, artistike dhe pedagogjike, bashkë me zgjedhjen veprave letrare dhe materialeve shkollore për lexim. Sidoqoftë, mungesa e një gjuhe

argumentuese shkencore në interpretimin e këtyre teksteve, duke u mbështetur në kritere që nuk kalon kufijtë e perceptimit individual, mbetet një nga sfidat e pamundura për t'u tejkaluar në formimin letrar. “Hartimi i teksteve të letërsisë, pa i përfillur kriteret ideore, artistike e pedagogjike nga njëra anë; njëkohësisht përzgjedhja arbitrare e teksteve letrare dhe e librave të lekturës shkollore, duke shtuar këtu edhe interpretimin pa një gjuhë argumentuese shkencore, një interpretim që mbështetet në kritere që s'i kalon kufijtë e perceptimit individual, mbetet njëra ndër sfidat me të pakapërcyeshme të formimit letrar ndër ne” (Matoshi, 2008, f. 111).

Në mësimin e letërsisë brenda fushës së arsimit, Showalter (2003) prezanton një perspektivë mbresëlënëse. Sipas saj, qëllimi kryesor i mësimin të letërsisë, siç paraqitet në një tekst shkollor, nuk është thjesht të transmetojë informacion, por të angazhojë aktivisht nxënësit në artin e leximit, analizës dhe interpretimit. Në mësimin e letërsisë, Showalter (Placeholder12) argumenton se „Qëllimi kryesor i mësimin të letërsisë në një libër letërsie është të mësojë aktivisht nxënësi se si të lexojnë, të analizojnë dhe të interpretojnë një tekst letrar, duke interpretuar ato që këto tekste mund të përfshijnë mes rreshtave” (Showalter, 2003, f. 22).

Politikat do të sjellin rekomandime konkrete dhe „Zbatimi i teksteve të avancuara duhet t'u qaset institucioneve përkatëse arsimore kompetente. Natyrisht, qasja e interpretimit të temës do të jetë e ndryshme, por do të bazohet në metodologji moderne, e cila do të linte mënjanë ngarkesat e mëdha ideologjike, që kanë bazën e ndjeshmërisë ndaj interesit kombëtar dhe reciprok për të ecur përpara proceseve integruese globale për tekstet shkollore në Kosovë e Shqipëri” (Shala, 2016, f. 319).

“Kur punoni me libra të veçantë, kjo mund të sjellë një vështrim më të kujdesshëm në sfondin e autorëve dhe se si mund të ketë ndikuar në punën e tyre, faktorët politikë ose fetarë që rrethojnë shkrimin e librit, epoka letrare mbi të cilën është shkruar libri ose nga e cila është ndikuar, dhe faktorët kulturorë që i dhanë formë librit” (Granath, 2017, f. 7)”.

Në këtë kontekst përfshihen njohuritë më të thelluara rreth temave, autorëve, fenomeneve, dukurive dhe ngjarjeve letrare dhe kulturore të ndryshme. Kjo

qasje u mundëson nxënësve të thellojnë kuptimin e tyre për tekstet, duke dalluar veçoritë e strukturës gjuhësore, letrare dhe stilistike.

Bazuar në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës (Gjimnazet - klasa X, XI, XII), tekstet letrare dhe joletrare përdoren me nxënës për zgjerimin e dijeve dhe të aftësive argumentuese, interpretuese e kreative (MAShT, 2016).

Sipas Rexhepit (2002), hartuesit e teksteve kanë investuar në idenë se personaliteti i shkrimtarit është një aspekt shumë më fascinant se vetë vepra e tij. Kjo bindje vjen nga perceptimi se shkrimtari posedon një aftësi kreative artistike, një dhunti e rrallë e natyrës që jo të gjithë individët e kanë, duke e bërë këtë personalitet të jetë një objekt studimi dhe vlerësimi i veçantë në shkencat e letërsisë.

“Hartuesit e teksteve kanë menduar se personaliteti i shkrimtarit është shumë më interesant se vepra e tij, sepse ai posedon aftësi kreative artistike, cilësi që nuk i kanë të gjithë njerëzit, do me thënë një dhunti të natyrës që u bie hise vetëm disa njerëzve (Rexhepi, 2002, f. 59).

Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të bëhet një analizë e teksteve aktuale shkollore të letërsisë, prej klasës së dhjetë deri në klasën e dymbëdhjetë, në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë.

Pyetjet e hulumtimit

- 1) Si i vlerësojnë mësimdhënësit tekstet aktuale shkollore të letërsisë, a është i përshtatshëm zbatimi i tyre?
- 2) A mendojnë mësimdhënësit se teksti i letërsisë ndikon në formimin kulturor të nxënësit?
- 3) Cili është mendimi i nxënësve, se teksti shkollor aktual ka një funksion të përshtatshëm në zhvillimin e tyre mësimor?

METODOLOGJIA

Modeli i hulumtimit

Hulumtimi ka qasje cilësore dhe sasiore. Për të grumbulluar të dhëna sasiore, kemi përdorur 216 pyetësorë për nxënës, ndërsa për marrë të dhëna cilësore kemi përdorur intervistat gjysmë të strukturuar, me 20 mësimdhënës.

Popullata dhe mostra

Popullata e këtij hulumtimi janë nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta të 7 rajoneve të Kosovës. Nga përpunimi i të dhënave nga pyetësorët me nxënës, rezulton se 74.4% prej tyre i takojnë gjinisë femërore, kurse 29.6% të gjinisë mashkullore.

Përzgjedhjen e mostrës së hulumtimit e kemi bërë në mënyrë rastësore dhe responentë janë: 216 nxënës dhe 20 mësimdhënës të klasës së dhjetë (X), njëmbëdhjetë (XI) dhe dymbëdhjetë (XII), në arsimin e mesëm të lartë, të komunave: Prishtinë (Gjimnazi “Xhevdet Doda”), Pejë (Gjimnazi “Bedri Pejani”), Suharekë (Gjimnazi “Jeta e Re”), Lipjan (Gjimnazi “Ulpiana”), Podujevë (Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani”), Viti (Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës”), Vushtrri (Gjimnazi “Eqrem Çabej”), të shtatë rajoneve të komunave të Kosovës. Për realizimin e hulumtimit kemi përdorur pyetësorin për nxënës dhe intervistën me mësimdhënës të ShMU.

Metodat e hulumtimit

Për të realizuar këtë hulumtim, kemi përdorur këto metoda: metodën e analizës teorike, metodën e analizës së dokumentacionit, metodën përshkruese, metodën krahasuese, metodën statistikore, metodën e analizës së dokumentacionit - përmes së cilave kemi bërë analizën e ligjeve, udhëzimeve strategjive, rregulloreve, raporteve të hulumtimit dhe botimeve të tjera rreth kësaj teme.

Instrumentet e hulumtimit

Në hulumtim si instrument kryesor kemi përdorur pyetësozin për nxënës dhe intervistën gjysmë të strukturuar për mësime dhënë.

Pyetësozi është përdorur për mbledhjen e të dhënave sasiore, ndërsa intervista gjysmë e strukturuar mundësoi mbledhjen e të dhënave cilësore.

Instrumentet e përcaktuara për këtë hulumtim janë pyetësozët për nxënës dhe intervistat për mësime dhënë.

Disa nga pyetjet orientuese janë:

Sa është funksional dhe i përshtatshëm teksti i letërsisë për nxënësit?

Tekstet shkollorë të letërsisë a janë të ngarkuara me fjalë që nxënësit nuk i kuptojnë?

Në tekstet shkollorë të letërsisë a i kuptojnë nxënësit detyrat, pyetjet, përshkrimet, shembujt, fjalët e panjohura, pa dhënë shpjegime mësime dhënë?

Ndërsa intervista e strukturuar përbëhet prej 6 pyetjeve, të cilat janë:

Cili është vështirësi juaj për tekstet e reja aktuale shkollorë të letërsisë, a është i përshtatshëm zbatimi i tyre?

Sa u jepet hapësirë nga mësime dhënë diskutimit dhe debateve me nxënësit, lidhur me përmbajtjet dhe situatat letrare në tekstet shkollorë?

Cila është rëndësia e teksteve shkollorë të letërsisë dhe a keni vërejtur gabime në përmbajtje në drejtshkrim?

Në tekstet shkollorë të letërsisë, nxënësit a i kuptojnë detyrat, pyetjet, përshkrimet, shembujt, fjalët e panjohura, pa dhënë shpjegime mësime dhënë?

Procedura e mbledhjes së të dhënave

Për realizimin e pyetësozit janë mbledhur të dhënat gjatë hulumtimit, të cilat janë shqyrtuar dhe analizuar, pastaj janë njoftuar drejtorët e shkollave, përmes e-mail-it, lidhur me realizimin e intervistave me mësime dhënë të

Gjuhës dhe letërsisë shqipe, të klasave X, XI, XII. Gjithashtu, hulumtimi është realizuar në terren, me mbledhjen e të dhënave gjatë intervistës me mësimitdhënës dhe me nxënës, përmes Google forms dhe e-mail-it.

Procedura e analizës së të dhënave

Të dhënat cilësore, të mbledhura nga pyetjet e hapura dhe nga intervistat me mësimitdhënës, i kemi analizuar duke interpretuar dhe grupuar përgjigjet për çdo pyetje, të cilat pastaj janë interpretuar në mënyrë përshkruese.

Derisa të dhënat e dala nga intervistat me mësimitdhënësit e Gjuhës dhe letërsisë shpeshherë kanë qenë më konkrete, sidomos në rrafshin e kritikës së caktuar për autorë konkretë dhe njësi të caktuara mësimore, pra edhe për përmbajtjet, të cilët në përgjigjet e tyre kanë qenë shumë më të përmbajtur. Shpesh përgjigjet e tyre ishin përgjithësuese, mungonte qasja kritike dhe kompetente, por, megjithatë, kur kërkohet ndonjë e dhënë konkrete, gjykimet e tyre ishin interesante dhe me peshë përgjithësisht për temën.

REZULTATET E HULUMIMIT

Tekstet aktuale të letërsisë, të cilat janë në përdorim për të gjitha klasat e gjimnazit, kanë një nivel të pranueshëm profesional, shkencor e teknik, dhe kanë një traditë përdorimi, ngase hartuesit e tyre në masën më të madhe i kanë pasur parasysh dhe i kanë respektuar kërkesat e Kurrikulës.

Pra, duke u bazuar në realizimin e këtij hulumtimi në terren, si dhe përfundimin e analizës së të dhënave të dala nga hulumtimi, kemi hartuar raportin me rezultatet e hulumtimit në shkollat mesme të larta në Kosovë.

Rezultatet e këtij hulumtimi janë paraqitur në formë të grafikëve dhe me anë intervistave me mësimitdhënës, si dhe është bërë komentimi analitik të tyre. Gjithashtu, në kuadër të tyre, është përfshirë edhe krahasimi midis komunave sa i përket çështjeve të trajtuara dhe rezultateve të shkollave të mesme të larta në Kosovë. Kështu, në realizimin e hulumtimit së pari i kemi

marrë mendimet e nxënësve, duke filluar me shtrimin e pyetjeve të përcaktuara dhe pyetja e parë ka qenë:

1. Sa është funksional dhe i përshtatshëm teksti i letërsisë?

Në pohimin *Sa është funksional dhe i përshtatshëm teksti i letërsisë për nxënësit*, shohim se 18 nxënës janë përgjigjur aspak nuk pajtohen, 24 janë përgjigjur se nuk pajtohen, 68 janë shprehur neutralë, 59 prej tyre pajtohen, dhe 43 të tjerë plotësisht pajtohen.


Nga hulumtimi i kryer me nxënës, kuptohet se tekstet letrare kanë një ndikim thelbësor në zhvillimin kulturor të nxënësve, një fenomen i konfirmuar nga rezultatet e hulumtimit, pasi shumica substanciale e nxënësve nga shkollat e gjimnazit pohon një ndikim të tillë.

Duke u mbajtur ngushtë për qëllimet e hulumtimit, janë bërë përpjekje të koordinuara për të formuluar pyetje që shërbejnë për të nxjerrë përgjigje të përshtatshme dhe të informuara.

Si rrjedhojë, orientimi i nxënësve ndaj formimit kulturor shfaqet si një faktor vendimtar, duke pasuar gjithmonë potencialin e gjerë të përgjigjeve nga ta.

Për korrektësi dhe saktësi informacioni, duhet pranuar se një numër i madh i nxënësve nuk e kanë specifikuar përgjigjen pozitive si “kulturë e përgjithshme komunikimi”, por janë mjaftuar vetëm me përgjigjet si “kulturë e përgjithshme”, të cilat i kemi përfshirë në kategorinë e parë.

Sa është funksional dhe i përshtatshëm teksti i letërsisë për ju nxënësit?



Grafiku 1. Funksionimi dhe përshtatshmëria e tekstit të letërsisë për nxënësit e këtij niveli

1. Sa ndikon teksti i letërsisë në formimin kulturor të nxënësit?

Analiza e përmbajtjes së njëzive letrare në tekstet shkollore të letërsisë dhe ndikimi i tyre në formimin kulturor të nxënësve paraqesin një fushë të rëndësishme të hulumtimit shkencor.


Pyetja e parashtruar është përqendruar se si këto tekstet ndikojnë në zhvillimin e aftësive komunikuese të nxënësve, duke sjellë një ndriçim mbi rolin e tyre në formimin e kulturës së komunikimit.

Në pohimin *Sa ndikon teksti i letërsisë në formimin kulturor të nxënësit* shohim se 15 nxënës janë përgjigjur aspak nuk pajtohen, 28 janë përgjigjur se nuk pajtohem, 62 janë shprehur neutralë, 41 prej tyre pajtohen dhe 66 të tjerë plotësisht pajtohen, por nxënësit i kanë dhënë këto përgjigjeje të pjesshme, duke mos specifikuar ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë të këtyre përmbajtjeve letrare në zhvillimin e aftësisë së tyre komunikuese.

Interpretimi i përgjigjeve kërkon një analizë të thelluar për të kuptuar natyrën e lidhjes midis përmbajtjes së tekstit letrar dhe perceptimit të nxënësve mbi funksionalitetin dhe përshtatshmërinë e tij. Në pjesën tjetër të analizës, ndërhyhet në pohimin se tekstet letrare kanë një ndikim të ndjeshëm në formimin kulturor të nxënësve, një konstatim i cili mbështetet

nga shumica dërmuese e nxënësve nga shkollat e gjimnazit. Kjo gjen vlerë shkencore duke përdorur rezultatet e hulumtimit për të përforcuar argumentin se letërsia ka një rol kyç në ndërtimin e kulturës së komunikimit në kontekstin shkollor. Gjithashtu, vlerësohet rëndësia e qasjes së nxënësve ndaj formimit kulturor, duke përdorur termat "Qasje kritike" dhe "Ndikimi potencial i përgjigjeve". Ky qëndrim paraqet një përpjekje shkencore për të lidhur përgjigjet e nxënësve me qasjen e tyre kritike dhe perceptimin e mundësive të ndryshme të përgjigjeve. Për të shtuar saktësi në interpretimin e përgjigjeve, theksohet se një grup i konsiderueshëm i nxënësve nuk ka specifikuar përgjigjen pozitive si "kulturë e përgjithshme komunikimi", por kanë përdorur vetëm përgjigje si "kulturë e përgjithshme", një detaj i rëndësishëm për të kuptuar variacionin në perceptimet e tyre.

Teksti i letërsisë ndikon në formimin kulturor të nxënësit:



Grafiku 2. Formimi kulturor i nxënësit nëpërmes tekstit të letërsisë

2. A e zgjojnë interesimin tuaj për lexim dhe interpretim tekstet e zgjedhura letrare në libra të letërsisë?

E kam parashtruar këtë pyetje duke shpresuar në përgjigje që ofrojnë një pasqyrë reale për opinionet e tyre rreth kësaj çështjeje. Dhe, vërtet shumica e përgjigjeve kanë qenë korrekte dhe me përmbajtje, të cilat kanë shprehur

bindjet reale të nxënësve, sado që atyre mund t'u bëhet qasje e ndryshme interpretimi.

Kështu, ata kanë deklaruar se përmbajtje të caktuara të njësive letrare reflektojnë në përmasa domethënëse në formimin e një kulture shkrimi dhe leximi të nxënësit. Një pjesë e nxënësve janë shprehur se ndikimi i teksteve shkollore të letërsisë është relativisht përcaktues që të zgjojë interesimin e tyre për lexim dhe interpretim. Është interesant se gjatë bisedave me nxënës për këtë temë dalin edhe vlerësime të tjera, sikur ka luhate në rëndësinë e përmbajtjes së një teksti letrar në formimin e kulturës së shkrimit, leximit dhe interpretimit të nxënësit, duke e lidhur këtë aspekt më shumë me prirjet e tyre sesa me leximin.

Në pohimin nëse *Tekstet e zgjedhura letrare në libra të letërsisë zgjojnë interesimin për lexim dhe për interpretim, janë në funksion të arsimit të mesëm të lartë*, shohim se 17 nxënës aspak nuk pajtohen me këtë pohim, 35 janë përgjigjur se nuk pajtohen, 64 janë shprehur neutralë, 51 prej tyre pajtohen, dhe 44 të tjerë plotësisht pajtohen. Ky aspekt është prezantuar me qëllim që të nxjerrë në pah perceptimet e nxënësve lidhur me ndikimin e teksteve letrare në nivelin e interesimit dhe aftësive të tyre të interpretimit. Përgjigjet kanë shfaqur një gamë të gjerë të shprehjeve, ndërsa shumica e tyre janë vlerësuar si korrekte dhe me përmbajtje pasqyruese të bindjeve reale të nxënësve. Nxënësit janë shprehur se përmbajtjet e caktuara të njësive letrare kanë një ndikim domethënës në formimin e kulturës së shkrimit dhe leximit të tyre.

Këto vlerësime sugjerojnë se lidhja ndërmjet përmbajtjes së një teksti letrar dhe formimit të kulturës së leximit është e ndërlikuar dhe ndikohet nga prirjet individuale të nxënësve më shumë se nga vetë veprimtaria e leximit.


3. A mjafton teksti i letërsisë për të kuptuar dhe interpretuar letërsinë shqipe dhe botërore?

Në pohimin se *A mjafton teksti i letërsisë për të kuptuar dhe interpretuar letërsinë shqipe e botërore* shohim se 15 nxënës janë shprehur se aspak nuk

pajtohen, 27 të tjerë nuk pajtohen, 63 janë neutralë, 57 pajtohen dhe 49 plotësisht pajtohen.

Përmes kësaj pyetjeje, qëllimi ynë ishte të nxjerrim perspektivat e nxënësve lidhur me rëndësinë e teksteve letrare, që në mënyrë të pashmangshme përfshijnë përmbajtjet e njësive letrare shqipe dhe botërore, në zhvillimin e kulturës komunikuese të tyre. Ky hulumtim, gjithashtu, merr parasysh vlerat e letërsisë shqipe dhe botërore përmbledhur në tekstet e letërsisë. Si rrjedhojë, nxënësit që kanë marrë pjesë në hulumtim tregojnë një pakënaqësi të dukshme me përmbajtjet e teksteve letrare në nivelin e tyre shkollor. Këtyre rezultateve mund t'u bëhet një analizë e shumanshme, por gjithsesi duhet marrë në konsideratë se besueshmëria e opinionëve të nxënësve rreth vlerave të teksteve letrare është e besueshme.

Teksti i leximit (letërsisë) mjafton për të kuptuar dhe interpretuar letërsinë shqipe e botërore:




Grafiku 3. Teksti i letërsisë - të kuptuarit dhe interpretimi i letërsisë shqipe dhe botërore

4. Tekstet shkollore të letërsisë janë të ngarkuara me fjalë që nxënësit nuk i kuptojnë

Në pohimin *Tekstet shkollore të letërsisë leximit janë të ngarkuara me fjalë që nxënësit nuk i kuptojnë*, 26 nxënës janë shprehur se aspak nuk pajtohen, 40 të tjerë nuk pajtohen, 51 janë neutralë, 41 pajtohen dhe 54 prej tyre

pajtohen plotësisht. Nga hulumtimi vihet në pah se tekstet shkollore të klasës së dhjetë, të njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë janë të ngarkuara me fjalë që nxënësit nuk i kuptojnë. Në kontekstin e pretendimit se librat shkollorë të letërsisë, veçanërisht ata të përcaktuar për klasat dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë, shfaqin një dendësi leksikore të shquar, të karakterizuar nga përfshirja e fjalëve përtej kuptimit të nxënësve. Rezultatet empirike tregojnë një shpërndarje të opinionit nga nxënësit që kanë marrë pjesë në hulumtim. Hulumtimi nxjerr në pah një model të dukshëm, ku tekstet letrare për nivelet e mësipërme shkollore duket se përfshijnë fjalësi që tejkalojnë kuptimin kognitiv të demografisë së nxënësve.

Tekstet shkollore të letërsisë janë të ngarkuara me fjalë që nxënësit nuk i kuptojnë:



Grafiku 4. Ngarkesa e teksteve shkollore me fjalë që nxënësit nuk i kuptojnë

5. A e lexoni dhe analizoni letërsinë si art?

Për të konstatuar nëse nxënësit letërsinë e lexojnë dhe e analizojnë si art, parashtruar disa pyetje për nxënësit që ishin pjesë e hulumtimit.

Në pyetjen A përjetoni kënaqësi estetike duke lexuar vepra letrare?, nga 219 nxënës, sa ka qenë mostra, 67 prej tyre ose 31,8% pohojnë se përjetojnë

kënaqësi estetike, ndërsa 152 nxënës ose 68.2% aspak nuk pajtohen se duke lexuar vepra letrare përjetojnë kënaqësi estetike.

Në pyetjen A mësojnë diçka për jetën?, nga 219 nxënës, 74 ose 35.1% përgjigjen se mësojnë shumëçka për jetën, kurse 145 nxënës ose 64.9% mendojnë se nga tekstet letrare nuk mësojnë asgjë për jetën.

Në pyetjen A u ndihmon letërsia për t'u shprehur?, 108 nxënës ose 51,2% theksojnë se u ndihmon për t'u shprehur, kurse 111 ose 48,8% nuk e pohojnë një gjë të tillë.

Në pyetjen A u ndihmon letërsia për të fituar kulturë letrare?, 123 nxënës ose 58,3% deklarojnë se u ndihmon për të fituar kulturë letrare, kurse 96 nxënës ose 41.7% nuk janë të pajtimit se letërsia u ndihmon atyre për të fituar kulturë letrare.

Megjithatë, shumica janë shprehur se tekstet letrare krijojnë aftësi komunikimi dhe konsiderohet përgjigjja më racionale. Megjithatë, kur vjen puna te motivimi i nxënësve për të lexuar letërsinë si art të bukur, përgjigjet dominuese tregojnë se letërsia u ofron atyre aftësi për t'u shprehur, kënaqësi estetike, në krahasim me rëndësinë që ka leximi për të kuptuar jetën dhe për të fituar një kulturë të përgjithshme letrare. Prandaj, mbetet në dorën e nxënësve të theksojnë, ndoshta edhe me forcë, se leximi duhet të pajiset me një kulturë të folur dhe të shkruar. Kështu, kultura e shkrimit dallohet nëpërmjet krijimtarisë, shprehjes së fuqishme dhe prezantimit dinjitoz që reflekton në personalitetin e secilit nxënës.

Opinionet e nxënësve

- Ka njësi mësimore që janë të gjata dhe kanë shumë detaje, por ka edhe njësi mësimore që janë të shkurta dhe të kuptueshme;
- Përmbajnë shumë tekst të panevojshëm;
- Janë shumë të gjata, kanë informata që nuk na nevojiten;
- Ndoshta ndonjëherë, por nuk mendoj se janë aq të gjata;

- Po, shumë. Paramendo 15 faqe një autor, gjë që nuk është e pranueshme për nxënësit;
- Në të shumtën e rasteve po, pastaj bëhen edhe monotone;
- Po, shumë të ngarkuara. Shumica nga to nuk mendoj se duhen;
- Jo edhe aq shumë;
- Po, shumë të gjata.

Ka dallime kontradiktore nga ana e nxënësve, ngase disa thonë temat janë shumë të gjata dhe disa shumë të shkurtra. Në shumicën e rasteve po, por me ndihmën e profesorëve arrijnë t'i kuptojnë dhe t'i kanë më të thjeshta, edhe pse disa tema janë shumë të mërzitshme.

Rezultatet e hulumtimit me mësime të mësuara

1. Në pyetjen e parashtruar mësime të mësuara, Cili është vështirësi juaj për tekstet aktuale shkollorë të letërsisë, a është i përshtatshëm zbatimi i tyre?, mësime të mësuara kanë theksuar se teksti i letërsisë për klasat e 11-ta është në nivelin e duhur, por disa të tjerë deklarojnë se është e vështirë të përgatiten plani dhe programi mësimor me librat aktualë. Duhet theksuar se librat shkollorë janë shumë të mirë, por të ngarkuar dhe është e vështirë t'i jepet hapësirë punës së pavarur ku duhet të bisedohet, reflektohet dhe analizohet për mësimin letrar. Problem të theksuar mësime të mësuara e kanë pikërisht përgatitjen e planit dhe programin për klasën e 12-të, sepse ka material shumë dhe pak orë mësimore.

Tekstet shkollorë të letërsisë janë të përshtatshme për procesin mësimor, me përjashtim të disa gabimeve teknike dhe gjuhësore. Vështirësia për zbatimin e tyre mund të ndryshojë në varësi të nxënësve.

2. Në pyetjen e parashtruar mësime të mësuara, Si mund të organizojnë mësime të mësuara një hapësirë më të gjerë për diskutime dhe debate me nxënësit, duke u fokusuar në analizën e përmbajtjeve dhe situatave letrare në tekstet shkollorë?, sipas tyre, nxënësi ka të drejtë dhe përgjegjësi në të shprehur dhe liri të kërkojë, të kalojë dhe të japë informata dhe ide nga të

gjitha llojet, qoftë me gojë ose me shkrim, rreth njësive mësimore që gjenden në tekst.

Nxënësve u jepet hapësirë mjaftueshëm nga ana e mësimit, por mundësia është e vogël, sepse orë ka pak në raport me materialin, nëse duam ta zhvillojmë si duhet.

Diskutimit dhe debateve me nxënësit, lidhur me përmbajtjet dhe situatat letrare në tekstet shkollore, u jepet hapësirë, por mungesa e teknologjisë dhe mjeteve të tjera të konkretizimit e vështirëson punën.

Metodat efektive mund të ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më thellësisht tekstin, të analizojnë aftësitë e tyre kritike dhe analitike dhe t'i shprehin mendimet e tyre.

Për të bërë përdorimin më efektiv të hapësirës për diskutime dhe debate në tekstet shkollore, është e nevojshme që mësimit të përcaktojnë qëllimin e tyre mësimor, të kenë një plan mësimor të qartë dhe të sigurojnë se nxënësit janë të përfshirë dhe të angazhuar në proces.

Gjithashtu, mësimit mund të ofrojnë mbështetje dhe ndihmë për nxënësit që duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre në diskutim dhe debat, për aq sa e kërkon nevoja e debatit apo diskutimit mësimor për nevojat rreth përmbajtjeve letrare në këto tekste shkollore.

3. Në pyetjen e parashtruar mësimit, Cila është rëndësia e teksteve shkollore të letërsisë dhe a keni vërejtur gabime në përmbajtje në drejtshkrim?, mësimit në përgjithësi theksojnë se tekstet e Letërsisë dhe gjuhës shqipe, të klasave X, XI dhe XII, janë në nivelin e duhur, nuk kemi vërejtur gabime drejtshkrimore, përveç disa gabimeve teknike. Rëndësia e teksteve shkollore të letërsisë është e madhe, sepse nëpërmjet saj nxënësit kanë mundësi të ndërlihen edhe me historikun e letërsisë, llojet e saj, fazat e saj etj.

Rëndësia e teksteve shkollore të letërsisë është shumë e madhe, sepse pa libra nuk ka as mësim cilësor, mirëpo disa mësimit theksojnë që në disa raste ka edhe gabime drejtshkrimore.

4. Në pyetjen e parashtruar mësimdhënësve, Në tekstet shkollore të letërsisë nxënësit a i kuptojnë detyrat, pyetjet, përshkrimet, shembujt, fjalët e panjohura, pa dhënë shpjegime ju si mësimdhënës?, kemi këto përgjigje: Duke e ndjekur përmbajtjen e teksteve shkollore aktuale në AML, nxënësit kanë mundësi të parashtrojnë pyetje dhe t'i përshtatin ato me temën, si dhe duke i përdorë aftësitë e mendimit kritik. Unë kërkoj që nxënësit të reflektojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë, të sintetizojnë, që të lidhin dhe analizojnë përmbajtjen e koncepteve të mësuara.

Ka raste kur nuk i kuptojnë, por ua shpjegojmë ne edhe nga këndi ynë edhe përmes fjalorëve. Unë dhe të tjerët i angazhojmë të interesohen edhe vetë, kështu që në orën e radhës e diskutojmë dhe vijmë në përfundimin e kuptimit të asaj që e kërkojmë, duke i diskutuar ato që kemi sjellë nga detyrat e shtëpisë.

Në tekstet shkollore të letërsisë, nxënësit i kuptojnë detyrat, pyetjet dhe përshkrimet, por te pjesa e mësimëve, kur bëhet fjalë për letërsinë filobiblike dhe letërsinë e bejtexhinjve, nxënësit kanë vështirësi të disa fjalë.

5. Në pyetjen e parashtruar mësimdhënësve, Çfarë mendoni për cilësinë e teksteve shkollore të letërsisë?, mësimdhënësit janë shprehur se tekstet shkollore të letërsisë (tekstet aktuale) e kanë një rol shumë pozitiv në renditje dhe në përmbajtje, si dhe i përmbushin nevojat e tyre në arritjen e rezultateve të nxënësve në letërsi. Cilësia e librave shkollorë të letërsisë, të cilët po i përdorim në vitet e fundit janë të mira. Tekstet e reja, në krahasim me tekstet e mëhershme, kanë një përparim, por ende nevojitet të përpunohen.

Mësimdhënësit propozojnë, gjithashtu, se versioni digjital i teksteve duhet të jetë më i pranishëm te nxënësit.

Tekstet shkollore kanë një cilësi të mirë, pasi u mundësojnë nxënësve të zhvillojnë aftësinë e analizës së teksteve dhe të krijojnë mendime të ndryshme në lidhje me to.

Tekstet shkollore të letërsisë kanë thellësi dhe kompleksitet që të inkurajojnë nxënësit të diskutojnë, të analizojnë, dhe të interpretojnë tekstin në mënyra të ndryshme.

Gjatë hulumtimit, sipas mësimdhënësve, janë përfshirë të gjitha periudhat e letërsisë, që nga fillimi deri në fund, si ajo shqipe ashtu edhe ajo botërore, por sikur të ishin nga pesë orë mësimore, si më herët, do të ishte më lehtë, por tash, në vend të katër vjet shkollim, kemi tre me atë program mësimor.

Përfundime

Letërsia në tekstet aktuale shkollore në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë dhe qasja e mësimdhënësve ndaj njësive të caktuara mësimore nga letërsia duhet të jetë e veçantë, në mënyrë që të dalin në pah mesazhe edukative - arsimore dhe kulturore, të cilat ndikojnë në formimin e përgjithshëm të nxënësve që kanë ndikim në njohuritë e tyre.

Bazuar në rezultatet e hulumtimit, kemi nxjerrë këto përfundime:

- Ndikimi i teksteve letrare në formimin kulturor: Nxënësit shprehen se tekstet letrare në tekstet shkollore kanë ndikim të ndjeshëm në formimin e tyre kulturor. Përmbajtjet e njësive letrare, shqipe dhe botërore, perceptohen si pjesë e rëndësishme në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe lexuese të nxënësve.
- Interesimi për lexim dhe interpretim: Shumica e nxënësve pohojnë se përmbajtjet e njësive letrare kanë ndikim pozitiv në interesimin e tyre për lexim dhe interpretim. Megjithatë, ka vlerësime të ndryshme lidhur me rëndësinë e tyre në zhvillimin e kulturës së shkrimit dhe leximit.
- Në disa raste, nxënësit shprehen se tekstet shkollore janë të ngarkuara me fjalë që ata nuk i kuptojnë. Kjo mund të reflektojë nevojën për një gjuhë më të qartë dhe të përshtatshme për nivelin e tyre shkollor.
- Nxënësit përqendrohen në përvojën estetike dhe aftësitë komunikuese që ofron leximi i letërsisë si art. Megjithatë, vlerësohen edhe aspektet e tjera, përfshirë mësimin për jetën dhe fuqizimin e aftësive për shprehje.

- Mësimdhënësit i vlerësojnë tekstin e letërsisë si të mira dhe vërejnë një përparim në cilësi, krahasuar me tekstet e mëparshme. Ata propozojnë prezantimin e versionit digjital për të përmirësuar prezantimin dhe përdorimin nga nxënësit, si dhe rishikimin e teksteve aktuale, të cilat janë në përdorim.

Rekomandime

Bazuar në rezultatet e hulumtimit, kemi nxjerrë këto rekomandime:

- Tekstet shkollore duhet të përgatiten duke bashkëpunuar me ekspertë dhe mësues të letërsisë shqipe nga shkollat e mesme të larta;
- Njësitë mësimore në tekstet shkollore duhet të adaptohen me metodologjitë e reja mësimore dhe të jenë të përdorshme në praktikë gjatë procesit të mësimin;
- Njësitë mësimore të përgatiten në atë mënyrë që të ndikojnë në formimin kulturor të nxënësve, duke siguruar kështu një mjedis mësimor që promovon zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive në të shprehur.
- Tekstet letrare në tekstet shkollore duhet të jenë të përshtatshme për lexuesit e shkollave të mesme të larta, duke ofruar terminologji të qartë, dhe të shoqërohen me sqarime shtesë për të bërë përmbajtjen më të kuptueshme dhe për të ndihmuar në thellimin e analizës së teksteve;
- Në tekstet e letërsisë temat e zgjedhura të mos jenë të gjata dhe mos të ngarkohen me fjalë të panjohura për nxënësit, por të përfaqësohen me më shumë njësi, autorë dhe tema, të periudhave të ndryshme letrare, me interes për ta.

Literatura

- Devetaku-Gojani, H. (2009). *Gjuha shqipe në tekstet shkollore*. Prishtinë.
- Granath, S. (2017). *Teaching literature in upper-secondary English class A qualitative study of Swedish teachers' approaches and experiences*. Sweden: Malardalen University-School of Education, Culture and Communication. Von <https://www.diva-portal.org/smash/get/diva2:1177161/FULLTEXT01.pdf> abgerufen
- Koliqi, D. (2014). *Barazia gjinore në tekstet e gjuhës shqipe dhe të lëndëve shoqërore të shkollës fillore të Kosovës*. Prishtinë.
- Mari, F., & Rozhje, Z. (2002). *Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore*. Pedagogjia në zhvillimin e oraktikave metodike.
- MASHT. (2007). *Ligji Nr. 02/L-67 Për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit Pedagogjik*. Prishtinë: Gazeta zyrtare e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë. Von <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2437> abgerufen
- MASHT. (2011). *Standarde për tekstet shkollore*. Prishtinë. Von <https://masht.rks-gov.net/05-ua-zbatimi-i-standardeve-per-tekstet-shkollore-nr-5-2011-date-31-08-2011/> abgerufen
- MASHT. (2016). *Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës (Gjinnazet – klasa X, XI, XII)*. Prishtinë. Von <https://masht.rks-gov.net/kurrikula-berthame-per-arsimin-e-mesem-te-larte-te-kosoves-gjinnazet-klasa-x-xi-xii/> abgerufen
- Matoshi, H. (2008). *Tekstete shkollore letrare dhe formimi letrar*. Prishtinë.
- Rexhepi, N. (2002). *Letërsia shqipe në tekstet shkollore të Kosovës (1945-1990)*. Prishtinë.
- Shahini, G. (2020). *Planet dhe programet mësimore në lëndën e gjuhës shqipe*. Prishtinë.
- Shala, S. (2016). *Policy formulation and Evaluation of textbooks in Albania and Kosovo*. Freiburg: Journal of Teaching and Education.
- Showalter, E. (2003). *Mësimdhënia e Letërsisë*.
- Titini, S., & Mustafaraj, E. (2015). *Problemet që lidhen me njohuri të leksikore në tekstet e gjuhës shqipe X-XII*. Prishtinë.

ADRESIMI I TIK-UT NË KURRIKULË DHE VËSHTIRËSITË NË ZBATIMIN E LËNDËS TEKNOLOGJI ME TIK NË SHKOLLAT E MESME TË ULËTA

Agim Bujari⁵
agim.bujari@rks-gov.net
Sahare Reçica Havolli⁶
sahare.recica@rks-gov.net

Abstrakt

Kurrikula lëndore Teknologji me TIK zbatohet që nga klasa e gjashtë e arsimit të mesëm të ulët. Në kuadër të kësaj lënde, nxënësit mësojnë dhe marrin njohuritë lidhur me teknologjinë dhe bazat elementare të teknologjisë informative, me kompjuter dhe pajisje të tjera elektronike.

Qëllimi i këtij studimi është që përmes hulumtimit empirik të identifikojmë adresimin e TIK-ut në kurrikulë dhe vështirësitë që dalin gjatë zbatimit të lëndës Teknologji me TIK. Sa janë të përshtatshme tekstet e kësaj lënde, sa zbatohen modulet nga ana e mësimitdhënësve: duke përfshirë TIK-un në Këshillim dhe orientim në karrierë; Puna dhe edukimi në ndërmarrësi; Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm; metodologjitë e mësimitdhënies-nxënies; mënyrat e vlerësimit dhe tekstet mësimore.

Studimi i kësaj tematike është bërë përmes qasjes së kombinuar. Përmes pyetjeve të shkallëzuara, janë siguruar të dhëna sasiore, ndërsa përmes pyetjeve të hapura janë siguruar informacione cilësore për çështjen në fjalë.

Në këtë studim janë përfshirë 458 nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe 16 mësimitdhënës të lëndës Teknologji me TIK.

Lidhur me përshtatshmërinë e teksteve shkollore të lëndës Teknologji me TIK, rreth 25% e nxënësve janë shprehur se tekstet janë shumë të përshtatshme, 50% janë shprehur se tekstet janë të përshtatshme, dhe 25 % e nxënësve janë shprehur se tekstet janë deri diku të përshtatshme. Në bazë të mesatares së rezultateve, nxënësit e klasës së gjashtë kanë një vlerësim më të lartë për tekstet shkollore, $M=3.98$, ndërsa nxënësit me vlerësimin më të ulët

⁵ Hulumtues për mësimitdhënie dhe zhvillim profesional të mësimitdhënësve në Institutin Pedagogjik të Kosovës

⁶ Hulumtuese për arsim special në Institutin Pedagogjik të Kosovës

Kërkime Pedagogjike

të teksteve të lëndës Teknologji me TIK e kanë nxënësit e klasës së 9, $M=3.54$. Duke u bazuar në rezultatet e testit ANOVA, rezulton se dallimet në vlerësimin e teksteve shkollore nga ana e nxënësve, janë të rëndësishme statistikisht, pasi që $p=0.07 < 0.05$.

Rezultatet treguan se, në shkollën e mesme të ulët, janë identifikuar shumë probleme në zbatimin e TIK. Gjetjet treguan se nuk zbatohen në nivelin e duhur modulet e parapara për këtë lëndë, ka probleme të theksuara me tekstet, si dhe mungojnë pajisjet për zbatim të suksesshëm.

Fjalët çelës: jeta dhe puna, kurrikula lëndore, TIK-u, vështirësi, zbatim.

Addressing ICT in the Curriculum and the difficulties in implementing the subject Technology with ICT at the Lower secondary school

Abstract

The subject curriculum for Technology with ICT is implemented from the sixth grade of lower secondary education. Within this subject, students learn and acquire knowledge related to technology, and the elementary basics of Information Technology using computers and other electronic devices.

Through empirical research, The purpose of this study was to identify the extent to which ICT is addressed in the curriculum and the difficulties that arise during the implementation of the subject: Technology with ICT. The focus was to explore the suitability of textbooks for this subject, and more specifically how well are the modules implemented by the teachers including: ICT in Counseling and career guidance, work and education in entrepreneurship, education for sustainable development, teaching-learning methodologies, and assessment methods.

The study of this topic was conducted using a combined methodological approach. Through scaled questions, quantitative data were collected, while through open-ended questions, qualitative information was provided about the topic for research.

This study involved 458 lower secondary school students and 16 teachers of the subject Technology with ICT.

Regarding the suitability of the textbooks of the subject Technology with ICT, about 25% of the students said that the texts are very suitable, 50% said that the texts are suitable and 25% of the students said that the texts are somewhat suitable. Based on the average of the results, the students of the sixth grade have a higher rating for the textbooks, $M=3.98$, while the students with the lowest rating of the textbooks of the subject Technology with ICT, have the students of the 9th grade, $M=3.54$. Based on the results of the ANOVA test, it turns out that the differences in the evaluation of the textbooks by the students were statistically significant, since $p=0.07 < 0.05$.

The results showed that, in the lower secondary school, many problems have been identified in the implementation of ICT. Findings show that the previous modules for this subject were not implemented at the expected level, there were significant problems with the textbooks, and schools lack necessary equipment for successful implementation.

Keywords: Life and work, subject curriculum, ICT, difficulties, implementation

Hyrje

Lënda mësimore Teknologji me TIK fillon të zbatohet nga klasa e gjashtë e arsimit të mesëm të ulët. Përmes kësaj lënde, nxënësit marrin njohuritë elementare të teknologjisë dhe teknologjisë informative me kompjuter.

Qëllimi i lëndës Teknologji me TIK ndryshon nga viti në vit, duke filluar nga zhvillimi i shkathtësive praktike në përdorimin e TIK-ut, letrës, drurit, veglave të punës, zhvillimin e të menduarit kritik, gjatë krijimit të modeleve në praktikë profesionale (MASHT, 2018a), duke i aftësuar ata për zgjidhje të problemeve praktike, marrjen e vendimeve, punën e pavarur, punën me projekte përmes përdorimit të TIK-ut, shkathtësitë për jetë, si dhe i orienton ata drejt qëllimeve të veta (MASHT, 2018b).

Në kuadër të kësaj lënde, zbatohen disa module, të cilat janë me përzgjedhje vullnetare nga ana e nxënësve. Disa module pëlqehen më shumë nga ana e nxënësve dhe zbatohen më shumë nga ana e mësimitdhënësve.

Përmes kësaj lënde, nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë, nxënësit krijojnë një bazë të mirë teorike, por edhe praktike, në punën me teknologji të ndryshme, duke përfshirë makineri për përpunimin e materialeve të ndryshme, deri në hartimin e projekteve dhe përdorimin e TIK-ut për qëllime mësimore. Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit përkufizohen si të gjitha pajisjet, mjetet, përmbajtjet, burimet, forumet dhe shërbimet, digjitale dhe ato që mund të shndërrohen në ose të shpërndahen përmes formave digjitale, të cilat mund të përdoren për realizimin e qëllimeve të mësimitdhënies së të nxënësve, duke rritur qasjen dhe shtrirjen e burimeve, ngritjen e kapaciteteve, si dhe menaxhimin e sistemit arsimor (Department of School Education and Literacy Ministry of Human Resource Development Government of India, 2012).

Kur mësimitdhënësit kanë aftësi digjitale dhe janë të trajnuar për përdorimin TIK-un, këto qasje mund të çojnë në aftësi më të larta të të menduarit, të ofrojnë mundësi krijuese dhe të individualizuara për nxënësve për të shprehur të kuptuarit e tyre, si dhe i përgatisin ata për t'u përballur me ndryshimet e vazhdueshme teknologjike në shoqëri dhe në vendin e punës. Andaj, shkolla e mesme e ulët duhet të rrisë kapacitetet dhe t'i përgatisë nxënësit sa më mirë në përdorimin e kompjuterit, teknologjisë.

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Në shekullin e 21-të, termi "teknologji" është një çështje e rëndësishme në shumë fusha, përfshirë arsimin. Kjo për shkak se teknologjia është bërë "autostrada" e transferimit të njohurive në shumicën e vendeve. Integrimi i teknologjisë në ditët e sotme ka kaluar nëpër inovacione dhe ka transformuar shoqëritë tona, ka ndryshuar tërësisht mënyrën se si njerëzit mendojnë, punojnë dhe jetojnë (Grabe, M.&Grabe, C. , 2007).

Sipas Arnseth dhe Hatlevik (2012), cituar në Ghavifekr dhe Rosdy, Integrimi i Informacionit, Komunikimit dhe Teknologjisë (TIK), në arsim i referohet përdorimit të komunikimit të bazuar në kompjuter, që inkorporohet në procesin e përditshëm mësimor në klasë. Në lidhje me përgatitjen e nxënësve për epokën aktuale digjitale, mësuesit shihen si lojtarët kryesorë në përdorimin e TIK-ut në klasat e tyre të përditshme. Kjo është për shkak të aftësisë së TIK-ut për të ofruar mjedis dinamik dhe proaktiv të mësimdhënies - të nxënësve (Ghavifekr, S. & Rosdy, W.A.W. , 2015).

Fusha kurrikulare Jeta dhe puna në shkollën e mesme të ulët

Fusha kurrikulare Jeta dhe puna fillon të zbatohet që në arsimin fillor, me lëndën mësimore Shkathtësi për jetë. Në arsimin e mesëm të ulët, në kuadër të fushës Jeta dhe puna, zbatohet lënda mësimore Teknologji me TIK, e cila fillon të zbatohet që nga klasa e gjashtë e arsimit të mesëm të ulët.

Lënda Teknologji me TIK në kurrikulën e klasës së gjashtë

Në kurrikulën lëndore për klasën e gjashtë parashihet që, përmes fushës kurrikulare "Jeta dhe Puna" nxënësit të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si: anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijesimin dhe vetëbesimin për ekzistimin e mundësive të orientimit profesional (përzgjedhja e profesionit), përdorimin e TIK-ut, ushtrimin e

parimeve të ndërmarrësisë dhe zbatimin e aktiviteteve për arritjen e kompetencave për zhvillim të qëndrueshëm (MASHT, 2018a).

Qëllimi i kësaj lënde është të zhvillojë te nxënësit shkathtësitë praktike, duke filluar me përdorimin e TIK-ut, letrës, drurit, veglave të punës, zhvillimin e të menduarit kritik gjatë krijimit të modeleve në praktikë. Gjithashtu, nxit bashkëpunimin, punën në grupe dhe projekte të ndryshme, duke zhvilluar parimet e ndërmarrësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe kompetencat për të orientuar ata drejt qëllimeve për karrierën e tyre profesionale (MASHT, 2018a).

Lënda Teknologji me TIK në kurrikulën e klasës së shtatë

Në fushën Jeta dhe Puna, në klasën VII, lëndë bartëse është lënda Teknologji me TIK.

Lënda Teknologji me TIK synon të zhvillojë shkathtësitë praktike te nxënësit, duke filluar me përdorimin e plastikës, letrës, drurit, veglave të punës, përpunimin e të dhënave me programe kompjuterike, si dhe zhvillon të menduarit kritik gjatë krijimit të modeleve në praktikë.

Në kuadër të kësaj lënde do të zhvillohen module, të cilat synojnë të përmbushin konceptet kryesore të fushës Jeta dhe Puna për shkallën III, si:

- Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë;
- Puna dhe edukimi për ndërmarrësi;
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Përmes teknologjisë dhe TIK-ut, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë: qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Njëkohësisht, nxënësit do të vetëdijësohen për mundësitë e orientimit profesional.

Qëllimi i kësaj lënde është që të zhvillojë të menduarit kritik te nxënësit, duke i aftësuar ata për zgjidhje të problemeve praktike, marrjen e vendimeve, punën e pavarur, punën me projekte përmes përdorimit të TIK-

ut, shkathtësitë për jetë, si dhe i orienton ata drejt qëllimeve të veta (MASHT, 2018b).

Lënda Teknologji me TIK në kurrikulën e klasës së tetë

Lënda Teknologji me TIK në klasën VIII synon të zhvillojë shkathtësitë praktike teknologjike te nxënësit, duke filluar me paraqitjen e trupave, përdorimin e metaleve, njohjen e motorëve, llojet e transmetuesve, funksionin e mekanizmave, teknologjinë e materialeve makinerike, përdorimin e pajisjeve teknike, trafiku, paraqitja e rolit të simuluesve, si dhe përpunimi dhe llogaritja e të dhënave me program kompjuterik, duke zhvilluar të menduarit kritik gjatë krijimit të projekteve praktike teknologjike (MASHT, 2019).

Në kuadër të lëndës Teknologji me TIK zhvillohen module, të cilat synojnë të përmbushin konceptet kryesore të fushës Jeta dhe Puna për shkallën 4, si: Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë, Puna dhe edukimi për ndërmarrësi dhe Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm. Të gjitha këto koncepte zhvillohen në ndërlidhje të rezultateve të fushës dhe të lëndës për të arritur qëllimin kryesor të fushës Jeta dhe Puna (MASHT, 2019).

Përmes Teknologjisë dhe TIK-ut, ndërmarrësisë, orientimit në karrierë, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijesimin dhe vetëbesimin për ekzistimin e mundësive të orientimit profesional (përzgjedhja e profesionit), përdorimit të TIK-ut etj. (MASHT, 2019).

Lënda Teknologji me TIK në kurrikulën e klasës së nëntë

Kjo lëndë synon të zhvillojë punën e pavarur, shkathtësitë praktike dhe hulumtuese te nxënësit për zgjidhjen e sfidave të ndryshme kompjuterike, si dhe të menduarit kritik gjatë krijimit të modeleve në praktikë. Në kuadër të kësaj lënde, do të zhvillohen module, të cilat synojnë të përmbushin konceptet kryesore të fushës Jeta dhe Puna për shkallën IV, si:

- Teknologji duke përfshirë TIK-un;
- Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë;
- Puna dhe edukimi për ndërmarrësi;
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Përmes Teknologjisë dhe TIK-ut, nxënësit do të njihen me shkathtësitë e dizajnit, teknologjinë e materialeve, elektronikën, programimin, integrimin e pajisjeve me programe softuerike, teknologjinë e transportit, si dhe të dinë të përzgjedhin orientimin e tyre profesional, përmes idesë së tyre për të ardhmen, si dhe puna dhe edukimi për ndërmarrësi. Shkalla e kurrikulës IV - përforsim dhe orientim, synon t'i orientojë nxënësit që të marrin parasysh mundësitë e ndryshme të karrierës (MASHT, 2020).

METODOLOGJIA

Qasja e studimit

Hulumtimi është i kombinuar, me qasje sasiore dhe cilësore. Në pyetësor, përveç pyetjeve me përgjigje alternative, kishte edhe pyetje të hapura, të cilat u kanë dhënë mundësi nxënësve dhe mësuesve për shprehje të lirë të mendimit. Qasja e kombinuar mundëson që njëra ta plotësojë tjetrën. Ndonjëherë është e vështirë që përmes pyetjeve të mbyllura të nxjerrim të dhënat e kërkuara, kështu që qasja cilësore mundëson plotësimin e mangësive të qasjes sasiore.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij studimi është që përmes hulumtimit empirik të identifikojmë adresimin e TIK-ut në kurrikulë dhe vështirësitë që dalin gjatë zbatimit të lëndës Teknologji me TIK. Sa janë të përshtatshme tekstet e kësaj lënde, sa zbatohen modulet nga ana e mësuesve, duke përfshirë TIK-un në Këshillim dhe orientim në karrierë; puna dhe edukimi në ndërmarrësi; edukimi për zhvillim të qëndrueshëm; metodologjitë e mësuesve; mënyrat e vlerësimit dhe tekstet mësimore.

Popullata e studimit dhe pjesëmarrësit

Popullatën e studimit e përbëjnë të gjithë nxënësit e shkollës së mesme të ulët dhe të gjithë mësimitdhënësit e lëndës Teknologji me TIK që punojnë në shkollën të mesme të ulët. Në këtë studim janë përfshirë 458 nxënës të shkollës së mesme të ulët dhe 16 mësimitdhënës të lëndës Teknologji me TIK. Duke u bazuar në faktin se popullata e nxënësve është dukshëm më e madhe se ajo e mësimitdhënësve, edhe numri i nxënësve pjesëmarrës në hulumtim është më i madh se ai i mësimitdhënësve.

Pyetjet e hulumtimit

Pyetja 1: Përmes cilave forma të punës mësimore angazhohen nxënësit në lëndën Teknologji me TIK?

Pyetja 2: Për çfarë arsye përdoret kompjuteri në lëndën Teknologji me TIK?

Pyetja 3: Cilat vështirësi paraqiten gjatë realizimit të lëndës së TIK-ut?

Pyetja 4: Sa janë të përshtatshme tekstet e lëndës Teknologji me TIK?

Pyetja 5: Cili është perceptimi i mësimitdhënësve për shfrytëzimin e TIK-ut nga nxënësit për arritjen e rezultateve?

Pyetja 6: Cili është realizimi i moduleve të lëndës Teknologji me TIK?

Mostra e nxënësve

Në këtë studim morën pjesë 458 nxënës, prej tyre 52.2% të gjinisë femërore, ndërsa 47.8% të gjinisë mashkullore, 13.1% janë të klasës së 6-të, 17.7% të klasës së 7-të, 32.8% të klasës së 8-të, 36.5% të klasës së 9-të, ku në një klasë mesatarisht mësojnë 20 nxënës.

Nga komuna e Suharekës janë 10% e nxënësve, 23.4% nga komuna e Ferizajt, 20.1% të komunës së Prizrenit, 36.5% të komunës së Prishtinës,

dhe 10 % të nxënësve janë nga komuna e Fushë-Kosovës. Në secilën shkollë është përzgjedhur nga një paralele e klasave 6-9, në mënyrë rastësore.

Mostra për mësimdhënës

Në këtë studim morën pjesë 16 mësimdhënës të lëndës TIK, që japin mësim në klasat 6, 7, 8 dhe 9. Prej tyre, 56.3% janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 43.7% të gjinisë femërore, rreth 50% janë të moshës 51-60, 37.5%, janë të moshës 31-40 vjeç, ndërsa 12.5%, janë të moshës 41-50 vjeç.

81.2% i kanë të përfunduar studimet bachelor 4-vjeçar, 6.3% kanë të përfunduar bachelor 3- vjeçar, ndërsa 12.5% kanë të kryer studimet master. Sa i përket përvojës së punës në arsim, 6.3% e pjesëmarrësve kanë përvojë deri 3 vjet, 25% kanë përvojë 4-10 vjet, 12.5% kanë përvojë 11-20 vjet, 6.2% kanë përvojë 21-30 vjet dhe 50 % kanë përvojë mbi 30 vjet. 43.8% punojnë në fshat, 50% punojnë në qytet dhe 6.2% punojnë edhe në fshat edhe në qytet.

Instrumentet e hulumtimit

Për realizimin e këtij studimi, u përdorën dy instrumente: pyetësi për nxënës dhe pyetësi për mësimdhënës.

Instrumenti për nxënës është hartuar enkas për këtë studim dhe përbëhet nga gjithsej 48 variabla. Prej këtyre variablave, 6 janë të dhëna demografike, ndërsa 42 janë variabla që lidhen me çështjen e studimit. Prej 42 variablave që lidhen me studimin, 6 prej tyre janë pyetje të hapura, përmes të cilave është kryer studimi cilësor, ndërsa 36 janë pyetje me opsione ose shkallë, përmes së cilave janë mbledhur të dhëna sasiore. Pyetësi për mësimdhënës është i përafërt me pyetësin e nxënësve, por ekzistojnë edhe disa dallime, të cilat janë vetëm në aspektin e përshtatjes me nivelin e kapaciteteve akademike/informative. Ky pyetësor përbëhet nga 9 variabla, që janë të dhëna demografike dhe profesionale të mësimdhënësve, por janë edhe rreth 60 variabla të tjera që lidhen me temën e studimit.

Procedura e mbledhjes së të dhënave

Para fillimit të mbledhjes së të dhënave, së pari kemi kontaktuar me Drejtoritë e Arsimit në komunat që është organizuar hulumtimi. Nga Drejtoritë Komunale u siguruan numrat dhe email-at kontaktues të secilit nga drejtorët e shkollave ku do të organizohej hulumtimi. Pastaj kontaktuam me drejtorët e shkollave përkatëse. Me pëlqimin e drejtorit të shkollës, u paraqitem në shkollën përkatëse për të mbledhur të dhënat nga nxënësit dhe mësimsdhënësit. Pyetësorët për mësimsdhënësit dhe nxënës kanë një numër të konsiderueshëm të variablave, andaj për plotësimin e këtyre pyetësorëve nevojitej një kohë afërsisht 30-35 minuta. Hulumtimi u organizua nga autorët që janë hulumtues në Institutin Pedagogjik të Kosovës.

Procedura e analizës së të dhënave

Për analizimin e të dhëna cilësore nuk u përdoret ndonjë pako, por të dhënat e nxjerra u grupuan dhe paraqiten në punim. Të dhënat nga hulumtimi sasior u analizuan përmes paketës statistikore për shkencat sociale (SPSS). Për vlerësimin e rezultateve të të gjitha testeve statistikore, do të vendoset niveli i domethënies statistikore 0.05. Përveç rezultateve përshkruese, ku janë paraqitur rezultatet e frekuencës, janë nxjerrë edhe rezultatet krahasuese dhe përmes testit ANOVA është bërë krahasimi i rezultateve dhe testimi për rëndësinë statistikore.

REZULTATET

Angazhimi i nxënësve në lëndën TIK (metodologjitë e mësimsdhënies - nxënies)

13.3 % e nxënësve pohojnë se në këtë lëndë angazhohen përmes diskutimit dhe bashkëpunimit, 7.6 % e tyre pohojnë se angazhohen përmes punës individuale, 2.2 % përmes punës në grup, 12% me anë të projekteve dhe 64.8 % pohojnë se angazhohen përmes punës praktike me mjete teknologjike, sidomos me kompjuter.




Figura 1. Angazhimi në lëndën TIK

Përdorimi i kompjuterit

16.2% e nxënësve pohojnë se kompjuterin e përdorin për t'u përgatitur për jetë, 28.4% pohojnë se e përdorin për të avancuar të mësuarit, 14.8% e përdorin për lojë dhe argëtim, 31.9% për projekte mësimore, 3.7% për prezantime dhe 5 % për çështje të tjera të ndryshme.




Figura 2. Përdorimi i kompjuterit

Veprimet me pajisje teknologjike

Dinë të shkruajnë tekst të shkurtër në word janë deklaruar 88.4% e nxënësve, ndërsa 11.6% e tyre janë shprehur se nuk dinë të shkruajnë tekst të shkurtër në word;

82.1% e nxënësve janë shprehur se dinë të vizatojnë dhe ngjyrosin në paint, ndërsa 17.9% e tyre nuk dinë;

67.5% e nxënësve janë shprehur se dinë të printojnë vizatimet e tyre, ndërsa 32.5% e tyre nuk dinë;

85.6% e nxënësve dinë të krijojnë dhe ruajnë dokumente, ndërsa 14.4 % e tyre nuk dinë të krijojnë dhe të ruajnë dokumente;

Mbi 90.8% e nxënësve janë shprehur se dinë të shfrytëzojnë burime të ndryshme informacioni në internet, ndërsa 9.2% e tyre nuk dinë;

95.9% janë shprehur se dinë të bëjnë punime, projekte, ndërsa 4.1% janë shprehur se nuk dinë të bëjnë punime dhe projekte;

91.7% janë shprehur se dinë të prezantojnë punime para mësimit ndërsa 8.3% nuk dinë;

78.6% janë shprehur se realizojnë aplikacione për prezantim në Power Point, ndërsa 21.4% janë shprehur se nuk dinë ta bëjnë një gjë të tillë;

74.7% e përdorin aplikacionin Microsoft word për çështje mësimore, ndërsa 25.3% e tyre nuk e përdorin këtë aplikacion;

Rreth gjysma e nxënësve (48 %) janë shprehur se e përdorin aplikacionin Excel, ndërsa 52% e tyre nuk përdorin këtë aplikacion;

56.3% janë shprehur se përdorin formula, funksione, grafikë, etj, ndërsa 43.7% e tyre nuk i përdorin;

80.8% janë shprehur se përdorin programe kompjuterike për zbatimin praktik të njësive dhe temave mësimore, ndërsa 19.2% e tyre nuk i përdorin këto programe kompjuterike;

57.4% mund të krijojnë portfolio, gazeta, broshura, doracakë, ndërsa 42.6% e tyre nuk mund t'i krijojnë;

30.6% janë shprehur se përdorin mikro-kontrollerë të ndryshëm për realizimin e aktivitete praktike në klasë dhe jashtë saj (p.sh. Microbit, Arduino etj.), ndërsa 69.4% e tyre nuk përdorin mikro-kontrollerë.

39.5% e nxënësve janë shprehur se krijojnë projekte të ndryshme për mbrojtjen e ambientit, duke përdorur komponentë elektronike (p.sh., kompleti i Microbit, Arduino etj.), ndërsa 60.5% e tyre nuk krijojnë projekte të tilla.

10.9% e nxënësve janë shprehur se janë pjesë e klubeve të Kodimit në shkollë, ndërsa 89.1% e tyre janë shprehur se nuk janë pjesë e klubeve.

59% e nxënësve janë shprehur se marrin informacione të nevojshme rreth drejtimeve, profileve dhe qendrave të aftësimi për interesa personale, ndërsa 41% e tyre janë shprehur se nuk marrin informacione të tilla.

68.3% e nxënësve janë shprehur se identifikojnë kërkesat e profesionit që u pëlqen dhe i krahasojnë ato me njohuritë dhe shkathtësitë personale, ndërsa 31.7% e tyre janë shprehur se nuk mund t'i identifikojnë kërkesat e profesionit që i pëlqen.

78.2% e nxënësve janë shprehur se paraqesin ambiciet e tyre për një profesion të caktuar, ndërsa 21.8% e tyre nuk i paraqesin ambiciet.

70.1% e nxënësve marrin pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup, ndërsa 29.9% e tyre nuk marrin pjesë.

70.3% e nxënësve janë shprehur se analizojnë dhe vlerësojnë përparësitë e përdorimit të llojeve të ndryshme të energjisë në ruajtjen e mjedisit ku jetojnë, ndërsa 29.7% e tyre nuk i analizojnë dhe vlerësojnë këto përparësi.

Rezultatet treguan se 68.7% e nxënësve pohuan se kryejnë detyra e veprime të ndryshme me pajisje teknologjike, duke përdorur aplikacione të ndryshme, ndërsa 31.3% e tyre janë shprehur se nuk e përdorin teknologjinë.

Tabela 1. Veprimet me pajisje teknologjike dhe të tjera

Nr.	Unë di të:	Po	Jo
1	Shkruaj një tekst të shkurtër në Word	88.4%	11.6%
2	Vizatoj dhe ngjyros në Paint	82.1%	17.9%
3	Printoj vizatimet e mia	67.5%	32.5%
4	Krijoj dhe ruaj dokumentin	85.6%	14.4%
5	Kryej detyrat përmes kompjuterit	75.5%	24.5%
6	Shfrytëzoj burime të ndryshme informacioni në internet	90.8%	9.2%
7	Bëjë punime, projekte	95.9%	4.1%
8	Prezantoj punimet para mësimit dhe nxënësve	91.7%	8.3%
9	Realizoj aplikacione për prezantim në PowerPoint etj.	78.6%	21.4%
10	Përdor aplikacionin Microsoft Word për çështje mësimore	74.7%	25.3%
11	Përdor aplikacionin Excel	48%	52%
12	Përdor formulat, funksionet, grafikët, etj.	56.3%	43.7%
13	Përdor programe kompjuterike për zbatimin praktik të njësive dhe temave mësimore	80.8%	19.2%
14	Mund të krijoj: a) Portfolio b) Gazeta c) Broshura d) Doracak	57.4%	42.6%
15	Komunikoj me mësimit përmes platformave të ndryshme: email, whats app, viber, etj.	80.1%	19.9%
16	Përdor mikro-kontrollerë të ndryshëm për realizimin e aktivitete praktike në klasë dhe jashtë saj (p.sh., Microbit, Arduino etj.)	30.6%	69.4%
17	Krijoj projekte të ndryshme për mbrojtjen e ambientit duke përdorur komponente elektronike (p.sh., kompleti i Microbit, Arduino etj.)	39.5%	60.5%
18	Jam pjesë e klubeve të Kodimit në shkollë	10.9%	89.1%
19	Marr informacione të nevojshme rreth drejtimeve, profileve dhe qendrave të aftësimit për interesa personale	59%	41%
20	Identifikoj kërkesat e profesionit që më pëlqen dhe i krahasoj ato me njohuritë dhe shkathtësitë personale	68.3%	31.7%
21	Paraqes ambiciet e mia për një profesion të caktuar	78.2%	21.8%
22	Marr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup	70.1%	29.9%
23	Analizoj dhe vlerësoj përparësitë e përdorimit të llojeve të ndryshme të energjisë në ruajtjen e mjedisit ku jetoj	70.3%	29.7%
	Rezultatet e përgjithshme	68.7%	31.3%

Vështirësitë në TIK

Rreth 88 % e nxënësve pjesëmarrës janë shprehur se nuk kanë vështirësi në TIK, ndërsa 12% e tyre janë shprehur se kanë vështirësi në TIK.




Figura 3. Vështirësitë në TIK, sipas nxënësve

Cilat janë vështirësitë në Lëndën e TIK-ut

Duke u bazuar se shumica e nxënësve janë shprehur se nuk kanë vështirësi në këtë lëndë, pritej që edhe ankesat të jenë më të vogla. Nga pjesa e nxënësve që janë shprehur se kanë vështirësi në Lëndën e TIK-ut, kryesisht janë paraqitur këto ankesa: libri është i komplikuar, apo disa njësi janë të paqarta, mungesa e pajisjeve teknologjike (mungesë e kompjuterëve), apo edhe numri i vogël i kompjuterëve. Ankesa rreth librit është në klasën e tetë, ndërsa mungesa e kompjuterëve nuk lidhet me klasën, por me shkollën.

Përshtatshmëria e teksteve shkollore të Lëndës së TIK-ut

Vetëm 3.1% e nxënësve janë shprehur se libri i TIK-ut është i papërshtatshëm, 5.5% e tyre janë shprehur se libri është pak i përshtatshëm, 29.3% e tyre janë shprehur se libri deri diku është i përshtatshëm, 42.4% e nxënësve janë shprehur se libri është i përshtatshëm dhe vetëm 19.9 % e nxënësve janë shprehur se libri është shumë i përshtatshëm.

Nëse e shikojmë krahasimin e nxënësve të klasave të ndryshme, vërejmë se mesatarja më e lartë është e nxënësve të klasës së 6-të, $M=3.98$, pastaj e klasës së 7-të, $M=3.85$, ndërsa nxënësit e klasës së 8-të, $M=3.69$ dhe klasës së 9-të, $M=3.54$. Pra, rezultatet tregojnë se nxënësit e klasës së tetë dhe klasës së nëntë janë më pak të kënaqur me tekstet e Lëndës së TIK-ut.

Në bazë të rezultateve të paraqitura në tabelën nr. 3, vërehet se $F=4.041$, ndërsa $p=0.007 < 0.05$. Dallimet në vlerësimin e tekstit shkollor janë statistikisht të rëndësishme dhe në bazë të këtyre vlerësimeve teksti më i dobët është ai i klasës së nëntë, pastaj ai i klasës së tetë, me radhë vjen i klasës së shtatë, ndërsa teksti më i mirë, në bazë të nxënësve, është i klasës së gjashtë, megjithëse ka të pakënaqur edhe me këtë tekst.

Në bazë të rezultateve të mësimdhënësve, rezulton se 50 % e tyre janë shprehur se tekstet shkollore janë të përshtatshme, 25% janë shprehur se janë shumë të përshtatshme dhe 25% janë shprehur se tekstet deri diku janë të përshtatshme.

Nëse i krahasojmë rezultatet e nxënësve dhe të mësimdhënësve, rezulton se tekstet shkollore janë më të përshtatshme për t'i prezantuar nga ana e mësimdhënësve sesa që të mësohen nga ana e nxënësve.




Figura 4. Përshtatshmëria e teksteve të TIK-ut, sipas nxënësve

Tabela 2. Krahasimi i mesatareve në bazë të klasave për përshtatshmërinë e teksteve

Sa ju duket i përshtatshëm libri me të cilin jeni duke mësuar?			
Klasa	N	Mean	Std. Deviation
6	60	3.98	1.172
7	81	3.85	.760
8	150	3.69	.941
9	167	3.54	.923
Total	458	3.71	.949

Tabela 3. Testi ANOVA, për dallimet në vlerësimin e librit nga nxënësit e shkollës së mesme të ulët

ANOVA

Sa ju duket i përshtatshëm libri me të cilin jeni duke mësuar?					
	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	10.695	3	3.565	4.041	.007
Within Groups	400.512	454	.882		
Total	411.207	457			

Tabela 4. Rezultatet e mësimdhënësve për përshtatshmërinë e teksteve shkollore

Përshtatshmëria e teksteve shkollore

Shumë i përshtatshëm	25%
I përshtatshëm	50%
Deri diku i përshtatshëm	25%

Detyrat në tekstin aktual të TIK-ut

Nëse e analizojmë figurën nr. 5, vërejmë se 12.4% e nxënësve janë shprehur se teksti që janë duke e përdorur ofron shumë pak detyra praktike, 65.1% e

tyre janë shprehur se deri diku ofron detyra praktike, ndërsa 22.5% janë shprehur se teksti aktual ofron shumë detyra praktike.

Në bazë të krahasimit të rezultateve të paraqitura në tabelën nr. 5, vërejmë se në përgjithësi në klasat ku është organizuar hulumtimi mesataret janë të afërta. Mesataren më të ulët e kanë dhënë nxënësit e klasave të 7-ta dhe të 9-ta, $M=2.05$, ndërsa mesatarja e rezultateve të nxënësve të klasës së 6-të, $M=2.12$, ndërsa mesatarja e rezultateve për nxënësit e klasës së 8-të $M=2.18$.

Në bazë të rezultateve të testit ANOVA, vërejmë se dallimet në mes të rezultateve të nxënësve të klasave 6-9 nuk kanë rëndësi statistikore. Pavarësisht se nxënësit e këtyre klasave kishin vlerësim të ndryshëm për tekstet e klasave respektive, këto dallime nuk paraqesin ndonjë rëndësi statistikore.




Figura 5. Detyrat praktike në tekstin aktual

Tabela 5. Krahasimi i mesatareve në bazë të klasave për detyrat praktike në tekste

A ofron detyra praktike teksti që jeni duke e shfrytëzuar?			
	N	Mean	Std. Deviation
6	60	2.12	.454
7	81	2.05	.610
8	150	2.18	.580
9	167	2.05	.609
Total	458	2.10	.583

Tabela 6. Testi ANOVA, lidhur me detyrat në tekst

ANOVA					
	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	1.637	3	.546	1.612	.186
Within Groups	153.743	454	.339		
Total	155.380	457			

Shfrytëzimi i teknologjisë për arritjen e rezultateve

Në bazë të rezultateve të paraqitura në tabelën 7, vërejmë se 12.5% e mësimitdhënësve mendojnë se nxënësit shumë shpesh e shfrytëzojnë teknologjinë për arritjen e rezultateve në mësim, 56.2% e tyre mendojnë se nxënësit e tyre shpesh e shfrytëzojnë teknologjinë për arritjen e rezultateve, 31.3% mendojnë se nxënësit herë pas here e shfrytëzojnë teknologjinë për arritjen e rezultateve.

Rreth 23.6% e nxënësve të shkollës së mesme të ulët janë shprehur se shumë shpesh e shfrytëzojnë teknologjinë për të arritur rezultate në mësim, 43% e tyre shpesh e shfrytëzojnë, 23.1% e shfrytëzojnë herë pas here, 7% e nxënësve e shfrytëzojnë rrallë, ndërsa 3.3% e nxënësve pothuajse nuk e shfrytëzojnë fare teknologjinë për të arritur rezultate në mësim.

Në bazë të rezultateve të paraqitura në tabelën nr. 6, vërejmë se mesataren më të lartë për shfrytëzimin e teknologjisë për arritjen e rezultateve në mësim e kanë nxënësit e klasës së gjashtë, $M=4.02$, pastaj ata të klasës së shtatë, $M=3.86$, nxënësit e klasës së nëntë, $M=3.74$, ndërsa mesataren më të ulët e kanë nxënësit e klasës së tetë, $M=3.65$. Në bazë të këtyre gjetjeve, rezulton se nxënësit e klasës së gjashtë, më së shumti e shfrytëzojnë teknologjinë për arritjen e rezultateve në mësim, ndërsa nxënësit që më së paku e shfrytëzojnë janë nxënësit e klasës së tetë, mirëpo, në bazë të testit ANOVA, këto dallime nuk janë të rëndësishme statistikisht, pasi që $p=0.074 < 0.05$.

Tabela 7. Rezultatet e mësimdhënësve për shfrytëzimin e teknologjisë nga ana e nxënësve

Shfrytëzimi i teknologjisë për arritjen e rezultateve	
Shumë shpesh	12.5%
Shpesh	56.2%
Herë pas here	31.3%



Figura 6. Shfrytëzimi i teknologjisë nga nxënësit për arritjen e rezultateve në mësim

Tabela 8. Krahasimi i rezultateve të nxënësve të shkollës së mesme të ulët, lidhur me shfrytëzimin e teknologjisë për arritjen e rezultateve në mësim

Sa e shfrytëzoni teknologjinë për të arritur rezultate në mësim?			
	N	Mean	Std. Deviation
6	60	4.02	.854
7	81	3.86	.848
8	150	3.65	1.088
9	167	3.74	1.007
Total	458	3.77	.995

Tabela 9. Testi ANOVA, lidhur me shfrytëzimin e teknologjisë nga nxënësit për arritjen e rezultateve në mësim

ANOVA

Sa e shfrytëzoni teknologjinë për të arritur rezultate në mësim?

	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	6.832	3	2.277	2.323	.074
Within Groups	445.170	454	.981		
Total	452.002	457			

Vlerësimi në Lëndën e TIK-ut

Rreth 83.6% e nxënësve të shkollës së mesme të ulët janë shprehur se vlerësimi në Lëndën e Teknologjisë me TIK bëhet me anë të testeve, 10.7% ia shtojnë edhe listën e kontrollit, 0.2% e tyre janë shprehur se vlerësohen edhe me portfolio, 0.2% janë shprehur se vlerësimi në Lëndën e TIK-ut bëhet edhe me anë të portfolios elektronike, ndërsa 5.2% janë shprehur se vlerësimi i tyre bëhet edhe me anë të formave të tjera.




Figura 7. Vlerësimi në lëndën e TIK-ut

Për dallim prej nxënësve, shumica e mësimitdhënësve janë shprehur se bëjnë kombinim të instrumenteve të vlerësimit dhe pjesa dërmuese e tyre kanë paraqitur këto forma si më të shpeshta:

Listë kontrolli, portfolio e nxënësit, portfolio elektronike.

Zbatimi i moduleve

Moduli: Këshillim dhe orientim në karrierë

Në bazë të rezultateve të paraqitura në figurën 8, vërejmë se 73% e nxënësve janë shprehur se nuk e mbajnë modulin Këshillimi dhe Orientimi në karrierë, ndërsa 27% e tyre janë shprehur se e mbajnë këtë modul.




Figura 8. Moduli për Këshillim dhe orientim në karrierë

Përmbushja e përmbajtjes së modulit Këshillim dhe orientim në karrierë dhe trendi me zhvillimet

Lidhur me këtë çështje, është parashtruar pyetje e hapur për nxënësit që kanë pohuar se e mbajnë modulin për Këshillim dhe orientim në karrierë. Nga 27 % e pjesëmarrësve që ishin përgjigjur se e mbajnë, shumica e tyre pohojnë se përmbajtja i përmbush kërkesat e tyre, është në trend me zhvillimet dhe u pëlqen. Ka disa raste kur nxënësit pohojnë se mbajnë shënim nga arsimitari për t'i plotësuar mangësitë, ose edhe prej atyre që nuk janë të kënaqur me përmbajtjen.

Moduli: Puna dhe edukimi në ndërmarrësi

Rreth 12% e nxënësve janë shprehur se e mbajnë modulën Puna dhe edukimi në ndërmarrësi, ndërsa 88% e tyre janë shprehur se nuk e mbajnë këtë modul.




Figura 9. Moduli Puna dhe edukimi në ndërmarrësi

Përmbushja e përmbajtjes së modulit Puna dhe edukimi në ndërmarrësi dhe trendi me zhvillimet

Lidhur me këtë çështje, është parashtruar pyetje e hapur për nxënësit që kanë pohuar se e mbajnë modulën Puna dhe edukimi në ndërmarrësi.

Nga 12% i nxënësve që janë shprehur se e mbajnë modulën Puna dhe edukimi në ndërmarrësi, shumica e tyre nuk kanë dhënë përgjigje, një numër i vogël i tyre janë shprehur se moduli është në trend me zhvillimet dhe përmbajtja përmbush nevojat e tyre. Nuk ka pasur ndonjë vërejtje.

Moduli: Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

Rreth 10% e nxënësve pjesëmarrës në hulumtim janë shprehur se e mbajnë modulën për Edukim dhe zhvillim të qëndrueshëm, ndërsa 90% janë shprehur se nuk e mbajnë këtë modul.




Figura 10. Moduli Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

Përmbushja e përmbajtjes së modulit Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe trendi me zhvillimet

Lidhur me këtë çështje, është parashtruar pyetje e hapur për nxënësit që kanë pohuar se e mbajnë modulin Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Nga 10 % e pjesëmarrësve që ishin përgjigjur se e mbajnë këtë modul, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk ka dhënë fare përgjigje në pyetjen e hapur, ndërsa pjesa që ka dhënë përgjigje (rreth gjysma e 10%) pohojnë se përmbajtja i përmbush mjaft nevojat e tyre dhe është në trend me zhvillimet. Nuk kishte raste që japin vërejtje për këtë modul.

Realizimi i moduleve sipas mësimdhënësve

Për të ditur realizimin e moduleve në lëndën Teknologji me TIK, janë anketuar mësimdhënësit e kësaj lënde, të cilët janë kompetentë dhe përgjegjës për zbatimin e këtyre moduleve.

Moduli: Për Këshillim dhe orientim në karrierë

18.8% e mësimdhënësve kanë pohuar se e kanë zbatuar plotësisht modulin Këshillimi dhe orientimi në karrierë, 37.5% e tyre janë shprehur se shumë e

kanë zbatuar këtë modul, 37.5% janë shprehur se mesatarisht e kanë zbatuar këtë modul, ndërsa 6.2% e mësimdhënësve janë shprehur se aspak nuk e kanë zbatuar.




Figura 11. Realizimi i modulit Këshillim dhe orientim në karrierë

Moduli: Puna dhe edukimi në ndërmarrësi

Vetëm 6.2% e mësimdhënësve janë shprehur se aspak nuk e kanë zbatuar modulën Puna dhe edukimi në ndërmarrësi, 68.8% e tyre janë shprehur se mesatarisht e kanë zbatuar këtë modul, 12.5% e mësimdhënësve janë shprehur se shumë e kanë zbatuar, ndërsa 12.5% e mësimdhënësve janë shprehur se plotësisht e kanë zbatuar.




Figura 12. Zbatimi i modulit Puna dhe edukimi për ndërmarrësi

Moduli: Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

Vetëm 6.3% e mësimeve janë shprehur se plotësisht e kanë zbatuar modul Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, 18.7% e tyre janë shprehur se shumë e kanë zbatuar, 37.5% e mësimeve pohojnë se mesatarisht e kanë zbatuar modul në fjalë, 6.2% janë shprehur se pak e kanë zbatuar këtë modul dhe 31.3% e mësimeve janë shprehur se aspak nuk e kanë zbatuar modul Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm.




Figura 13. Moduli Edukim për zhvillim të qëndrueshëm

Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë

47.6% e nxënësve janë shprehur se për orientim në karrierë të tyre u tregojnë mësimdhënësit, 45% e tyre janë shprehur se për orientim në karrierë u tregojnë prindërit, 2.2% pohojnë se u tregojnë të afërmit, 0.2% pohojnë se u tregojnë pedagogu/psikologu i shkollës dhe 5% janë shprehur se dikush tjetër u tregon për shkollimin e mëtutjeshëm të tyre dhe orientimin në karrierë.

Tabela 10. Këshillimi dhe orientimi në karrierë

Kush ju këshillon se në cilën fushë duhet të orientoheni për karrierë?	
	Percent
Mësimdhënësit	47.6%
Prindërit	45.0%
Të afërmit e mi	2.2%
Pedagogu/psikologu i shkollës	0.2%
Dikush tjetër, kush:	5.0%
Total	100.0%

Faktorët që duhet të merren për bazë për orientim të drejtë në karrierë

44.8% e nxënësve pohojnë se rezultatet në mësim janë faktori përcaktues për orientim të drejtë në shkollim, 41% pohojnë se zgjedhja e tyre është përcaktuese për orientim të drejtë në shkollim, 5.2 % mendojnë se zgjedhja e prindërve është përcaktues, 2.8% mendojnë se opinioni i mësimdhënësve është përcaktues, 2% e lidhin afërsinë e shkollës me orientimin e drejtë në shkollim, 0.7% mendojnë se kostoja e shkollimit është përcaktuese, ndërsa 3.5% e nxënësve orientimin e drejtë në shkollim e lidhin me fitimin (të ardhurat) nga profesioni i ardhshëm.

Tabela 11. Faktorët që duhet të merren për bazë për orientim të drejtë në karrierë

Sipas jush, çka duhet të merrni parasysh për orientim të drejtë në karrierë?	
	Percent
Rezultatet në mësim	44.8%
Zgjedhja ime	41.0%
Zgjedhja e prindërve	5.2%
Opinionit i mësimdhënësve	2.8%
Afërsia e shkollës	2.0%
Kostoja (çmimi) e shkollimit	0.7%
Fitimi (të ardhurat)	3.5%
Total	100.0%

Sugjerime dhe komente shtesë lidhur me lëndën e Teknologjisë me TIK

Në këtë pjesë janë marrë për bazë sugjerimet dhe komentet e nxënësve dhe mësimdhënësve.

Sugjerime dhe komente shtesë nga nxënësit lidhur me lëndën Teknologji me TIK

Lidhur me sugjerimet e kërkuara, janë vetëm një numër i vogël i nxënësve që kanë dhënë sugjerime.

Disa nga sugjerimet janë:

- Tekstet duhet të jenë më të përshtatshme;
- Të kenë kabinete të teknologjisë, të pajisura me kompjuterë;
- Të mbajnë më shumë orë praktike;
- Të kenë më shumë mësim për gjuhët programore;
- Kabineti të pajiset edhe me mjete të tjera teknologjike (laptop, projektor, tabela digjitale etj);
- Mundësi për të krijuar website;

Sugjerime dhe komente shtesë nga mësimmhënësit lidhur me lëndën e Teknologjisë me TIK:

- Të ketë më shumë ushtrime, shembuj dhe detyra të shtëpisë;
- Shkolla të ketë kabinet të informatikës dhe të pajiset me kompjuterë ose laptopë, tabela të mençura;
- Të vendoset/instalohet rrjeti i internetit në kabinetin e TIK-ut;
- Literatura të jetë më e përshtatshme për klasat 6, 7, 8 dhe 9 dhe shtëpia botuese të përzgjidhet me shumë kujdes. Në tekste ka mungesë të praktikës dhe vlerësimit të shkathtësive të nxënësve;
- Të bëhet përmirësimi i gabimeve teknike në tekst, largimi i informatave të vjetra, sepse teknologjia ka përparuar;
- Funksionalizimi i punëtorive dhe pajisja e tyre me vegla dhe materiale për punë praktike për realizimin e temave: Shkathtësitë e dizajnit dhe punimeve praktike me materiale nga druri, plastika, metalet etj;
- Të bëhen ndryshime kurrikulare dhe lënda e Teknologjisë me TIK-un të ndahet në aspektin profesional, sipas orëve praktike dhe teorike me një fond shtesë të orëve, 74 orë për teknologjinë dhe 74 orë për TIK-un në vit, pra praktikisht ndarje në dy lëndë.

PËRFUNDIME

Duke nxjerrë një rezultat të përgjithshëm për 23 veprime që lidhen me përdorimin e teknologjisë, u gjet se rreth 68.7% e nxënësve e përdorin teknologjinë për kryerjen e detyrave dhe veprimeve të ndryshme, duke përdorur aplikacione të ndryshme për qëllime të ndryshme, ndërsa 31.3% e nxënësve nuk e përdorin teknologjinë për këto qëllime.

Lidhur me vështirësitë në lëndën Teknologji me TIK, rreth 88% e nxënësve u shprehën se nuk kanë vështirësi, kurse për pjesën që u paraqitën se kanë vështirësi u theksua se libri është i komplikuar, apo edhe mungesa e kabineteve dhe kompjuterëve.

Sa i përket përshtatshmërisë së librit të lëndës Teknologji me TIK, rreth 8.6% e nxënësve kanë qëndrim negativ, 29.3% qëndrim neutral dhe 62.3% kanë qëndrim pozitiv. Lidhur me këtë çështje, u gjet se nxënësit e klasës së nëntë janë më pak të kënaqur me tekstin e lëndës Teknologji me TIK, $M=3.54$, ndërsa nxënësit më të kënaqur janë nxënësit e klasës së gjashtë, $M=3.98$

Në përgjithësi vërejmë një mosrealizim të moduleve nga ana e mësimeve, pasi që vetëm 18.8% e mësimeve kanë pohuar se e kanë zbatuar modulën Këshillim dhe orientim në karrierë, vetëm 12.5% e mësimeve janë shprehur se plotësisht e kanë realizuar modulën Puna dhe edukimi në ndërmarrësi, ndërsa vetëm 6.3% e mësimeve janë shprehur se plotësisht e kanë zbatuar modulën Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, ndërsa 31.3% e mësimeve janë shprehur se aspak nuk e kanë zbatuar modulën Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Sa i përket lëndës Teknologji me TIK, e cila përfshin modulet: TIK, Këshillim dhe orientim në karrierë, Puna dhe edukimi në ndërmarrësi, Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, sipas nxënësve, por edhe mësimeve. Përveç TIK-ut, këto module nuk janë realizuar plotësisht në kuadër të lëndës, janë zhvilluar pjesërisht apo është përzgjedhur vetëm ndonjëri nga modulet. Ndërsa, për modulet e mbajtura, nxënësit kanë deklaruar se moduli i TIK-ut ka nevojë të plotësohet me programe më të avancuara, kurse përmbajtjet e moduleve të tjera i përmbushin nevojat e tyre dhe se janë në trend me kohën.

Rezultatet treguan se, në përgjithësi, modulet e lëndës Teknologji me TIK nuk janë zbatuar sa duhet, andaj nuk i përmbushin nevojat e nxënësve të shkollës së mesme të ulët.

Përveç instrumenteve të plotësuara, ekipi i hulumtuesve ka marrë edhe disa informata shtesë, të nevojshme për këtë hulumtim:

- Disa nxënës, në disa klasa, kryesisht të klasave 8 dhe 9, janë deklaruar se programet e TIK-ut janë shumë të thjeshta, nuk i përmbushin nevojat dhe mundësitë e tyre dhe se kanë nevojë të mësojnë programe më të avancuara;

- Vetëm në një shkollë ekipi e ka verifikuar funksionimin e kabinetit të pajisur me kompjuterë dhe laptopë funksionalë, rrjet të internetit dhe, sipas deklaramit të nxënësve, të gjithëve u mundësohet qasja dhe përdorimi i tyre. Ndërsa në shkollat e tjera nuk ka hapësirë për kabinet apo nuk mirëmbahen dhe nuk funksionojnë kompjuterët, ose nga numri i madh i klasave dhe nxënësve shumë rrallë, apo ndonjëherë, u vjen radha të shfrytëzojnë kabinetin e informatikës.
- Është e nevojshme që të bëhen ndryshime kurrikulare dhe lënda e Teknologjisë me TIK-un të ndahet në aspektin profesional, sipas orëve praktike dhe teorike, me një fond shtesë të orëve, 74 orë për Teknologjinë dhe 74 orë për TIK-un në një vit shkollor.
- Mungojnë Kabinetet/punëtoritë për modulet e tjera.

REKOMANDIME

Me qëllim të tejkalimit të vështirësive dhe realizimit të kurrikulës lëndore, të lëndës Teknologji me TIK, rekomandohet që:

- MASHTI t'i rishikojë tekstet shkollore të lëndës Teknologji me TIK;
- Shtëpitë botuese të hartojnë tekste në përputhje me kurrikulën, me përmbajtje dhe detyra të qarta;
- Mësimdhënësit t'i zbatojnë modulet lëndore për lëndën Teknologji me TIK në pajtim me kërkesat e kurrikulave lëndore të klasave përkatëse;
- Të funksionalizohen kabinetet/punëtoritë dhe të pajisen shkollat me materiale dhe mjete teknologjike, me qëllim të realizimit të detyrave praktike me nxënës.

Bibliography

- Cohen, L., Lawrence, M.& Marrison K. . (2007). *Research Methods in Education, sixth edition*. London and New York : Routledge/Falmer.
- Department of School Education and Literacy Ministry of Human Resource Development Government of India. (2012). *National Policy on Information and Communication Technology (ICT) In School Education*. Department of School Education and Literacy Ministry of Human Resource Development Government of India.
- Ghavifekr, S. & Rosdy, W.A.W. . (2015). Teaching and learning with technology: Effectiveness of ICT integration in schools. *International Journal of Research in Education and Science (IJRES)*, 1 (2), 175-191.
- Grabe, M.&Grabe, C. . (2007). *Integrating technology for meaningful learning (5th ed.)* . Boston: MA: Houghton Mifflin.
- MAShT. (2016a). *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar)*. Prishtinë: MAShT.
- MAShT. (2016b). *Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës (Klasa VI, VII, VIII dhe IX), e rishikuar*. Prishtinë: MAShT.
- MAShT. (2018a). *Kurrikulat lëndore/programet mësimore, klasa e gjashtë*. Prishtinë: MAShT.
- MAShT. (2018b). *Kurrikulat lëndore/programet mësimore, Klasa e shtatë*. Prishtinë: MAShT.
- MAShT. (2019). *Kurrikulat lëndore/programet mësimore, klasa e tetë*. Prishtinë: MAShT.
- MAShT. (2020). *Kurrikulat lëndore/programet mësimore, klasa e nëntë*. Prishtinë: MAShT.
- MAShTI&ASK. (2022). *Statistikat e arsimit në Kosovë 2021/2022*. Prishtinë: MAShTI&ASK.

PRAKTIKAT E MËSIMDHËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR NË PËRGATITJEN E MATERIALEVE MËSIMORE

Lirije Bytyqi-Beqiri
Instituti Pedagogjik i Kosovës
Email: lirije.bytyqi@rks-gov.net

Abstrakt

Ky raport studimi përmban të dhëna lidhur me përgatitjen e materialeve mësimore në klasë, të cilat mbështesin mësimdhënien. Pjesa e parë e raportit përmban analizën teorike të dokumentacioneve zyrtare, si ligjit, kurrikulës bërthamë, kurrikulave lëndore, dhe studime të autorëve të ndryshëm lidhur me rolin dhe rëndësinë e materialeve mësimore në procesin mësimor, ndërsa në pjesën e dytë paraqesim perceptimet e nxënësve dhe mësimdhënësve të arsimit fillor, opinionet e tyre, lidhur me përgatitjen e materialeve mësimore për të mbështetur mësimdhënien dhe nxënien.

Qëllimi i studimit është të paraqesim praktikat e mësimdhënësve në përgatitjen e materialeve mësimore, mundësitë dhe sfidat e tyre, si dhe të identifikojmë nivelin e përfshirjes së nxënësve në përgatitjen e materialeve mësimore.

Për realizimin e këtij studimi, ishte e nevojshme të hartohet një pyetësor për të mbledhur të dhëna nga mësimdhënësit në shërbim. Pjesëmarrës në studim janë 380 mësimdhënës të arsimit fillor.

Për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit realizuam intervista me 17 nxënës, ndërsa për evidentimin e të dhënave nga intervista krijuam instrument të veçantë, tabelë që përmban të dhëna që lidhen me qëllimin e hulumtimit.

Rezultatet e dala nga hulumtimi ofrojnë të dhëna për mundësitë, sfidat dhe praktikat e mësimdhënësve për zhvillimin e materialeve mësimore dhe përfshirjen e nxënësve në hartimin e tyre.

Gjetjet e studimit tregojnë se mësimdhënësit nuk kanë kushte të mjaftueshme për përgatitjen e materialeve mësimore. Edhe pse mësimdhënësit përgatisin materiale mësimore, të cilat i përdorin gjatë punës me nxënësit në klasë, përfshirja e nxënësve në përgatitjen e materialeve është shumë e vogël. Edhe nxënësit, edhe mësimdhënësit materialet mësimore i përgatisin në shtëpi. Nxënësit materialet mësimore, si ilustrime, figura të ndryshme, prezantime, i përgatisin në kuadër të detyrave të shtëpisë dhe për përgatitjen e tyre shfrytëzojnë buxhetin dhe ndihmën e familjes. Gjetjet e hulumtimit argumentojnë mjaftueshëm nevojën e hartimit të moduleve të trajnimit për mësimdhënës, për përgatitjen dhe përdorimin e materialeve mësimore.

Fjalët çelës: materiale mësimore, mësimdhënës, mësimdhënie, përgatitje, praktika.

Practices of Primary School Teachers in the Preparation of Teaching Materials

Lirije Bytyqi-Beqiri

Abstract

This research report contains data related to the preparation of teaching materials in the classroom to support instruction. The first part of the report includes a theoretical analysis of official documentation such as laws, basic curriculum, subject curricula, and studies by various authors regarding the role and importance of teaching materials in the instructional process. In the second part, we present the perceptions of elementary school students and teachers, their opinions on the preparation of teaching materials to support teaching and learning.

The study aims to present the practices of teachers in preparing teaching materials, their opportunities and challenges, and to identify the level of student involvement in the preparation of teaching materials.

To conduct this study, it was necessary to develop a questionnaire to gather data from serving teachers. The participants in the study are 380 elementary school teachers. For data collection from students, we conducted interviews with 17 students, and to record the interview data, we created a specific instrument, a table containing information related to the research purpose.

The results of the research provide data on the opportunities, challenges, and practices of teachers for developing teaching materials and involving students in their creation. The findings of the study indicate that teachers do not have sufficient conditions for preparing teaching materials. Although teachers prepare teaching materials for use in class with students, the involvement of students in the preparation of materials is very limited. Both students and teachers prepare teaching materials at home. Students prepare materials such as illustrations, various figures, presentations as part of homework, utilizing their budget and family assistance for their preparation. The research findings sufficiently argue for the need for the development of training modules for teachers in the preparation and use of teaching materials.

Keywords: instructional materials, teacher, teaching, preparation, practices.

Hyrje

Mësimdhënia si proces është mjaft komplekse, ngase kërkon angazhim, përkushtim, interaktivitet, kreativitet edhe nga ana e mësimdhënësve, por edhe nga ana e nxënësve. Materialet mësimore janë mjaft të rëndësishme për lehtësimin, konkretizimin, kreativitetin dhe atraktivitetin në mësimdhënie dhe nxënie. Ato planifikohen nga mësimdhënësi, përgatiten nga mësimdhënësi, apo në bashkëpunim me nxënësit, ndërsa zbatohen/ përdoren me nxënësit.

Ky studim rrjedh si prioritet i dalë nga studimet paraprake dhe, sipas studimit, planifikimi dhe përdorimi i burimeve, mjeteve e materialeve mësimore nga mësimdhënësit e arsimit fillor (Beqiri, 2022), del se lista e mjeteve e materialeve mësimore është mjaft e shkurtër dhe kufizohet në mjete e materiale të gatshme.

Përmes studimit, synojmë të mbledhim të dhëna nga mësimdhënësit për praktikën e mësimdhënësve, si dhe sfidat dhe mundësitë e tyre në përgatitjen e materialeve mësimore.

Organizimi i këtij raporti të studimit përfshin kontekstin teorik, udhëzimet e dhëna për mësimdhënësit në dokumentet zyrtare, analizën e studimeve të tjera lidhur me zhvillimin e materialeve mësimore, analizën e të dhënave të mbledhura nga mësimdhënësit lidhur me praktikën e mësimdhënësve, mundësitë dhe sfidat e tyre në përgatitjen e materialeve mësimore.

Shqyrtimi i literaturës

Mësimdhënësit kanë rol të shumëfishtë në procesin mësimor. Ata ndihmojnë nxënësit të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe shprehje përmes një procesi të organizuar e planifikuar, siç është mësimdhënia. Mësimdhënësi planifikon dhe organizon procesin edukativ dhe arsimor në përputhje me përmbajtjen, grupin e nxënësve, hapësirën dhe materialet që ka në dispozicion. Mjetet dhe materialet mësimore kanë një rol të veçantë në lehtësimin dhe efektivitetin e mësimdhënies. Mësimdhënësit përdorin mjete e teknika të ndryshme për

ta bërë mësimin më tërheqës, më të kapshëm dhe më cilësor. Mjetet e materialet kanë rol të dyfishtë: ndihmojnë mësimdhënësit për mësimdhënie dhe njëkohësisht ndihmojnë edhe nxënësit në nxënie. Sipas autorit Shefik Osmani, "përdorimi i mjeteve mësimore, sipas rastit, mund të jetë në funksion të lehtësimit të procesit të të mësuarit nga ana e nxënësve, të shkurtimit të kohës së nevojshme për perceptimin e vetëdijshëm të një materiali, të sigurimit të një pune më efektive nga ana e mësuesit dhe e nxënësve, të mënjanimin të formave verbale e libeske, të krijimit të kushteve për rezultate optimale në punën mësimore-edukative" (Osmani, 1983, f. 445). Duke i përdorur materialet mësimore, krijohet raport më i afërt dhe miqësor ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësit, krijohet klimë më miqësore, e cila ndihmon ndjeshëm në mësim.

Nxënësit kanë nevojë për materiale të ndryshme, të cilat ndihmojnë dhe lehtësojnë procesin e mësimnxënies, krijimin e shprehive e shkathtësive për punë të pavarur. Zbatimi dhe përdorimi i tyre mundëson një shkallë më të lartë të stimulimit të aktivitetit të nxënësve dhe ngritjen e efikasitetit të punës mësimore të nxënësve dhe mësimdhënësve (Zylfiu, 2005).

Në Ligjin për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik mjetet mësimore janë mjetet e ndryshme teknike, modelet, objektet natyrore, materialet grafike, hartat gjeografike etj., të cilat shfrytëzohen si burime të njohurive dhe mundësojnë që nxënësi të kuptojë dukuritë natyrore dhe shoqërore: proceset, objektet etj." (MASHT, 2006, f. 1), ndërsa material është çdo send që përdoret si lëndë e parë për të prodhuar a për të ndërtuar diçka, ose si mjet për qëllime të caktuara (fjale. al, 2023).

Kurrikula Bërthamë (MASHT, 2016) inkurajon mësimdhënësit që bashkë me nxënësit dhe bartësit tjerë të arsimit të hartojnë materiale të përshtatshme, si dhe jep udhëzime për materiale dhe burime mësimore për të shtatë fushat.

Kurrikulat lëndore udhëzojnë mësimdhënësit të përdorin mjete e materiale mësimore të cilat ndihmojnë arritjen e rezultateve dhe kompetencave për lëndët në klasat përkatëse dhe arritjen e rezultateve të kompetencave për shkallët e kurrikulës.

Kurrikulat lëndore për klasat përkatëse, për secilën lëndë mësimore, japin udhëzime për materiale dhe burime mësimore. Vetëm në disa lëndë dhe në klasë të caktuara, Kurrikula lëndore/programi mësimor në formë deklarate u bën me dije se mësimdhënësi mundet të krijojë materiale të ndryshme didaktike, të cilat ndihmojnë në arritjen e rezultateve të të nxënësve (MASH, 2021), ndërsa në lëndët e tjera sugjerojnë përdorimin e materialeve të gatshme, si: materiale tekstuale, vizuale, auditive-dëgjimore dhe audiovizuale.

Materialet, të cilat mund të përdorin mësimdhënësit për zhvillimin e materialeve mësimore, janë të ndryshme. Ato mund të jenë materiale natyrore, si: dru, gurë, dhe, ujë, bimë etj., por edhe materiale tjera, si: letër, plastikë, qelq, hekur etj., të cilat përdoren si lëndë e parë për zhvillimin e materialeve.

Materialet mësimore, të cilat mund të zhvillohen nga mësimdhënësit, studiuesi Lalit Kishore i klasifikon në tri grupe:

- Materiale për mësimdhënie: piktura, postera, grafikë, filma, video, prezantime në Power Point, materiale të printuara, modele, kukulla, maska etj.
- Materiale për mësimnxënie: fleta pune, fletat e aktiviteteve, materiale plotësues, materiale referuese, lojëra etj.
- Materiale për mësimdhënie dh nxënie: libra shkollorë, libra pune, CD etj. (Edu, 2022).

Të gjitha materialet mësimore kanë për qëllim të ndihmojnë të mësuarit e nxënësve. Që materialet të mbështesin të mësuarit e nxënësve, ato duhet të jenë tërheqëse, shumëngjyrëshe, të kenë veti të cilat i joshin nxënësve. Përdorimi i tyre do të ndihmojë në paraqitjen e ideve të reja të nxënësve. Shfrytëzimi i duhur e bën materialin pozitiv ose negativ. Materialet, si zare, shkopinj, mermer, forma 3D, karta etj., mund të kenë përdorime të shumta, prandaj janë të njohura si materiale mësimore në shkolla (Edu, 2022).

Studimi Zhvillimi i materialeve mësimore për qëllimet specifike (Tomlinson, 2001) jep udhëzime për mësimdhënësit për të zhvilluar materiale mësimore. Sipas tij, materialet që zhvillojnë mësimdhënësit duhet

të kenë ndikim, efekt të dukshëm te nxënësit, të ndihmojnë nxënësit të ndihen të qetë, të zhvillojnë vetëbesimin e nxënësve, të lehtësojnë mësimnxënien dhe të tërheqin vëmendjen e nxënësve, të përshtaten për stilet e ndryshme të të nxënit, të ofrojnë mundësi për informata kthyesë, reagime ndaj rezultateve etj (Tomlinson, 2001).

Sipas tij, hapat ose procedurat e zhvillimit të materialeve përfshijnë hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e materialeve mësimore. Materialet e hartuara zbatohen në situatat reale dhe aty vlerësohen nëse ato janë të përshtatshme ose jo për nxënësit e synuar.

Pyetja e hulumtimit

Pyetja kryesore me të cilën udhëhoqëm hulumtimin është:

- *Cilat janë praktikat e mësimdhënësve të arsimit fillor për përgatitjen e materialeve mësimore?*

Ndërsa nënpyetje plotësuese, të cilat ndihmojnë hulumtimin, janë:

- Çfarë materialesh përgatisin mësimdhënësit e arsimit fillor?
- Cilat janë kriteret që mësimdhënësit i marrin parasysh gjatë përgatitjes së materialeve mësimore?
- Sa përfshihen nxënësit në përgatitjen e materialeve mësimore?
- Cilat janë mundësitë dhe sfidat e mësimdhënësve në përgatitjen e materialeve mësimore?

METODOLOGJIA

Modeli i hulumtimit

Hulumtimi është përshkruar dhe ka qasje të përzier. Përmes pyetësorëve mblodhëm të dhëna statistikore - të dhëna sasiore, ndërsa të dhënat cilësore i morëm përmes intervistave të realizuara me nxënës.

Popullacioni dhe mostra

Popullacioni i hulumtimit janë të gjithë mësimitdhënësit dhe nxënësit e arsimit fillor, ndërsa për mostër përzgjedhëm 5% të popullacionit të mësimitdhënësve, që i bie 384 mësimitdhënës të arsimit fillor, në nëntë komuna në Republikën e Kosovës. Mostra është përzgjedhur mbi bazën e kërkesave për madhësinë e mostrës (Required Sample Size, 2006) me koefidencë 95%.

Për mostër janë përzgjedhur mësimitdhënës të komunave të ndryshme, mësimitdhënës që punojnë në zona urbane dhe rurale, në të gjitha klasat e arsimit fillor, dhe mësimitdhënës të gjinive të ndryshme.

Tabela 1. Përfshirja e mësimitdhënësve sipas komunave dhe zonave ku punojnë

Komunat	Ferizaj	F. Kosovë	Gjakovë	Klinë	Malishevë	Mitrovicë	Pejë	Podujevë	Prishtinë	Gjithsej
Nr	34	51	32	21	41	62	36	46	61	384
%	8.9	13.3	8.3	5.5	10.7	16.1	9.4	12.0	15.9	100
Urban N	17	29	14	12	25	34	22	25	34	212
Rural N	17	22	18	9	16	28	14	21	27	172

Nga tabela 1 shohim se përfshirja e mësimitdhënësve ka qenë nga komuna të ndryshme, në zona urbane dhe rurale. Sa u përket komunave, shohim se numri më i madh i mësimitdhënësve të përfshirë janë nga Mitrovica dhe Prishtina, ndërsa numër më i vogël përfshihet nga komuna e Klinës. Ky dallim vjen për shkak të numrit të mësimitdhënësve të arsimit fillor në shkollat pjesëmarrëse në hulumtim, pra shkollat e Mitrovicës dhe Prishtinës kishin numër më të madh të mësimitdhënësve për dallim nga komunat e tjera. Dallime të tilla ndodhin edhe në karakteristika të tjera të mostrës së mësimitdhënësve, si p.sh. edhe sa i përket përfshirjes urbane dhe rurale ka dallime në mostrën e mësimitdhënësve, ngase numri më i madh vijnë nga zonat urbane, dhe kjo ndodh për shkak se shkollat e qytetit ishin më të mëdha dhe kanë numër më të madh të mësimitdhënësve.

U përfshinë mësimdhënës të të dy gjinive, të të gjitha klasave të arsimit fillor.

Tabela 2. Përfshirja e mësimdhënësve sipas gjinisë dhe klasave me të cilat punojnë

	Gjinia		Klasa me të cilën punojnë					Gjithsej
	M	F	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Klasa 4	Klasa 5	
Nr	54	330	49	109	95	41	90	384
%	14.1	85.9	12.8	28.4	24.7	10.7	23.4	100

Sa i përket përgatitjes shkollore, mësimdhënësit e përfshirë kishin të përfunduar fakultetin N=274 ose 71.4% e mësimdhënësve, ndërsa me gradën master/magjistër kemi N=110 ose 28.6% të mësimdhënësve. Mësimdhënësit kanë përvojë disavjeçare në mësimdhënie dhe prej tyre vetëm N=6 ose 1.6% ishin në fazën fillestare, pra 0 -1 vit përvojë pune në mësimdhënie, N=182 ose 47.4% e mësimdhënësve ishin me përvojë 2-10 vjet, N=112 ose 29.2% kanë përvojë 11-20 vjet, kurse N=84 ose 21.9 kanë përvojë mbi 20 vjet në mësimdhënie.

Numri i nxënësve në klasat me të cilat punojnë mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim është i ndryshëm dhe mesatarja e nxënësve në klasë është 24 nxënës.

Tabela 3. Të dhëna përshkruese për numrin e nxënësve në klasat me të cilat punojnë mësimdhënësit

	N	Minimum	Maximum	Mean
Numri i nxënësve në klasë:	384	10	42	23.81
Valid N (listwise)	384			

Në hulumtim u përfshinë edhe 17 nxënës të arsimit fillor. Meqë hulumtimi me nxënës u realizua përmes intervistave, përzgjedhëm 17 nxënës, 5 nxënës të klasës së tretë, 6 nxënës të klasës së katërt dhe 6 nxënës nga klasa e pestë.

Mosha e nxënësve të përfshirë në hulumtim ishte 8-11 vjet dhe prej tyre 9 ishin vajza kurse 8 ishin djem.

Instrumentet

Për mbledhjen e të dhënave përdorëm pyetësor dhe intervista të strukturuar.

Për mbledhjen e të dhënave nga mësimdhënësit përdorëm pyetësorë. Pyetësorët përfshijnë pyetje të tipit të mbyllur. Përmbajnë të dhëna demografike, si: mosha, gjinia, klasa, vendi; si dhe 9 pyetje përmes së cilave morëm informatat që janë në fokus të hulumtimit.

Mbledhjen e të dhënave nga nxënësit e realizuam përmes intervistave, fokusi i së cilave ishte pjesëmarrja e nxënësve në përgatitjen e materialeve mësimore, mundësitë dhe sfidat e tyre.

Procedura e mbledhjes së të dhënave

Të dhënat i mblodhëm në shkolla të caktuara, në komunat e sipërpërmendura. Paraprakisht kontaktuam me Drejtoritë Komunale të Arsimit në komunat përkatëse, të cilët na ndihmuan në përzgjedhjen e shkollave. Pastaj kontaktuam me drejtorët e shkollave për t'i informuar për hulumtimin dhe për të caktuar kohën e përshtatshme për realizimin e hulumtimit. Mësimdhënësit i mblodhëm në sallën e mësimdhënësve, i informuam për hulumtimin dhe pastaj shpërndamë pyetësorët. Pas plotësimit të pyetësorëve nga mësimdhënësit morëm planifikime vjetore, dymujore dhe përgatitje për orët mësimore, me qëllim të analizës së tyre.

Pas mbledhjes së të dhënave nga mësime të ndryshme në një ambient të përshtatshëm, klasë apo zyrë të qetë, i takuam nxënësit dhe i intervistuar të tre së bashku, duke shënuar përgjigjet e tyre në pyetjet e parashtruara.

Procedura e analizës së të dhënave

Të dhënat e mbledhura nga mësime të ndryshme i analizuar përmes programit kompjuterik SPSS (Statistical Package for the Social Science - pakoja Statistike për Shkencat Shoqërore). Të dhënat e hulumtimit i analizuar dhe i interpretuar si të përgjithshme.

Pyetësorët ishin anonimë, me qëllim të ruajtjes së konfidencialitetit të mësime të ndryshme të përfshirë në hulumtim.


Të dhënat e nxënësve i analizuar përmes analizës përshkuese, duke i analizuar të dhënat e mbledhura dhe duke i përshkruar ato.

REZULTATET

Rezultatet e hulumtimit i kemi orientuar në dy aspekte të rëndësishme, të cilat ishin edhe fokus i hulumtimit: përgatitja e materialeve mësimore nga mësime të ndryshme e arsimit fillor dhe përfshirja e nxënësve në përgatitjen e tyre.

Të dhënat e hulumtimit tregojnë se shumica e mësime të ndryshme nuk kanë marrë pjesë në asnjë formë të zhvillimit profesional që lidhet me zhvillimin e materialeve mësimore. Këtë të dhënë e siguroam përmes pyetjes së parashtruar mësime të ndryshme: A keni marrë pjesë në programe të trajnimit apo ndonjë formë tjetër të zhvillimit profesional që lidhet me zhvillimin e materialeve mësimore?

Kërkime Pedagogjike




Grafiku 1. Pjesëmarrja e mësimeve në formë të zhvillimit profesional që lidhet me zhvillimin e materialeve mësimore

Sa i përket përfshirjes apo pjesëmarrjes së mësimeve në trajnime apo forma të tjera të zhvillimit profesional të mësimeve, nga grafiku 1 shohim se vetëm 20.6% e mësimeve kanë marrë pjesë në programe trajnime apo formë tjetër të zhvillimit profesional që lidhet me zhvillimin e materialeve mësimore. Në pyetjen pasuese, se në çfarë forme kanë marrë informata dhe njohuri shtesë për zhvillimin e materialeve mësimore, mësimeve pohojnë se disa informata i kanë marrë në disa nga programet e trajnimit, si: ECDL, MKLSh, Krijimi i materialeve për shkencat e natyrës, trajnimet e mbajtura për kurrikulën etj.

Perceptimet e mësimeve të arsimit fillor për përgatitjen e materialeve mësimore

Në pyetjen e parashtruar mësimeve, se sa shpesh përgatisin materiale mësimore, të dhënat nga hulumtimi tregojnë se shumica e mësimeve përgatisin shpesh ose vazhdimisht përgatisin materiale mësimore.



Grafiku 2. Përgjigjet e mësimeve në pyetjen sa shpesh përgatisin materiale mësimore

Të dhënat nga grafiku tregojnë se shumica e mësimeve përgatisin shpesh materiale mësimore, e po ashtu disa prej tyre vazhdimisht përgatisin materiale mësimore.

Mësimeve përgatisin materiale në të gjitha lëndët mësimore, por, sipas të dhënave, shpeshësia e përgatitjes së materialeve në lëndë të ndryshme dallon nga lënda në lëndë.

Tabela në vazhdim tregon perceptimet e mësimeve lidhur me përgatitjen e materialeve mësimore në lëndë të ndryshme.

Kërkime Pedagogjike

Tabela 4. Shpeshësia e përgatitjes së materialeve nga mësimmhënësit në lëndë të ndryshme

Lëndët	Gjuhë Shqipe		Matematikë		Edukatë figurative		Edukatë muzikore		Njeriu dhe natyra		Shoqëria dhe mjedisi		Edukatë fizike sportt dhe shëndeti		Shkathtësi për jetë	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Asnjëherë	1	0.3	2	0.5	9	2.3	15	3.9	4	1.0	5	1.3	20	5.2	8	2.1
Rrallë	6	1.6	3	0.8	50	13.0	139	36.2	11	2.9	76	19.8	133	34.6	14	3.6
Nganjëherë	50	13.0	130	33.9	175	45.6	119	31.0	165	43.0	136	35.4	83	21.6	199	51.8
Shpesh	196	51.0	102	26.6	65	16.9	34	8.9	112	29.2	140	36.5	66	17.2	73	19.0
Vazhdimisht	131	34.1	147	38.3	85	22.1	77	20.1	92	24.0	27	7.0	82	21.4	90	23.4

Nga paraqitja tabelare shohim se fokusi i përgatitjes së materialeve nga ana e mësimit është në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë. Më së paku materiale shohim se mësimit përgatitjes në lëndët e shkathësive, sidomos në lëndët Edukatë muzikore dhe Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.


Materialet mësimore që i përgatitjes mësimit mësimit e arsimit fillor

Në pyetjen e parashtruar mësimit mësimit, se *çfarë materialesh mësimit përgatitjes*, kemi marrë përgjigje nga të gjithë mësimit mësimit. Mësimit mësimit pohojnë se përgatitjes materiale të ndryshme, si: posterë, video, filma, video, prezantime, fletëza mësimit të printuara në letër, modele, kukulla, maska, fleta pune, udhëzime për aktivitete, materiale plotësuese, materiale referuese, lojëra, figura gjeometrike, zare, karta, teste, ushtrime, ilustrime etj.

Por cilat nga këto materiale mësimit mësimit i përgatitjes më shpesh?

Të dhënat flasin për materiale të shumta, të cilat mësimit mësimit i përgatitjes në lëndë të ndryshme, e disa prej tyre duket se përgatitjes shumë shpesh. Siç shihet nga grafiku, këtë e pohojnë mbi 90% e mësimit mësimit, si: teste 99.2%, ushtrime (fleta pune për ushtrime) 98.7%, ilustrime 94.8% dhe figura gjeometrike 93.2%.

Materiale, të cilat përgatitjes më rrallë nga mësimit mësimit, pohohet të jenë maskat 4.9% dhe kukullat 9.9%. Vlen të theksohet se materialet e renditura janë marrë nga planifikimet e mësimit mësimit, përkatësisht nga lista e materialeve të cekura në përgatitjes e mësimit mësimit për orë mësimit.




Grafiku 3. Materialet të cilat mësimitdhënësit i përgatisin më shpesh

Kriteret që mësimitdhënësit i marrin parasysh gjatë përgatitjes së materialeve mësimore

Gjatë përgatitjes së materialeve mësimore, mësimitdhënësit marrin parasysh kriteret e ndryshme, si rezultatet, të cilat mund të arrihen me përdorimin e tyre, lëndën mësimore në të cilën përdoren ato materiale, moshën e nxënësve, gjininë e nxënësve, vendin ku përdoren, kohën kur përdoren, qëllimin për çfarë shërbejnë, sa janë atraktive për nxënësit, efektivitetin e tyre, përdorimin e ngjyrave, të nxisin kreativitetin të nxënësit. Të jenë të lehta për përdorim, të lehtësojnë nxënësin, të ndihmojnë nxënësit të ndihen të qetë, të zhvillojnë vetëbesimin e nxënësve, të tërheqin vëmendjen e nxënësve, të përshkruajnë me stilet e ndryshme të të nxënësit, të ofrojnë mundësi për informata kthyesë, të ndihmojnë në vlerësimin dhe vetëvlerësimin e nxënësve.

Nëse i rendisim sipas rëndësisë që i japin mësimitdhënësit, shohim se si kriteret, të cilat mësimitdhënësit i marrin më shpesh parasysh gjatë përgatitjes së materialeve mësimore, janë rezultatet mësimore, të cilat mund të arrihen përmes materialeve të përgatitura

Kërkime Pedagogjike



Grafiku 4. Kriteret që mësimdhënësit i marrin parasysh gjatë përgatitjes së materialeve mësimore

Shohim se kriteret që i marrin parasysh mësimdhënësit gjatë përgatitjes së materialeve mësimore, janë kritere mjaft të rëndësishme, të cilat ndihmojnë dhe lehtësojnë mësimdhënien dhe nxënien.

Mësimdhënësit shprehen të pakënaqur me materialet që posedon/ofron shkolla. Këtë e pohojnë N=373 ose 97% e mësimdhënësve.

Sipas tyre, përgjegjësinë për sigurimin e materialeve mësimore e kanë mësimdhënësit (N=345 ose 89.8%) dhe shkolla, përkatësisht menaxhmenti i saj (N=196 ose 51%). Vetëm N=9 ose 2.3% e mësimdhënësve mendojnë se nxënësit janë përgjegjës për sigurimin e materialeve mësimore.

Lidhur me sigurimin e materialeve mësimore, mësimdhënësit mendojnë se *"materialet mësimore duhet të sigurohen nga organet kompetente, sepse shpesh mësimdhënësit dhe prindërit paguajnë shuma të larta për sigurimin e materialeve. Shpesh në shkollë nuk e kemi as materialin bazë, siç janë letra e bardhë dhe ngjyra për fotokopje"* (m150).

Mësimdhënësit kërkojnë sigurimin e laptopëve, printerëve dhe projektorëve në shkollë. Ata bëjnë thirrje që *"çdo klasë të ketë letrat e bardha, projektorët statikë dhe printerët funksionalë për të mundësuar realizimin e përgatitjes dhe shfrytëzimit të materialeve."*

Përfshirja e nxënësve në përgatitjen e materialeve mësimore

Deklarimet e mësimdhënësve lidhur me përfshirjen e nxënësve në përgatitjen e materialeve mësimore janë të ndryshme:

- N=12 ose 3.1% pohojnë se nxënësit i përfshijnë gjithmonë në përgatitjen e materialeve mësimore;
- N=73 ose 19% pohojnë se nxënësit i përfshijnë shpesh në përgatitjen e materialeve mësimore;
- N=174 ose 45.3% e mësimdhënësve pohojnë se nxënësit nganjëherë përfshihen në përgatitjen e materialeve mësimore;

- N=104 ose 27.1% e mësimeve pohojnë se rrallë nxënësit i përfshijnë në përgatitjen e materialeve mësimore;
- N=21 ose 5.5% pohojnë se nxënësit nuk i përfshijnë asnjëherë në përgatitjen e materialeve mësimore.

Në pyetjen se a i angazhoni nxënësit në shtëpi për përgatitjen e materialeve mësimore, N=343 ose 89.3% e mësimeve pohojnë se nganjëherë edhe i angazhojnë nxënësit të përgatisin materiale mësimore dhe këtë e bëjnë në kuadër të detyrave të shtëpisë, duke i lidhur me temën të cilën e zhvillojnë.

Por cilat janë opinionet e nxënësve lidhur me përfshirjen e tyre në përgatitjen e materialeve mësimore?

Të gjithë nxënësit pohojnë se përgatisin materiale mësimore, por shumica prej tyre pohojnë se përgatisin rrallë materiale mësimore. Vetëm 2 prej nxënësve pohojnë se përgatisin shpesh materiale mësimore.

Nga materialet, të cilat nxënësit tregojnë se përgatisin materiale mësimore, janë hamera për ilustrime të ndryshme, flamurin e Kosovës për ditën e Pavarësisë me materiale të ndryshme, si argjila, pëlhura, dhe letra, tregime të ndryshme, vjersha të cilat i shkruajnë vetë, figura gjeometrike nga kartoni etj.

Materialet mësimore nxënësit i përgatisin për detyrë shtëpie dhe zakonisht ato i sjellin në shkollë, i prezantojnë para nxënësve dhe i vendosin në këndin e caktuar në klasë.

Nxënësit gjatë diskutimit theksuan edhe vështirësitë, të cilat i hasin gjatë përgatitjes së materialeve mësimore, si: koha e shkurtër që kanë në dispozicion për përgatitjen e tyre, gjetjen e materialeve të nevojshme.

"Vështirësi kemi shpesh, sepse nganjëherë nuk i kemi gjërat e nevojshme në shtëpi, duhet t'i blejmë ato e kur prindërit vijnë vonë ne nuk kemi si t'i bëjmë..."(n 4, klasa IV).

"Unë nuk di të vizatoj mirë, prandaj kur mësuesja kërkon që të bëjmë hamer, unë i lutem vëllait ose mamit të më ndihmojë ta bëj vizatimin tim..." (n2, klasa III).

Por nxënësit pohojnë se ndihen shumë mirë kur përgatisin materiale mësimore, sepse gjatë përgatitjes mësojnë më shumë, lexojnë më shumë për atë që punojnë dhe, gjithashtu, përgatiten më mirë kur kanë t'i prezantojnë ato.

Pasi që materialet i punojnë në shtëpi, shfrytëzojnë ndihmën e familjarëve, sepse ka raste kur ata edhe nuk mund t'i përgatisin vetë.

"Mua më ndihmon motra, sepse vetë nuk mundem" (n. 11, klasa V).

"Unë i bëjë vetë, sepse dua që gjërat e mia t'i bëjë vetë..."(n9, klasa V).

Sikurse nxënësit, edhe mësime dhënësit hasin në vështirësi të ndryshme gjatë përgatitjes së materialeve mësimore.

Mundësitë dhe sfidat e mësime dhënësave në përgatitjen e materialeve mësimore

Të dhënat e mbledhura nga mësime dhënësit tregojnë për mundësi të pakta për përgatitjen e materialeve mësimore nga mësime dhënësit në shkollë dhe për mundësinë e përfshirjes së nxënësve në përgatitjen e tyre.

Përgatitja e materialeve mësimore bashkë me nxënësit në klasë, sipas mësime dhënësave, është pothuajse e pamundur në kushtet që ofron shkolla. Mësime dhënësit bashkë me nxënësit në klasë mund të përgatisin materiale shumë të thjeshta, punime nga letra apo materiale që nxënësit i posedojnë në shtëpi. Sipas mësime dhënësave, nuk ka kushte e as mbështetje të mjaftueshme për ta.

Në pyetjen e parashtruar se sa drejtori dhe stafi tjetër i shkollës u mundëson, i inkurajon apo mbështet në zhvillimin e materialeve, kemi këto përgjigje: Asnjëherë N=40 ose 10.4%, Rrallë N=69 ose 18%, nganjëherë N=165 ose 43%, shpesh N=22 ose 5.7% dhe gjithmonë N=88 ose 22%. Të dhënat

tregojnë se mësimdhënësit nuk janë të kënaqur me mbështetjen që u ofrohet, por as me kushtet që ofron shkolla. Nga të dhënat e marra përmes pyetësorëve të realizuar me mësimdhënësit, del se 93% e mësimdhënëseve nuk kanë hapësira, mjete e pajisje, të cilat u mundësojnë atyre zhvillimin e materialeve mësimore në shkollë. Vetëm 7% e mësimdhënëseve pohojnë se kanë hapësira, mjete dhe kushte për përgatitjen e mjeteve e materialeve mësimore së bashku me nxënësit në shkollë.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përfundime

Materialet mësimore ndihmojnë nxënësit dhe mësimdhënësit në procesin mësimor. Nxënësit kanë nevojë për materiale mësimore për ta lehtësuar mësimnxënien, kurse mësimdhënësit përmes materialeve mësimore ofrojnë mësimdhënie atraktive, të kapshme dhe të përshtatshme për moshën e nxënësve.

Përveçqë ndihmojnë dhe lehtësojnë mësimnxënien, materialet mësimore ndihmojnë që në klasë të krijohet klimë miqësore që ndihmon ndjeshëm në mësim, ndihmojnë krijimin e shprehive e shkathtësive për punë të pavarur të nxënësve, si dhe rrisin ndjeshëm ndjenjën e kreativitetit të nxënësit dhe të mësimdhënësit.

Udhëzimet e dhëna në kurrikulat lëndore janë deklarata, të cilat u bëjnë me dije mësimdhënëseve se mund të krijojnë materiale didaktike, të cilat ndihmojnë arritjen e rezultateve të të nxënit, por nuk ka udhëzime të qarta rreth përgatitjes së materialeve mësimore.

Mësimdhënësit nuk kanë ndjekur trajnime apo forma të tjera specifike të zhvillimit profesional që kanë për qëllim ofrimin e mbështetjes së mësimdhënëseve në përgatitjen e materialeve mësimore, por ata kanë marrë pjesë në trajnime të tjera, të cilat tërthorazi ndonjëherë kanë diskutuar edhe rëndësinë e materialeve mësimore.

Në lëndë të ndryshme mësimdhënësit përgatisin materiale të ndryshme, por nga të dhënat e hulumtimit del se më shumë mësimdhënësit përgatisin teste, fleta pune, ilustrime, prezantime etj.

Gjatë përgatitjes së materialeve mësimore, mësimdhënësit marrin parasysh kritere të ndryshme, të cilat janë të rëndësishme për përdorimin e tyre. Si kritere më të rëndësishme, të cilat mësimdhënësit i marrin parasysh gjatë përgatitjes së materialeve mësimore, janë ndikimi i tyre në arritjen e rezultateve mësimore, lëndën mësimore në të cilën përdoren ato materiale, efektivitetin e tyre, kreativitetin që nxisin te nxënësit, lehtësinë për përdorim, zhvillimin e vetëbesimit të nxënësve, stilet e ndryshme të të nxënësve, mundësinë e ofrimit të informatave kthyesë etj.

Nxënësit shumë rrallë marrin pjesë në përgatitjen e materialeve mësimore në shkollë. Materialet mësimore nxënësit i përgatisin në shtëpi, në kuadër të detyrave të shtëpisë, të cilat i sjellin në shkollë, i prezantojnë para nxënësve dhe i vendosin në këndet e caktuara në klasë.

Si nxënësit ashtu edhe mësimdhënësit sfidohen në përgatitjen e materialeve mësimore. Për përgatitjen e materialeve mësimore nxënësit kanë nevojë për përkrahjen e familjarëve të tyre, ndërsa mësimdhënësit pohojnë se sfiduesë janë kushtet që ofron shkolla, si mungesa e mjeteve dhe materialeve të nevojshme.

Rekomandime

Nga rezultatet e dalja dhe përfundimet e lartcekura mund të dalim me disa rekomandime për aktorët, si:

Drejtoria Komunale e Arsimit të pajisë shkollat me teknologji mësimore si dhe t'i furnizojë ato me mjete e materiale të nevojshme, bazuar në nevojat dhe kërkesat e tyre;

Aktorët brenda shkollës: stafi menaxherial, mësimdhënësit dhe nxënësit, të bashkëpunojnë dhe të krijojnë materiale mësimore;

Për përgatitjen e materialeve mësimore mësimdhënësit të përdorin materiale ricikluese, materiale natyrore, duke i përshtatur ato, me qëllim të krijimit të mundësive të sigurimit më të lehtë të materialeve, zvogëlimit të kostos financiare, si dhe zhvillimit të kreativitetit të nxënësit.

Mësimdhënësit të planifikojnë aktivitete që kanë të bëjnë me përgatitjen e materialeve mësimore në klasë dhe të përfshijnë edhe nxënësit në përgatitjen e tyre.

REFERENCAT

- Beqiri, L. (2022). Planifikimi dhe përdorimi i burimeve, mjeteve e materialeve mësimore nga mësimdhënësit e arsimit fillor. *Kërkime Pedagogjike*, f. 339-358.
- Edu, T. L. (2022, 11 24). *leverageedu.com*. Retrieved from <https://leverageedu.com/blog/teaching-learning-material/>: <https://leverageedu.com/blog/teaching-learning-material/>
- IPK. (2016). *Kurrikula e bazuar në kompetenca, përvojat gjatë zbatimit, sfidat dhe mundësitë, si dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme të mësimdhënësve*. Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- IPK. (2016). *Udhëzues për udhëheqjen dhe zbatimin e Kurrikulës*. Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- MASh. (2021). *Kurrikulat lëndore/programet mësimore, klasa e pestë*. Prishtinë.
- MAShT. (2016). *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të republikës së Kosovës*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.
- MAShT. (2018). *Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitor dhe arsimin fillor në Kosovë*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.
- MAShT. (2018). *Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, klasa e dytë*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.
- MAShT. (2018). *Plani dhe programi mësimor, klasa 1*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.
- MAShT. (2019). *Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, klasa e tretë*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.

- MAShT. (2020). *Kurrikula lëndore/Programet mësimore, klasa e katërt*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.
- MAShT. (2021). *Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, klasa e psetë*. Prishtinë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.
- Osmani, S. (1983). *Fjalor i Pedagogjisë*. Tiranë: 8 Nëntori.
- Zylfiu, N. (2005). *Didaktika*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

Artikuj on-line:

- Materialet mësimore (Përzgjedhja dhe përgatitja e tyre), burimet mësimore.* (2022, 10 18). Retrieved from <https://text-id.123dok.com/document/6qme7654z-materialet-mesimore-perzgjedhja-dhe-pergatitja-e-tyre-burimet-mesimore-fusha-e-kurrikules-matematika-fusha-e-kurrikules-matematika.html>.
- Pse materialet mësimore janë të rëndësishme?* (2022, 10 21). Retrieved from <https://lwworc.org/sq/why-instructional-materials-are-important>.
- Tomlinson, B. (2001). *Materials development*. In R. Carter & D. Nunan (eds.). Retrieved from <https://books.google.com/books>.
- shqip, F. (2023, 4 14). Retrieved from fjale.al: <https://fjale.al/material>
- Edu, T. L. (2022, 11 24). leverageedu.com. Retrieved from <https://leverageedu.com/blog/teaching-learning-material/>: <https://leverageedu.com/blog/teaching-learning-material/>
- MAShT. (2006, 6 29). <https://masht.rks-gov.net>. Retrieved from <https://masht.rks-gov.net/ligji-per-botimin-e-teksteve-shkollore-mjeteve-mesimore-lektyres-shkollore-dhe-te-dokumentacionit-pedagogjik-nr-02-l-67/>
- MAShT. (2006). <https://masht.rks-gov.net/ligji-per-botimin-e-teksteve-shkollore-mjeteve-mesimore-lektyres-shkollore-dhe-te-dokumentacionit-pedagogjik-nr-02-l-67>. Retrieved from masht.rks-gov.net.

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37(496.51)(048)

Kërkime pedagogjike / këshilli shkencor i IPK-së Hatixhe Ismajli, Naser Zabeli, Linda Grapci . - Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2023. - libra ; 24 cm.

[Vëllimi] 1 : Përmbledhje punimesh. - 200 f. : ilustr.

1. Ismajli, Hatixhe 2. Zabeli, Naser 3. Grapci, Linda

ISBN 978-9951-591-67-6

ISBN 978-9951-591-68-3

ISBN 978-9951-591-68-3



9 789951 591683